



**Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës**

# UDHËZIME PËR EDUKIMIN GLOBAL

*Zhvilluar nga Rrjeti i Javës së Edukimit Global  
I koordinuar nga Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës*

# UDHËZIME PËR EDUKIMIN GLOBAL

---

## KONCEPTE DHE METODOLOGJI PËR EDUKIMIN GLOBAL PËR MËSUESIT DHE HARTUESIT E POLITIKAVE

Zhvilluar nga Rrjeti i Javës së Edukimit Global  
I koordinuar nga Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës

Botuar nga: Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës - Lisbonë  
2008

Botimi i parë 2008 - Botimi i përditësuar 2012

Shkruar nga: Grupi i Punës për Udhëzimet për Edukimin  
Global -  
Alicia Cabezudo, Christos Christidis, Miguel  
Carvalho da Silva, Valentina Demetriadou -  
Saltet, Franz Halbartschlager, Georgeta-Paula  
Mihai

Koordinuar: Miguel Carvalho da Silva

Përktheu: Astrit Dautaj

# PËRMBAJTJA

Parathënie dhe mirënjohje .....	4
Hyrje .....	5
Informacion.....	6
Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës.....	6
Programi i Edukimit Global i Qendrës Veri - Jug.....	6
Kapitulli A - Çfarë është edukimi global?.....	9
Përkufizime dhe deklaratat.....	9
Edukimi Global si proces i të mësuarit transformues.....	12
Kapitulli B - Përse Edukim global? .....	14
Bota e sotme: një botë e globalizuar .....	14
Të mësuarit për shoqërinë globale .....	15
Synimet.....	16
Kapitulli C - Koncepte .....	17
Njohuri – fusha pëmbajtjeje të sugjeruara .....	19
Aftësi.....	19
Vlera dhe qëndrime.....	21
Kapitulli D - Metodologjia .....	23
Bazat për metodologjinë e edukimit global.....	23
Kritere për përzgjedhjen dhe vlerësimin e metodave të edukimit global.....	25
Ide të rëndësishme për zbatimin e edukimit global.....	26
Metoda për zbatimin e edukimit global.....	31
Praktika të rekomanduara .....	33
Kritere për planifikimin dhe vlerësimin e edukimit global.....	39
Kritere për përzgjedhjen dhe vlerësimin e burimeve.....	41
Kritere për hartimin e kurrikulës për mjediset formale dhe jo formale .....	44
Vlerësimi .....	48
Kapitulli F - bibliografi & burime .....	55
Referenca .....	55
Lista e burimeve të edukimit global .....	57
Burimet arsimore të Këshillit të Evropës.....	58
Shtojca 1 – Deklarata e Maastricht për Edukimin Global.....	59
Shtojca 2 – Karta e Edukimit Global.....	64
Shtojca .....	74

## PARATHËNIE DHE MIRËNJOHJE

Ky dokument shërben si udhëzues për të kuptuar dhe për të zbatuar në praktikë edukimin global. Ai shërben edhe si një udhëzues pedagogjik për përdorimin dhe pasurimin e qasjes së edukimit global në çdo mjedis ku mësohet. Përmbajtja e tij ka në bazë përvojën e fituar nga praktikat jetësore dhe realitetet kulturore, gjeografike, shoqërore dhe ekonomike.

Ky manual ka në themel idenë se proceset arsimore në mjediset formale dhe jo formale duhet të hapin rrugën për të kuptuar më mirë botën e sotme gjithnjë e më globale. Ai shtrton edhe çështje të rëndësishme që lidhen me përgjegjësitë profesionale të edukatorëve dhe mësuesve si dhe me rolin e shkollës dhe të organizatave dhe institucioneve të ndryshme për rritjen e vetëdijes globale dhe të njohurive për çështjet botërore në kurrikul dhe në projektet dhe veprimtaritë jo formale.

Autorët dëshirojnë të përshëndesin proceset pjesëmarrëse që çuan në shkrimin e këtyre udhëzimeve dhe mundësinë për të diskutuar dhe kontribuar në zhvillimin e Edukimit Global, pasi këto udhëzime pasqyrojnë këndvështrimet e të interesuarve të ndryshëm në këtë fushë. Përfshirja e këndvështrimeve dhe e ideve të ndryshme, ndonjëherë edhe kundërshtuese, ka qenë jo vetëm sfidë, por edhe ka pasuruar përmbajtjen e këtij dokumenti.

Falënderojmë të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre për të bërë realitet këtë dokument, siç për shembull, anëtarët e rrjetit të Javës së Edukimit Global si dhe partnerët që, me mirësjellje, pranuan të luajnë rolin e vështirë të miqve kritikë.

## HYRJJE

Këto Udhëzime për Edukimin Global janë përgjigje e nevojës së shprehur nga rrjeti i veprimtarëve të edukimit global – rrjeti i Javës së Edukimit Global - për të pasur një instrument të përbashkët që ka në themel përvojën e fituar nga rrjeti dhe partnerë të tjerë, për të mbështetur mësuesit që të kuptojnë dhe të zbatojnë me sukses nismat e edukimit global.

Përmes këndvështrimeve të ndryshme për edukimin global, përmes metodave përkatëse dhe kritereve të vlerësimit, të cilat përfshijnë edhe praktikën, instrumentet dhe burimet e përbashkëta, këto Udhëzime synojnë të fuqizojnë punën tërësore për edukimin global. Ato synojnë edhe të ndihmojnë mësuesit në mjediset arsimore formale dhe jo formale, duke i pajisur ata me elemente të përgjithshëm që mund të zhvillohen më tej në përputhje me nevojat dhe përvojat e tyre konkrete; t'i ndihmojnë ata në identifikimin e metodave dhe praktikave ekzistuese të edukimit global; t'i mbështesin në procesin e reflektimit për çështjet globale dhe të rritjes së vetëdijes për veprimtaritë e tyre në këtë fushë; të rrisin shkëmbimin e praktikave të edukimit global dhe bashkëveprimin ndërmjet të interesuarve; të kontribuojnë në politikën arsimore në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Udhëzimet për Edukimin Global janë nismë e Programit të Edukimit Global të Qendrës Veri-Jug të Këshillit të Evropës, me pjesëmarrjen e një ekipi arsimtarësh nga rrjeti i Javës së Edukimit Global, që përbënte grupin e autorëve që kishin mandatin të hartonin së bashku Udhëzimet për Edukimin Global. Procesi i hartimit kishte në themel qasjen pjesëmarrëse të realizuar përmes konsultave, të organizuara në disa nivele, me arsimtarë dhe veprimtarë të edukimit global, të përfshirë aktivisht në programet e edukimit global dhe në programet rinore të Qendrës Veri-Jug. Këtyre iu bashkua edhe një grup këshilltarësh nga partnerët Evropianë dhe ndërkombëtarë të Qendrës Veri-Jug, të cilët kishin në përbërje edhe një ekip trajnerësh nga Universiteti i Qendrës Veri-Jug për Rininë dhe Zhvillimin.

Temat e paraqitura në manual synojnë të qartësojnë çështjet themelore që lidhen me edukimin global; ato sugjerojnë strategji për ndërtimin e përmbajtjes; ofrojnë qëllime, aftësi, vlera dhe qëndrime; ofrojnë këshilla për metodat, për hartimin dhe vlerësimin e kurrikulës dhe një listë me kontakte, adresë interneti dhe bibliografi të vlefshme.

Udhëzimet duhet të vlerësohen si një proces zhvillimi, i cili duhet të pasurohet rregullisht me ide, kontribute dhe praktika të reja, të sjella nga partnerë të ndryshëm me përvoja të ndryshme.

Në faqen e Qendrës Veri-Jug - [www.nscentre.org](http://www.nscentre.org) – do të gjeni si versionin e shtypur, ashtu edhe atë elektronik të manualit. Versioni elektronik përmban një kapitull shtesë, me adresë të dobishme për edukimin global, të cilat janë përditësuar rregullisht.

# INFORMACION

## QENDRA VERI – JUG E KËSHILLIT TË EVROPËS

Qendra Veri-Jug, e quajtur zyrtarisht si Qendra Evropiane për Ndërvarësi dhe Solidaritet Global është një Marrëveshje e Pjesshme e Këshillit të Evropës.

Qendra Evropiane për Ndërvarësi dhe Solidaritet Global u hap në Lisbonë në vitin 1990, në zbatim të Rezolutës (89) 14, e miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në 16 Nëntor 1989.

Mandati i Qendrës Veri-Jug i Këshillit të Evropës është të sigurojë një kuadër për bashkëpunim Evropian, me qëllim që të ngrëjë vetëdijen publike për çështjet të ndërvarësisë globale dhe të nxisë dhe nxisë politikatat e solidaritetit në përputhje me qëllimet dhe parimet e Këshillit të Evropës, respektin për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe kohezionin shoqëror. Puna e Qendrës Veri-Jug bazohet në tre parime: dialogu, partneriteti dhe solidariteti. Qeveritë, parlamentet, autoritetet vendore dhe rajonale dhe organizatat e shoqërisë civile përbëjnë partnerët që janë përfshirë në veprimtaritë e Qendrës. Qendra kryen studime dhe organizon debate, seminare dhe kurse trajnimi. Ajo vepron si katalizator, përmes lehtësimit të takimeve ndërmjet aktorëve me pikëpamje dhe nga vende të ndryshme, duke punuar për çështje të interesit të përbashkët dhe për nxitjen e formimit të rrjeteve të ndryshëm.

Qendra Veri-Jug vepron në dy drejtime kryesore:

- *Ngritja e vetëdijes Evropiane për çështjet e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global përmes arsimit dhe programeve rinore.*
- *Nxitja e politikave të solidaritetit Veri-Jug në përputhje me qëllimet dhe parimet e Këshillit të Evropës përmes dialogut ndërmjet Evropës, vendeve të Mesdheut Jugor dhe Afrikës.*

## PROGRAMI I EDUKIMIT GLOBAL I QENDRËS VERI-JUG

Objektivi i Qendrës Veri-Jug në lidhje me edukimin global është të zhvillojë, të rrisë dhe të mbështesë strategjitë dhe ndërtimin e kapaciteteve për edukimin global, në institucionet dhe veprimtarët që veprojnë në fushën e edukimit global, në sektorin formal dhe jo formal. Kjo punë bazohet në bindjen se edukimi global është një “edukim tërësor që hap sytë dhe mendjen e njerëzve ndaj realiteteve të botës dhe i zgjon ata për një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta njerëzore për të gjithë”.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Deklarata e Mاستrihtit për Edukimin Global, 15-17 nëntor 2002. Përcaktimi i parë është bërë në Takimin e Rrjetit të Javës së Edukimit Global” në Qipro, 28-31 mars 2002.

Në këtë këndvështrim, “Edukimi global, si dimension i Edukimit për qytetari, përfshin Edukimin për zhvillim, Edukimin për të drejtat e njeriut, Edukimin për qëndrueshmëri, Edukimin për paqe dhe për parandalimin e konfliktit dhe Edukimin ndërkulturor<sup>2</sup>.”

Programi i Edukimit Global i Qendrës Veri-Jug nxit, përmirëson dhe intensifikon këtë edukim në shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës si dhe në nivel global. Ky program bazohet në rekomandimet dhe rezultatet e konferencës që Qendra Veri-Jug organizoi në Athinë (1996), Budapest (1999) dhe në Maastricht (2002).

Ideja e Kartës së Edukimit Global për shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës lindi në seminarin ndërkombëtar për Partneritetin në Edukimin Global – Edukimi global në Shkollat e Mesme, i organizuar nga Qendra Veri-Jug në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Kombëtar dhe Çështjeve Fetare të Republikës Greke në Athinë, në mars të vitit 1996. Karta e Edukimit Global doli në vitin 1997, si dokumenti i parë referues për edukimin global i Qendrës Veri-Jug.

Që nga Konferenca e Budapestit, Lidhja dhe të Nxëniet për Ndryshim Global, në qershor 1999, Qendra Veri-Jug ka zhvilluar një mekanizëm për ngritjen e rrjeteve për veprimtarët nga shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës për të ndara strategjitë dhe praktikën për të rritur dhe përmirësuar edukimin global. Ky mekanizëm u bë zyrtar dhe Rrjeti i Javës së Edukimit Global organizoi takimin e tij të parë në Lisbonë në vitin 2000.

Kjo qasje rrjeti u mbështet nga Java e Edukimit Global, ngjarja përruese vjetore, mbarë evropiane, e rritjes së vetëdijes së për nxitjen e praktikave të edukimit global në mjediset arsimore formale, jo formale dhe jo formale. Java e Edukimit Global është koordinuar me ndihmën e Rrjetit të Javës së Edukimit Global, me mbështetjen e një faqeje interneti dhe një gazete periodike elektronike. Ky proces rrjeti është vlerësuar gjatë seminarit vjetor të vlerësimit të Javës së Edukimit Global, në të cilin u shkëmbyen strategjitë për rritjen dhe përmirësimin e edukimit global. Gjatë këtij seminari u zgjodh edhe tema e Javës së Edukimit Global për vitin në vijim.

Në Kongresin e Edukimit Global në Maastricht (2002), i organizuar nga Qendra Veri-Jug dhe partnerët e saj, përforcoi idenë për edukimin global, duke mbledhur së bashku politikanë dhe veprimtarë për të reflektuar për një strategji evropiane që do të përmirësonte dhe rriste edukimin global deri në vitin 2015. Ky reflektim çoi në Deklaratën e Maastricht.

Në kuadrin e procesit të hartimit të Udhëzimeve për Edukimin Global, Qendra Veri-Jug vendosi që ato, së bashku me nismat e mëparshme, të tilla si Deklarata e Maastricht për Edukimin Global të siguronin një bazë për të kryer një proces konsultimi në vitin 2008, i cili do të çonte në miratimin e rekomandimeve nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës për të mbështetur edukimin global në shtetet e tij anëtare.

Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës dhe Komisioni Evropian kanë rënë dakord të harmonizojnë përpjekjet e tyre për të rritur edukimin global dhe veprimin rinor në Evropë dhe më gjerë. Për këtë qëllim, të dyja institucionet, në 28 nëntor 2008, kanë nënshkruar një marrëveshje të përbashkët për të rritur të kuptuarit publik dhe për të mbështetur fuqimisht bashkëpunimin për zhvillim dhe përmbushjen e Synimeve të Mijëvjeçarit për Zhvillim, përmes aktorëve dhe të interesuarve në fushën e edukimit global.

---

<sup>2</sup> Deklarata e Maastrichtit për Edukimin Global, 15-17 nëntor 2002, shih Shtojca 1

Projekti bazohet në dy shtylla kryesore, së pari, në ambicien për të fuqizuar edukimin global në Shtetet Anëtarë të Bashkimit Evropian dhe, së dyti, në nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit rinor Afrikan-Evropian, në kuadrin e Strategjisë Bashkim Evropian-Afrikë, duke synuar kryesisht aktorët e shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale.

Programi i Edukimit Global bazohet edhe në Rekomandimet e Rezolutës 1318 (2003) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të cilat u rekomandojnë shteteve anëtarë të “nxisin edukimin global, të fuqizojnë vetëdijen publike për zhvillim të qëndrueshëm, duke mbajtur parasysh që Edukimi Global është thelbësor për të gjithë qytetarët për të fituar njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar, për të marrë pjesë dhe për të ndërvepruar me shoqërinë tonë globale, si “qytetarë të fuqizuar global”. Ky program plotëson veprimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme për Edukimin, Kulturën, Rininë dhe Sportet të Këshillit të Evropës në fushën e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe Edukimit për të Drejtat e Njeriut.

Objektivat e Programit të Edukimit Global janë pjesë e objektivave të Dekadës së UNESCO Kombeve të Bashkuara të Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Po kështu, duke iu referuar Synimeve të Mijëvjeçarit për Zhvillim, ky program synon të lehtësojë diskutimet dhe dialogun ndërmjet vendimmarrësve në fushën e politikës, të organizatave të shoqërisë civile ekspertëve, përmes partneritetit dhe rrjeteve.

Dhjetë vjet për Kongresit të mbajtur në Maastricht, ekzistonte nevoja për të reflektuar dhe lehtësuar një dialog për arritjet në edukimin global, duke mbajtur parasysh realitetet në ndryshim dhe të trajtojë sfidat e reja shoqërore, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë këndvështrim, NSC, GENE dhe CONCORD vendosën të mbajnë **një Kongres të dytë Evropian për Edukimin Global: Arsim, Ndërvarësi dhe Solidaritet në një Botë një Ndryshim**, në Lisbonë, në 27-28 shtator 2012, për të garantuar angazhimin për mbështetjen e nevojshme për fuqizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të edukimit global deri në vitin 2015 e më tej, duke rritur vetëdijen për Rekomandimet për edukimin për ndërvarësi globale dhe solidaritet dhe duke ndihmuar Shtetet anëtarë të vendosin standarde në këtë fushë.



## KAPITULLI A

# ÇFARË ËSHTË EDUKIMI GLOBAL?

### PËRKUFIZIME DHE DEKLARATA

Edukimi global është një këndvështrim edukativ që ngrihet nga fakti që njerëzit bashkëkohorë jetojnë dhe bashkëveprojnë në një botë gjithnjë e më globale. Arsimit i lind detyra e rëndësishme për t'u dhënë nxënësve shanset dhe kompetencat për të reflektuar dhe për të ndarë pikëpamjet dhe rolet në një shoqëri të ndërlidhur globale, si dhe për të kuptuar dhe për të diskutuar marrëdhëniet komplekse të çështjeve të përbashkëta shoqërore, ekologjike, politike dhe ekonomike, për të nxitur mënyra të reja të menduari dhe vepruari. Megjithatë, edukimi global nuk duhet të trajtohet si një qasje që duhet pranuar si e mirëqenë, pasi ne jemi të vetëdijshëm për dilemat, tensionet, dyshimet dhe perceptimet e ndryshme që lindin gjatë trajtimit të çështjeve globale në një proces edukimi.

Përkufizimet për edukimin global janë të ndryshme. Deklarata e Edukimit Global e Mاستrihtit (20012) shpall:

**Edukimi global** është edukimi që hap sytë dhe mendjet e njerëzve ndaj realiteteve të botës së globalizuar dhe i zgjon ata për një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta të njeriut për të gjithë.

**Edukimi global**, si dimension i Edukimit për qytetari, përfshin Edukimin për zhvillim, Edukimin për të drejtat e njeriut, Edukimin për qëndrueshmëri, Edukimin për paqe dhe për parandalimin e konfliktit dhe Edukimin ndërkulturor

Ekzistojnë dokumente të ndryshëm ndërkombëtarë që lidhen me zhvillimin e konceptit të edukimit global. Ne kemi renditur disa prej tyre sepse secili, në mënyrën e tij, përqendrohet dhe e pasuron këtë qasje.

- **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**

Arsimi duhet të synojë zhvillimin e plotë të personalitetit njerëzor dhe fuqizimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe të lirive themelore. Ai duhet të nxisë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet të gjitha kombeve, racave ose grupeve fetare dhe duhet të çojë përpara veprimtaritë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

Neni 26, **Kombet e Bashkuara, Konferenca e Përgjithshme, San Francisko, 10 Dhjetor 1948**

[www.un.org/education](http://www.un.org/education)

- **Rekomandime në lidhje me Edukimin për Mirëkuptim, Bashkëpunim dhe Paqe në nivel ndërkombëtar, dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.**

Edukimi ndërkombëtar duhet të çojë përpara zhvillimin e duhur intelektual dhe emocional të individit përmes harmonizimit të të mësuarit, trajnimit, informimit dhe veprimit. Ai duhet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore dhe të solidaritetit me grupet më pak të favorizuara dhe duhet të drejtohet drejt vëzhgimit të parimeve të barazisë në sjelljet e jetës së përditshme.

**UNESCO, Konferenca e Përgjithshme, Paris, Nëntor 1974**

[www.unesco.org/education](http://www.unesco.org/education)

- **Agjenda 21, Kapitulli 36: Zhvillimi i Edukimit, Vetëdijes Publike dhe Trajnimit.**

Edukimi, që përfshin arsimin formal, vetëdijen publike dhe trajnimin duhet të pranohet si një proces me anë të të cilit qeniet njerëzore dhe shoqëritë mund të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre. Edukimi është thelbësor për të çuar përpara zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të përmirësuar aftësitë e njerëzve për të trajtuar çështjet e mjedisit dhe ato të zhvillimit.

**Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, Rio de Janeiro,**

**3 - 14 Qershor 1992**

[www.un.org/esa/sustdev/documents](http://www.un.org/esa/sustdev/documents)

- **UNESCO – Deklarata Kuadri i Integruar për Veprim dhe Edukim për Paqe, të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci, Paris 1995**

Hyrje: Edukimi duhet të zhvillojë aftësinë për të vlerësuar vlerën e lirisë dhe të aftësive e nevojshme për të përballuar sfidat që e shoqërojnë atë. Kjo do të thotë, të edukosh qytetarët për të zgjidhur situatat e vështira dhe të pasigurta, për të ndërtuar tek ta aftësinë për autonomi dhe përgjegjësi individuale . Kjo kërkon vlerësimin e vlerës së përfshirjes qytetare dhe të aftësisë për të bashkëpunuar me të tjerë për të zgjidhur problemet dhe për të punuar për ndërtimin e një shoqërie të barabartë, paqësore dhe demokratike.

**UNESCO, Konferenca e Përgjithshme, Paris, 19 Nëntor 1995**

[www.unesco.org/education](http://www.unesco.org/education)

- **Deklarata e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, 2000**

Kapitulli: Vlerat dhe parimet

Ne besojmë që sfida qendrore me të cilën përballemi sot është të sigurojmë që globalizimi të bëhet një forcë pozitive për njerëzit e botës. Ndonëse globalizimi ofron shanse të mëdha, sot përfitimet prej tij ndahen në mënyrë të pabarabartë, ndërkohë që kostot nuk ndahen në përputhje me përfitimet. Ne pranojmë që vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion përballen me vështirësi të veçanta në përpjekjet e tyre për t'u përballur me këtë sfidë qendrore. Për këtë arsye, vetëm, përmes përpjekjeve të gjera dhe të mbështetura për të krijuar një të ardhme të përbashkët, të bazuar në humanizmin tonë të përbashkët me gjithë larminë e tij, globalizimi mund të bëhet gjithëpërfshirës dhe i drejtë.

- **Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Nju Jork, 8 shtator 2000**

<http://un.org/miollenniumgoals/>

▪ **Dekada e Kombeve të Bashkuara për Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm 2005-2014**

Vizioni i Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm është bota në të cilën secili ka shanset të përfitojë nga arsimi dhe të mësojë vlerat, sjelljet dhe mënyrën e jetesës që kërkohet për një të ardhme të qëndrueshme dhe për shndërrime shoqërore pozitive.

**Dekada e Kombeve të Bashkuara për Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm, Skema e Zbatimit Ndërkombëtar, Janar 2005**

[www.unesco.org/education](http://www.unesco.org/education)

▪ **Konsensusi Evropian për Zhvillimin: Kontributi i Edukimit për Zhvillim dhe Rritjen e Vetëdijes, 2007**

Synimi i Edukimit për Zhvillim dhe Rritjen e Vetëdijes është të aftësojë çdo person në Evropë për të pasur shanse gjatë gjithë jetës për t'u vetëdijësuar për dhe për të kuptuar shqetësimet e zhvillimit global e lokal dhe lidhjet personale me këto shqetësime dhe për të vënë në jetë të drejtat dhe përgjegjësitë, si banorë të një bote të ndërvarur dhe në ndryshim, për të sjellë ndryshime për një botë të drejtë dhe të qëndrueshme.

[http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/PUBLICATION\\_CONSENSUS\\_EN-067-00-00.pdf](http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/PUBLICATION_CONSENSUS_EN-067-00-00.pdf)

▪ **Viti Evropian i Dialogut Ndërkulturor, 2008**

Neni 2: Objektivat

1. Objektivat e përgjithshëm të Vitit Evropian të Dialogut Ndërkulturor do të kontribuojnë në [...] ngritjen e vetëdijes së të gjithë banorëve të Evropës, veçanërisht të rinjve, për rëndësinë e zhvillimit të një qytetarie aktive evropiane, të hapur ndaj botës, respektit të diversitetit kulturor dhe që bazohet në vlerat e përbashkëta në BE, të shprehura në nenin 6 të Traktatit të BE dhe të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.
2. Objektivat specifike të Vitit Evropian të Dialogut Ndërkulturor do të rrisin rolin e edukimit mjete të rëndësishëm për mësimdhënien rreth diversitetit, rritjen e të kuptuarit të kulturave të tjera dhe zhvillimit të aftësive dhe praktikave më të mira dhe do të hedhin dritë mbi rolin qendror të medias në zbatimin e parimit të barazisë dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë.

**Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës, Vendimi Nr. 1983/2006/EC 18 dhjetor 2006**

<http://ec.europa.eu/culture/portal/events/current/dialogue2008>

▪ **Letër e Bardhë për Dialogun Ndërkulturor e Këshillit të Evropës, Qershor 2008**

Qasja ndërkulturore ofron një model të menaxhimit të diversitetit kulturor të orientuar nga ardhmja. Ai propozon një konceptim që bazohet në dinjitetin njerëzor të individit (që përfshin humanizmin dhe fatin e përbashkët). Nëse duhet të realizojmë një identitet Evropian, ai do të bazohet në vlerat themelore të përbashkëta, në respektin për trashëgiminë e përbashkët dhe diversitetin kulturor, si dhe në respektin për dinjitet të barabartë njerëzor të çdo individi. e. Dialogu ndërkulturor luan rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ai mundëson parandalimin e ndarjeve etnike, fetare, gjuhësore dhe kulturore. Ai mundëson ecjen përpara në trajtimin e identiteteve tona të ndryshme kulturore në mënyrë konstruktive dhe demokratike, në bazë të vlerave të përbashkëta universale.

<http://www.coe.int/t/dg4/intercultural>

- **Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (e miratuar nga Komiteti i Ministrave në 11 Maj 2010)**  
Edukimi për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut ndërlihen ngushtë dhe mbështetin njëra tjetrën në mënyrë të ndërsjellë. Edukimi për qytetari demokratike përqendrohet kryesisht në të drejtat dhe përgjegjësitë demokratike dhe në pjesëmarrjen aktive, në lidhje me fushat qytetare, politike, shoqërore, ekonomike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë, ndërkohë që edukimi i të drejtave të njeriut ka të bëjë me spektrin më të gjerë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në çdo aspekt të jetës njerëzore

## **EDUKIMI GLOBAL SI PROCES I TË MËSUARIT TRANSFORMUES**

Në këto udhëzime ne dëshirojmë të trajtojmë rolin e edukimit global dhe të vëmë në dyshim qëndrimet, duke u larguar nga kultura e individualizmit, që shpesh herë shoqërohet me sundim, drejt një kulture të partneritetit të bazuar në dialog dhe bashkëpunim. Modeli i parë kulturor karakterizon sistemet arsimore në shume vende ku temat e edukimit global dhe vetëdija për realitetet e botës mendohet se nuk përputhet me vizionet kombëtare. Nga ana tjetër, modeli i partneritetit mund të çojë në mirëkuptimin ndërkombëtar dhe në bashkëpunimin ndërmjet kombeve dhe popujve.

Aspektet e sundimit ekzistojnë në forma të ndryshme në shumë aspekte të shoqërive tona dhe janë rrënjësor thellë në strukturat e sistemeve arsimore. Modeli aktual i arsimit pasqyron në shkallë të madhe këtë sundim. Kritika kundër tij, nënvizon se ky model të çon në marrëdhënie kundërshtuese ndërmjet individëve dhe njerëzve, veçanërisht nëse ata u përkasin kulturave, feve, grupeve shoqërore të ndryshme ose mënyrave të ndryshme të menduarit.

Duke i ndarë dhe kategorizuar lëndët, ne kemi krijuar hierarki dijeshe dhe kemi zhvlerësuar mënyrat e tjera të të mësuarit. Kjo ndarje e krijuar nga ky proces i një arsimit të fragmentarizuar, nuk na vendos në një botë të ndërlidhur dhe, në këtë mënyrë, nuk na jep mundësinë të ndërtojmë ura për t'iu afuar, për t'i njohur dhe për t'i kuptuar të tjerët.

Edukimi global nënkupton zbatimin e vizionit të kërkuar për të shkuar drejt një modeli partneriteti ndërmjet njerëzve, kulturave dhe feve në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Të mësuarit transformues përmes edukimit global përfshin një zhvendosje të thellë strukturale në bazën e mendimeve, ndjenjave dhe veprimeve. Ky është një edukim për mendjen dhe për zemrën. Kjo nënkupton një ndryshim rrënjësor drejt ndërlidhjes dhe krijon mundësi për të arritur më shumë barazi, drejtësi shoqërore, mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërmjet njerëzve.

Me edukimin global lidhen fuqimisht tri faza kryesore të të mësuarit transformues:

- Një analizë e situatës së sotme botërore
- Një vizion për alternativat kundrejt modeleve sunduese
- Një proces i ndryshimit drejt qytetarisë së përgjegjshme globale.

Edukimi global, si një proces i të mësuarit transformues, nënkupton procese pjesëmarrëse të vendimmarrjes në të gjitha këto faza. Qëllimi i një lloji të tillë të mësuari është të kultivojë njohuri të ndërsjella dhe vetëdije kolektive. Edukimi global sfidon makutërinë, pabarazinë dhe

egocentrizmin, përmes bashkëpunimit dhe solidaritetit, në vend që të ndajë njerëzit me anë të konkurrencës, konflikteve, frikës dhe urrejtjes.

Edukimi global, si një proces i të mësuarit transformues, ofron një rrugë për të sjellë ndryshime në nivele lokale të cilat ndikojnë nivelin global, në kuptimin e ndërtimit të qytetarisë përmes strategjive dhe metodave pjesëmarrëse, në mënyrë që njerëzit të mësojnë duke marrë përgjegjësitë, të cilat nuk mund t'i lihen në dorë vetëm qeverive dhe vendimmarrësve të tjerë.

Si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar, edukimi global bashkon programet e fushave të ndryshme të edukimit: Edukimi për Zhvillim, Edukimi i të Drejtave të Njeriut, Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm, Edukimi për Paqe dhe për Parandalimin e Konfliktit, Edukimi Ndërkulturor dhe ndërfetar, dimensionin global të edukimit për Qytetari etj., me qëllim që të përcaktohen themelet e përbashkëta të edukimit global.

Kjo do të krijojë ndikim real si në arsimin formal ashtu edhe në atë jo formal, i cili duhet të luajë një rol të madh për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë më gjerë pushtetin e tyre të vërtetë për ndërtimin e së ardhmes.

Por, edukimi global nuk merret vetëm me temat globale, problemet botërore dhe zgjidhjet e tyre. Ai është edukimi për të parashikuar një të ardhme me kushte më të mira jetese për të gjithë, duke lidhur këndvështrimet globale për të ardhmen dhe, duke filluar nga bota jonë e vogël, të bëjë të mundur që ky vizion të jetë sa real aq edhe i mundshëm. Të mësuarit transformues aftëson njerëzit të modelojnë një vizion të përbashkët për një botë me të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë. Përqendrimi në një të ardhme të tillë të dëshirueshme është edhe thelbi i vizionit transformues

Edukimi global mund të kontribuojë në procesin e projektimit të së ardhmes, por ai mund të luajë rol edhe në krijimin e metodave të reja, ku lëvizjet shoqërore dhe proceset e të mësuarit jo formal janë të rëndësishme për krijimin e hapësirave për vlera, çështje dhe metoda që nuk janë qendrore për të mësuarit formal, duke i dhënë më shumë zë të gjithë njerëzve, duke përfshirë edhe të shpërfillurit.

Duke e zhvendosur përqendrimin në zëvendësimin e kulturës që riprodhon sundimin me atë të partneritetit që bazohet në dialogun dhe bashkëpunimin, edukimi global ndryshon rregullat e vendosura të ekonomisë globale, duke rikthyer dinjitetin njerëzor në një vlerë qendrore.

## KAPITULLI B

# PËRSE NEVOJITET EDUKIMI GLOBAL?

## BOTA E SOTME: NJË BOTË E GLOBALIZUAR

Si rrjedhojë e lidhjeve të shumta të ndërvarësisë ndërmjet vendeve, bota në të cilën jetojmë është zhvilluar në një sistem të globalizuar. Historia e kohëve të fundit, në mënyrë të padyshimtë, tregon se jeta e burrave dhe grave të këtij planeti mund të ndikohet nga ngjarje dhe procese që ndodhin mijëra kilometra larg. Marrëdhëniet ekonomike, gjeopolitike dhe sociale në nivel botëror, komunikimi dhe teknologjitë moderne, media dhe transporti mundësojnë një qarkullim më të shpejtë të informacionit. Njerëzit dhe të mirat janë shkaqe dhe tipare të globalizimit si një proces që të çon në një botë të ndërvarur, të cilën sot e quajmë *glocalizim*.

Globalizimi është kompleks dhe i shumanshëm dhe pasojat e tij mund të vlerësohen, njëherazi, pozitive dhe negative:

Ndër pasojat pozitive të globalizimit mund të përmendim zgjerimi i horizontit të njerëzve, shfrytëzimi i njohurive dhe produkteve të shkencës dhe teknologjisë, larmia kulturore dhe pikëpamjet ndërkulturore, rritja e shanseve, zhvillimi personal dhe shoqëror dhe mundësitë e shkëmbimit të ideve dhe veprimet e përbashkëta drejt zgjidhjeve së problemeve të përbashkëta.

Pasojat negative janë, kryesisht, në nivelin shoqëror, ekonomik dhe mjedisor. Në njërin anë, është rritur varfëria në shoqëri, është zgjeruar hendeku ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim dhe ndërmjet njerëzve të privilegjuar dhe të përjashtuar, është ulur standardi i jetesës, janë rritur sëmundjet, migracioni i detyruar dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, shfrytëzimi i grupeve të dobëta shoqërore, racizmi dhe ksenofobia, konfliktet, pasiguria dhe individualizmi ekstrem. Nga ana tjetër, ka shumë pasoja mjedisore të tilla si: efekti serrë, ndryshimet klimatike, ndotja dhe shterimi i burimeve natyrore.

Shumë mendimtarë modernë besojnë se shkaqet kryesore për këto pasoja negative të globalizimit janë veprimtaritë pa fre të shoqërive shumëkombëshe dhe pasoja të vendimeve politike, që synojnë, kryesisht, zhvillime të njëanshme, të bazuar më shumë në sundimin e tregut, rritjen, konsumin dhe konkurrencën dhe uljen e mirëqenies shoqërore.

Ndërgjegjja botërore e ndryshimit global drejt një zhvillimi më të drejtë dhe më të qëndrueshëm dhe nevoja për bashkëpunim ndërkombëtar po trajtohet gjithnjë e më shumë në traktate, deklaratata dhe fushata që nxiten kryesisht nga angazhimi në rritje i shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare.

Që këtej, kërkesa për edukim global, si një dimension ndërkombëtar në metodat e mësimdhënies dhe të mësuarit në arsimin formal dhe jo formal, për të shkuar drejt një kuptimi më të mirë të çështjeve aktuale të botës, të ndikimi të tyre në nivel lokal dhe global, nuk është vetëm një nevojë, por edhe një sfidë morale e botës së sotme.

## **TË MËSUARIT PËR SHOQËRINË GLOBALE**

Globalizimi shtron sfida themelore në të gjitha fushat e edukimit në çdo vend. Ai ofron mundësi për njerëzit, kulturat, ekonomitë dhe gjuhët në një mënyrë të re. Në këtë kontekst, edukimi për çështjet globale mund të vlerësohet nga pikëpamja e tregut si rritje e aftësive dhe njohurive, të atyre që hyjnë në këtë treg, për të qenë konsumatorë dhe punëtorë të efektshëm në ekonominë globale.

Megjithatë, rëndësia e edukimit qëndron në ndihmën që i jep njerëzve të njohin dhe të pranojnë rolin e tyre dhe përgjegjësitë individuale dhe kolektive si anëtarë aktivë në këtë komunitet global, në kuadrin e angazhimit për drejtësi shoqërore dhe ekonomike për të gjithë dhe për mbrojtjen dhe rivendosjen e ekosistemeve të botës.

Edukimi global është koncepti pedagogjik i këtij vizioni

Si edukatorë në shekullin e 21-të, ne jetojmë në kohë sfidash dhe në një botë kundërshtish. Si mund t'i përgatisim njerëzit të përballojnë këto sfida? Cilat janë përgjegjësitë tona në botën e rritjes së informacionit dhe të zhvillimeve teknologjike? Cilat janë përgjegjësitë tona në botën e varfërisë, të dhunës, të paragjykitimit dhe të dëmtimit të mjedisit?

Edukimi global është një metodë e re, e cila përpiqet të ndihmojë në përgjigjen e këtyre pyetjeve. Ajo synon të aftësojë nxënësit të kuptojnë çështjet botërore ndërkohë që i fuqizon ata me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime të dëshirueshme për qytetarët e botës për të përballuar problemet globale. Në këtë këndvështrim, edukimi global është një proces i rritjes individuale dhe kolektive, që mundëson transformimin dhe vet transformimin. Në fakt është një praktikë shoqërore. Është një përgatitje e vazhdueshme për jetën në të cilën fitimi i kompetencave vepruese dhe emocionale për të analizuar dhe menduar në mënyrë kritike për realitetin, bën të mundur që nxënësit të bëhen agjentë shoqërorë aktivë.

Në këtë kontekst, gjithnjë e më shumë pranohet ideja se arsimi duhet të ofrojë shanse për vlerësimin realist, mbi bazë njohjeje të çështjeve bashkëkohore në botën tonë, pa imponuar pamje negative të një të ardhme të errët e të shkatërruar. Në të njëjtën kohë, argumentohet nevoja për më shumë mundësi në kurrikul për diskutime krijuese dhe të arsyeshme të pikëpamjeve të ndryshme për të ardhmet e mundshme. Kjo përputhet me lëvizjet bashkëkohore për reformat kurrikulare në vende të ndryshme, që mbështesin një këndvështrim më të hapur, përmes një përmbajtje të re, përdorimit të metodave aktive e burimeve të reja. Edukimi global përputhet me këtë lëvizje.

## **SYNIMET**

Edukimi global synon edukimin e qytetarëve në drejtësinë shoqërore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Edukimi global synon në hapjen e një dimensionit global dhe një këndvështrimi holistik në arsim për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë realitetet komplekse dhe proceset e botës së sotme dhe të zhvillojnë vlerat, qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e një bote të ndërlidhur.

Edukimi global ndihmon nxënësit të kuptojnë disa nga proceset komplekse që çojnë në dhunë dhe konflikt në nivel individual, kolektiv, kombëtar dhe global dhe të jenë të vetëdijshëm për disa nga rrugët për parandalimin dhe zgjidhjen e tyre. Përmes të kuptuarit të kulturave të ndryshme dhe edukimit të njerëzve si aktorë dinamikë për një botë më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë, edukimi global synon të zhvillojë qëndrime që çojnë në zgjidhje konstruktive dhe paqësore të konflikteve.

Edukimi global synon zhvillimin e komuniteteve të të mësuarit, në të cilët nxënësit dhe mësuesit nxiten të punojnë së bashku për çështjet globale.

Edukimi global synon në nxitjen dhe motivimin e nxënësve dhe mësuesve të shqyrtojnë çështjet globale përmes mësimdhënies dhe pedagogjisë krijuese.

Edukimi global synon të sfidojë programet dhe praktikatat e arsimit formal dhe jo formal përmes një përmbajtjeje dhe metodologjie të re.

Edukimi global synon të pranojë të qenit ndryshe, ndërvarësinë dhe krijimin e kushteve që të tjerët të shprehin vetveten dhe të ndërtojnë sjelljet e solidaritetit.

Edukimi global ndihmon nxënësit të zhvillojnë alternativat kur marrin vendime për jetën vetjake ose publike dhe të reflektojnë për pasojat e zgjedhjeve të tyre, duke kultivuar, në këtë mënyrë, shpirtin e “përgjegjësisë globale të qytetarit të botës”.

Edukimi global mbështet pjesëmarrjen në veprim. Me fjalë të tjera ai fton mësuesit dhe nxënësit të veprojnë në mënyrë dinamike për një botë më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.




## KAPITULLI C

### KONCEPTET

**Edukimi global** është një term që përmbledh koncepte që lidhen me realitetet e botës së sotme. Për këtë arsye, është një koncept i hapur, shumëpërmasor, i vazhdueshëm i arsimit të përgjithshëm. Përtej kësaj, ai vlerësohet si një përgjigje kolektive, tërësore ndaj sfidave historike, në mbështetje të qytetarisë globale, aktive në krijimin dhe rikrijimin e një bote të ndryshme, të barabartë, më të drejtë, paqësore dhe të qëndrueshme, të bazuar në solidaritet.

**Edukimi global** aftëson njerëzit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e nevojshme për të siguruar një botë të drejtë e të qëndrueshme në të cilën çdo individ ka të drejtë të përmbushë potencialin e tij.



Si e kemi përmendur në Kapitullin A, edukimi global nuk shqetësohet thjesht për këndvështrimet e temave globale dhe *çfarë ju mësohet për to*. Ajo shqetësohet për *mënyrën si mësohen dhe për kushtet e veçanta në të cilën mësohet*. Në fakt, është e nevojshme harmonia ndërmjet përmbajtjes, formës dhe kontekstit në të cilin ndodh procesi i të mësuarit.

Nëse edukimi global është mësimdhënia që ka të bëjë me qëllimet e ndryshimit për të vendosur një edukim që nuk riprodhon sistemin, por parashikon ndryshime shoqërore dhe

hap sytë e njerëzve<sup>3</sup>, është e qartë se përcaktimi tradicional i përmbajtjes duhet të zëvendësohet me një këndvështrim të ri të konceptit.

Përmbajtja e edukimit global e propozuar këtu nuk vjen nga kategori abstrakte, por nga nevojat e njerëzve, të shprehura prej tyre.

Koncepti tradicional i konceptit zëvendësohet nga:

- a) një analizë ngjarjesh dhe zhvillimesh që ndodhin në realitetin më të afërt.
- b) përzgjedhja e temave specifike të lidhura me këto ngjarje
- c) njohja e lidhjeve me botën e gjeë dhe dialogun që lind ndërmjet tyre.

Për këtë arsye, në një proces të mësuarit të edukimit global, nxënësit dhe mësuesit *thellohen në rrënjët dhe shkaqet e ngjarjeve dhe zhvillimeve* shkëmbejnë idetë për zgjidhje të mundshme në një ushtrim dinamik të vëzhgimit, analizës, reflektimit dhe shkëmbimit të informacionit që krijon një qark të ri njohurish dhe interesash.

Ndryshimet gjinore, klasore, etnike, fetare, ekonomike-shoqërore dhe kulturore do të rrjedhin përmes dialogëve dhe numrave ndërmjet çështjeve dhe problemeve të diskutuara dhe do të jenë pjesë e diskutimeve për zgjidhje të mundshme. Në këtë proces, *dija nuk është grumbullim njohurish, informacioni ose i disa të dhënave për tema ose probleme të caktuara*. Të dish do të thotë njohje e përditshme, përkujdesje ndaj të gjithë aspekteve të jetës dhe të menduarit lokal dhe global, të kuptuar në lidhje dhe ndërvarësi, në mënyrë që bota jashtme të jetë pjesë e analizës së jetës së përditshme, duke furnizuar procesin e të mësuarit.<sup>4</sup>

Në këtë mënyrë, përmbajtja është rezultat i një ndërlidhjeje konstante ndërmjet njohurive abstrakte të teorive dhe përvojave konkrete të jetës së përditshme. Në se në këtë proces të ndërtimit të kësaj përmbajtjeje, sjellja konkrete transformohet në kontekste të veçanta, ne e quajmë këtë zbatim praktik të teorisë – një dukuri që çrrënjës dallimin ndërmjet përmbajtjes abstrakte dhe sjelljes në kontekst.<sup>5</sup>

Përmbajtja në edukimin global lidh problemet në mikro kontekst me çështjet globale (të cilat janë edhe probleme në makro kontekst) dhe zhvendoset nga realiteti i afërt (familja, fqinjët, shkolla, qyteti) në një realitet të ndërmjetëm (qarku, shteti) dhe realiteti i largët (bota globale). Për këtë arsye është e rëndësishme të ndiqen të njëjtët probleme dhe çështje në të gjitha nivelet, për të shqyrtuar në mënyrë të vazhdueshme marrëdhëniet ndërmjet mikro dhe makro kontekstit, një ndër qasjet më të rëndësishme metodologjike për të kuptuar temat globale.<sup>6</sup>

---

<sup>3</sup> Shih Deklaratën e Mastrihtit, Kapitulli A, faqe 9

<sup>4</sup> Shih marrëdhëniet mikro/makro, Kapitulli D, Metodologjia, faqe 22

<sup>5</sup> Shih Paulo Freire “Pedagogjia e të shtypurit”, Kapitulli 4 zhvillon këtë koncept

<sup>6</sup> Shih Deklaratën e Mastrihtit dhe përkufizimet e tjera të edukimit global në Kapitullin A, faqe 9

## **NJOHURITË – FUSHA PËRMBAJTJEJE TË SUGJERUARA**

Edukimi global nuk paraqet përmbajtje të re, por pasuron konceptet dhe përmbajtjet e të gjitha lëndëve dhe fushave të arsimit që lidhen me zhvillimet global përmes zgjerimit të dimensioneve të tyre.

### **Njohja e procesit të globalizimit dhe zhvillimet e shoqërisë botërore**

Fokusi i edukimit global është drejtësia shoqërore dhe zhvillimi i qëndrueshëm për t'u dhënë shanse jete më të mirë të gjithëve. Për këtë arsye, fushat e përmbajtjes, nga të cilat edukimi global merr temat, përfshijnë çështje themelore të tilla, si: kushte jetese në nivel lokal dhe në pjesë të tjera të botës, shoqëri shumëkulturore, kontekste shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore, dhuna strukturore dhe e drejtpërdrejtë, ndërvarësia ndërmjet rajoneve, vendeve dhe kontinenteve dhe burimeve të kufizuara natyrore shoqëria e informacionit dhe media.

### **Njohuritë e historike dhe filozofike të koncepteve universale të njerëzimit**

Edukimi global ofron njohur për konceptet e përgjithshme të njerëzimit si: Të drejtat e njeriut, demokracia dhe qeverisja e mirë, ekonomia, drejtësia shoqërore, tregti e ndershme, barazi gjinore, paqe dhe transformimi i konfliktit, qytetaria, diversiteti, dialogu ndërkulturor dhe ndërfaqësor, zhvillimi i qëndrueshëm, shëndeti dhe ushtrimi i barabartë të drejtës për arritje shkencore dhe teknologjike.

### **Njohuri për të përbashkëtat dhe ndryshimet**

Edukimi global siguron njohuri për të përbashkëtat dhe ndryshimet në mënyrën e jetesës, kulturat, fetë dhe brezat. Njerëzit, në të gjitha anët e botës, kanë emocione, gëzime dhe mërzi. Kuptimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve e bën më të thjeshtë respektin ndaj diversitetit.

## **AFTËSI**

### **Të menduarit kritik dhe analiza**

Edukimi global duhet t'i ndihmojë nxënësit të shqyrtojnë çështjet me mendje të hapur dhe kritike, të reflektojnë për to dhe të jenë të gatshëm të rishqyrtojnë opinione e tyre në dritën e fakteve të reja dhe të argumenteve të arsyeshëm. Ato duhet të jenë të aftë të njohin dhe të sfidojnë njëanshmëritë, indoktrinimin dhe propagandën.

### **Ndryshimi i këndvështrimeve ose qasja e këndvështrimeve të larmishme**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të ndryshojnë këndvështrimin e tyre dhe të vështrtojnë situatat në një tjetër këndvështrim.

### **Njohja e stereotipave dhe paragjykimëve negative**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të dallojnë stereotipat dhe paragjykimet negativë dhe t'u kundërvihet atyre me forcë.

### **Kompetencat ndërkulturore në komunikim**

Edukimi global duhet të ndihmojë nxënësit të shqyrtojnë larminë kulturore të gjuhës dhe të kodeve për të mundësuar të kuptuarit e ndërsjellë. Në mozaikun e sotëm kulturor, ne kemi pranuar idenë që çdo grup shoqëror-kulturor, mund të kontribuojë në pasurinë e jetës së komunitetit përmes shkëmbimit të elementeve të identitetit, dialogut dhe përfshirjes së të gjithë anëtarëve të komunitetit të larmishëm kulturor.

### **Puna në ekip dhe bashkëpunimi**

Edukimi global duhet të ndihmojë nxënësi të vlerësojnë bashkëpunimin në detyrat e përbashkëta dhe të punojnë me individët e tjerë dhe grupet për qëllimet e përbashkëta.

### **Empatia**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të kuptojnë pikëpamjet dhe ndjenjat e të tjerëve, veçanërisht të atyre që u përkasin grupeve, kulturave dhe kombësive të ndryshme nga të tyret.

### **Dialogu**

Edukimi global duhet të zhvillojë aftësi për dialog, të tilla si dëgjimi aktiv, respekti për opinioneve të të tjerëve dhe pohimi i vetvetes në mënyrë konstruktive.

### **Vetëbesimi**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të komunikojnë qartë dhe me vetbesim me të tjerët, d.m.th., as me agresivitet që mohon të drejtat e të tjerëve dhe as me pasivitet që mohon vetveten.

### **Trajtimi i kompleksitetit, kontradiktave dhe pasigurisë**

Edukimi global ndihmon nxënësit të kuptojnë karakterin e ndërlikuar të botës, të jenë të vetëdijshëm për kontradiktat dhe pasiguritë dhe të kuptojnë se nuk ekzistojnë vetëm zgjidhje të njëanshme për probleme komplekse.

### **Trajtimi i konflikteve dhe i transformimi i konflikteve**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të përballen me konfliktet dhe t'i trajtojnë ata në mënyrë konstruktive dhe sistematike.

### **Krijueshmëria**

Edukimi global duhet të nxisë imagjinatën për të menduar dhe punuar për çështjet globale në mënyrë krijuese dhe të pëlqyeshme.

### **Kërkimi**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të kërkojnë për njohuri për çështjet globale, duke përdorur burime të ndryshme.

## **Vendimmarrja**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe të ndërmarrin nisma përmes procedurave demokratike.

## **Puna me medien**

Edukimi global duhet të aftësojë nxënësit të zhvillojnë vetëdijen për medien dhe të shqyrtojnë informacionet me mendje kritike.

## **Puna me shkencën dhe teknologjinë moderne**

Edukimi global duhet të pajisë nxënësit me aftësitë e kërkuara për përdorimin e përgjegjshëm të arritjeve të reja shkencore dhe teknologjike.

## **VLERAT DHE QËNDRIMET**

Vlerat themelore u japin mundësi mësuesve të qartësojnë parimet bazë të procesit të të mësuarit, duke i drejtuar ata në zgjedhjen e përmbajtjes, në identifikimin dhe përdorimin e burimeve të informacionit, të planifikimit të strategjive të mësimdhënies, të mësuarit e të vlerësuarit dhe zhvillimi i fushave të ndërhyrjes praktike për nxënësin.

Qëllimi final i edukimit global është të zhvillojë vlera që bazohen në njohjen e çështjeve globale dhe aftësitë që lidhen me to, për të ndërtuar qëndrime për qytetari globale të përgjithshme në nivel individual dhe kolektiv. Këto vlera përfshijnë:

### **Vetëvlerësimi, vetëbesimi, respekti ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve**

Edukimi global nxit nxënësit të zhvillojnë ndjenjën e vlerës dhe krenarisë për veten në mjedisin e tyre të veçantë shoqëror, kulturor dhe familjar. Ai i nxit ata të zhvillojnë ndjenjën e vlerësimit për të tjerët, në mënyrë të veçantë, të atyre me prejardhje të ndryshme nga e tyre.

### **Përgjegjësia shoqërore**

Edukimi global nxit nxënësit të zhvillojnë solidaritetin dhe shqetësimin për më shumë drejtësi shoqërore, botë të sigurt dhe paqësore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **Përgjegjësia ndaj mjedisit**

Edukimi global nxit nxënësit të kujdesen për një mjedis natyror të balancuar, në nivel lokal dhe global

### **Mëndje hapur**

Edukimi global mbështet qasjet e ndryshme ndaj burimeve të ndryshme të informacionit, kulturave dhe ngjarjeve me mendje kritike dhe të hapur.

### **Qëndrime e drejtuara nga e ardhmja**

Edukimi global i nxit nxënësit të zhvillojnë vizione të ndryshme për mundësinë e një bote gjithëpërfshirëse më të mirë në komunitetin tonë, në komunitete të tjera dhe në botën si një e tërë.

### **Anëtarësia komunitare aktive dhe pjesëmarrëse**

Edukimi global fuqizon ndjenjën e të qenit pjesë e komunitetit (lokal dhe global), ku të drejtat e individit dhe kolektivit njihen dhe respektohen nga të gjithë, duke krijuar, në këtë mënyrë, një ndjenjë të mbështetjes së ndërsjellë dhe nevojën për pjesëmarrje në vendimet e përbashkëta, duke mbështetur parimet e pluralizmit, të mosdiskriminimit dhe të drejtësisë shoqërore.

### **Solidariteti**

Edukimi global të çon në solidaritet aktiv. Ai krijon qytetarë të vetëdijshëm të realiteteve globale dhe që përfshihen në punën për një botë më të qëndrueshme, të bazuar në të drejtat e njeriut për të gjithë dhe në dialog dhe bashkëpunim.

## Kapitulli D

# Metodologjia

Metodologjia është një sistem parimesh dhe rregullash që paraprinë dhe analizojnë praktikën, që studion sistematikisht marrëdhëniet ndërmjet metodave dhe teorisë, në çdo shkencë.

Dallimi ndërmjet metodologjisë dhe metodave: Metodologjia, si thelbi i epistemologjisë, është themeli dhe zhvillimi shkencor i metodave, me qëllim që të formulohen bazat për krijimin e metodave të reja të veçanta ose për studimin dhe analizën e atyre ekzistuese. Një metodë është një procedurë e planifikuar që vendos një linjë veprimi të ndërmarrë për të arritur objektivat e përcaktuar të një shkence të veçantë.

Metodologjia në edukim, veçanërisht në edukimin global, është më shumë se një diskutim për metodat e mësimdhënies; metodologjia është një shtyllë e rëndësishme e politikës arsimore. Më shumë se si të mësohet ose si të zhvillosh veprimtari mësimore, metodologjia përfshin të gjitha çështjet e thelbit të arsimit. Në këtë kuptim, përmbajtja e çdo veprimtarie mësimore ka nevojë të lidhet drejtpërdrejt me metodat që do të përdoren në grupin mësimor, për të përmbushur objektivat e veprimtarisë së zgjedhur. Ky pohim bëhet qendror nëse ne pranojmë që çdo veprimtari, në çdo grup mësimor, në arsimin formal dhe jo formal, është zbatim i një konteksti të gjerë ideologjik. Për këtë arsye, çështjet metodologjike duhet të vlerësohen, jo vetëm në lidhje me veprimtaritë e veçanta të të mësuarit, por si kuadër i një procesi të vazhdueshëm të mësuarit, që lidhet me objektivat kryesore të arsimit dhe në ndërveprim dinamik me procesin e vlerësimit.

Nëse ne pranojmë që çdo formë e arsimit ndikon në mënyrën e të menduarit, të veprimit dhe të jetesës së qenieve njerëzore, mund të arrijmë në përfundimin që roli i metodologjisë në arsim është pranë të gjithë diskutimit të për rolin e arsimit në shoqëritë tona. .

## PARIME THEMELORE PËR METODOLOGJINË E EDUKIMIT GLOBAL

Për të reflektuar për parimet e metodologjisë së edukimit global, ne duhet të kthehemi në konceptet kryesore të Deklaratës së Maastricht-it:

***“Edukimi global është edukimi që hap sytë dhe mendjet e njerëzve ndaj realiteteve të botës së globalizuar.”***

Metodologjia e edukimit global duhet të lidhet me realitetet e botës. Kjo do të thotë se ajo është, para së gjithash, e bazuar në realitetin, kontekstin dhe nevojat e grupit mësimor, në realitetin e shoqërisë lokale përreth këtij grupi dhe, më tej, në realitetin e shoqërisë globale që ndikon në realitetet tona lokale dhe në ndërlidhjen mes tyre. Së pari, kjo kërkon të qartësohen konceptet të cilat do të shqyrtojmë dhe pastaj , duke përdorur burime të larmishme, të përshtatura ndaj aftësive dhe karakteristikave të ndryshme të grupit mësimor

(p.sh. moshë, njohja e gjuhës, prejardhja kulturore dhe aftësitë fizike) dhe të lidhura me stilet e të mësuarit.

Objektivat dhe hapat e ndryshëm të veprimtarisë duhet të jenë të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, për të siguruar pjesëmarrjen e secilit, por edhe për të krijuar mundësi të njëjta për të kuptuar realitetet e botës dhe të ndërlikohjes së tyre.

Më poshtë janë disa shembuj që ndihmojnë në reflektimin hap pas hapi të procedurës së të mësuarit:

- *Kush janë njerëzit në këtë grup (mësues dhe nxënës)?*
- *Nga vijnë (prejardhja kulturore etj.)?*
- *Si perceptohet identiteti i tyre kulturor në grup dhe në shoqërinë ku jetojnë?*
- *Përse ndodhen këtu?*
- *Si ndihen në këtë grup?*
- *Si sillen me njeri-tjetrin?*
- *Si reagojnë ndaj sjelljes së mësuesit?*
- *Si ndihet dhe reagon mësuesi ndaj sjelljes së nxënësve, si individë dhe si grup?*

Të kuptuarit e grupit mësimor është kusht i domosdoshëm për të gjithë arsimtarët, veçanërisht kur ata trajtojnë çështjet globale.

Në botën e sotme të globalizuar, identiteti kulturor, personal dhe kolektiv nuk është i dhënë njëherë e përgjithmonë. Për këtë arsye, është e rëndësishme të kuptosh njerëzit në grupin mësimor.

I rëndësishëm është edhe përcaktimi i fushës së dijes me të cilën do të kemi të bëjmë, sipas grupit të të mësuarit.

Po kështu e rëndësishme është edhe mënyra si ne do të trajtojmë dhe do të krijojmë atmosferën e duhur të të mësuarit, si do të ndërtojmë urat e komunikimit dhe të besimit dhe të krijojmë një hapësirë të sigurt dhe të pëlqyeshme për të mësuarit nga dhe me të tjerët, ku secili të ndihet me besim te vetja dhe si pjesë e grupit.

Si do ta arrijmë ne, si mësues, këtë objektiv? Cila është procedura që do të ndjekim?

Përsëri, përgjigja është një pyetje. *A është e mundur të kuptojmë çdo personalitet të ndryshëm dhe të sjellim pjesë të jetës së tij në grup, duke përdorur një metodë, një veprimtari, një mjet?*

Përgjigja mund të jetë e larmishme, veprimtari tërheqëse, pjesëmarrëse, krijuese dhe të përshtatshme që përshijnë të gjithë nxënësit dhe respekti për dëshirat, personalitetin, jetën, prejardhjen kulturore dhe dinjitetin.

Edukimi global frymëzon njerëzit për të sjellë një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta njeriu për të gjithë.

Diskutimi i koncepteve të drejtësisë, barazisë dhe të drejtat të njeriut me njerëzit kërkon metoda që çojnë në të menduarit kritik dhe analizë – procedura kërkimi, veprimtari që bazohen në kërkim, studime, eksplorime dhe hetime. Në të njëjtën kohë, përmbajtja e veprimtarisë mësimore duhet të ketë lidhje me jetën e njerëzve, situatat reale dhe përvojat njerëzore për të rritur vetëdijen e njerëzve për padrejtësinë dhe pabarazinë.



Është e rëndësishme që të njihen dhe të studiohen aktet e drejtësisë, kushtet e barazisë dhe të respektit për të drejtat e njeriut në jetën e përditshme të njerëzve, për të reflektuar për kontekstin që lejon ose krijon vlera të tilla në shoqëritë tona.

Është e qartë që një dialog i vërtetë demokratik ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e të mësuarit duhet të vazhdojnë procesin e eksplorimit kritik dhe krijues të botës, me qëllim që të lehtësohet krijimi i një dije kolektive dhe të kuptuarit të përbashkët të botës në të cilën jetojmë. Integrimi i përbërëve të ndryshëm të sistemeve të vlerave dhe pushtetit dhe diskutimi i ndërvarësisë ndërmjet realiteteve të njerëzve janë të domosdoshëm.

Qasja holistike kërkon të kuptohen marrëdhëniet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta ndërmjet formave të pushtetit, dhunës dhe padrejtësisë në të gjitha nivelet, si dhe vlerat, praktikat dhe kushtet e nevojshme që duhet për t'i kapërcyer ato. Kalimi nga injoranca dhe indiferenca tek njohuritë dhe vetëdija për çështjet globale mund të jetë rezultat e proceseve të të mësuarit që lidhin personalen me kolektiven dhe lokalen me kontekstin global. Kalimi nga njohja dhe vetëdija tek veprimi, për të sjellë një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta njeriu për të gjithë, mund të jetë rezultat i procesit të të mësuarit që kërkon të zhvillojë aftësi kritike dhe të kultivojë aftësinë e nxënësit për të marrë pjesë në një proces të vendimmarrjes kolektive dhe të veprimit për transformime, në nivel lokal, në ata drejtim.

Është po kaq e rëndësishme të lidhen teoria me realitetet shoqërore të së kaluarës dhe të tashmes, për të kuptuar parimet themelore të proceseve historike, në mënyrë që të kuptohet si dhe përse njerëzimi ka mbërritur në këtë situatë komplekse në nivel lokal dhe global dhe të zhvillohen vizionet pozitive të së ardhmes.

## **QASJET METODOLOGJIKE NË EDUKIMIN GLOBAL**

### **Të mësuarit të bazuar në bashkëpunim**

Në të mësuarit në bashkëpunim ekziston ndërvarësia pozitive ndërmjet përpjekjeve të pjesëmarrësve. Ata përqipen për mbështetje të ndërsjellë, kështu që anëtarët e të gjitha grupeve fitojnë nga përpjekjet e njeri-tjetrit. Ndërmjet angazhimit të pjesëmarrësve për të punuar së bashku ekziston ndërvarësi pozitive. Metoda mundëson të mësuarit përmes ndërveprimit, rrit aftësitë e komunikimit të pjesëmarrësve dhe fuqizon vetëvlerësimin.

### **Të mësuarit me bazë problemi**

Metodologjitë që bazohen te problemi nxitin njerëzit të kërkojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve, duke përdorur kureshtjen e tyre natyrore për ngjarje ose tema të veçanta. Pjesëmarrësit ftohen të reflektojnë për çështjet që nuk kanë përgjigje absolute ose zhvillime të lehta, që pasqyrojnë kompleksitetin e situatave botërore reale. Të mësuarit me bazë problemi hap rrugën për një qasje aktive, të orientuar nga detyra dhe e vetëkontrolluar të procesit mësimor.

### **Të mësuarit e bazuar tek dialogu**

Dialogu krijon bashkëbisedim ndërveprues ndërmjet pjesëmarrësve që kërkojnë të nxisin shkëmbimin e ideve. Ai funksionon si urë ndërmjet njerëzve dhe krijon një

hapësirë miqësore për zhvillimin e mendimeve, reflektimeve dhe propozimeve edhe nëse janë të kundërt ose të ndryshëm.

Dialogu ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe të dëgjimit dhe zhvillon të kuptuarit e çështjeve të pikëpamjeve të ndryshme. Ai është një ndër metodat më të rëndësishme të edukimit global.

<b>KRITERE PËR ZGJEDHJEN DHE VLERËSIMIN E METODAVE TË EDUKIMIT GLOBAL</b>			
<b>METODAT E EDUKIMIT GLOBAL DUHET TË JENË:</b>		<b>METODAT E EDUKIMIT GLOBAL</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Interesante</li> <li>• Tërheqëse</li> <li>• Motivuese</li> <li>• Sfiduese</li> <li>• Pjesëmarrëse</li> <li>• Bashkëpunuese</li> <li>• Realiste por Optimiste</li> <li>• Premtuese</li> <li>• Reflektuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtuar në njerëz të ndryshëm</li> <li>• Të ndryshëm por të ndryshueshëm</li> <li>• Me nxënësin në qendër</li> <li>• Krijuese</li> <li>• Ndërvepruese</li> <li>• Demokratike</li> <li>• Dinamike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bazohen në burime të mira</li> <li>• Janë koherente me përmbajtjen e EG</li> <li>• Mos “mëso” por eduko</li> <li>• Rrit vetëdijen</li> <li>• Nxiti dialogun</li> <li>• Japin ndjenjën e qenit pjesë</li> <li>• Rrit përgjegjësinë e secilit</li> <li>• Përfshin njerëzit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Respektojnë nxënësin</li> <li>• Bazohen në vlerat njerëzore</li> <li>• Zhvillon mendimin kritik</li> <li>• Lidh lokalen me globale</li> <li>• Nxiti veprimin</li> <li>• Lidh përmbajtjen me praktikën</li> <li>• Bazohen në mikro – makro</li> <li>• Nxiti vlerat njerëzore</li> </ul>

## **IDE TË RËNDËSISHME PËR ZBATIMIN E EDUKIMIT GLOBAL**

Çështjet e mëposhtme vlerësohen të rëndësishme në arsimin formal dhe jo formal.

### **Përcaktimi dhe kuptimi i grupit mësimor:**

Si në të gjitha format e edukimit, duke mbajtur parasysh situatën dhe prejardhjen e grupit mësimor, kjo është e rëndësishme, ndërsa në edukimin global është thelbësor. Moshë, numri i pjesëmarrësve, diversiteti shoqëror dhe kulturor, në lidhje me temat e zgjedhura, koha, materialet dhe hapësira e vlefshme duhet të merret parasysh në hartimin e programit të edukimit global dhe në zgjedhjen e metodave të përshtatshme. Duke nisur nga konteksti i nxënësit dhe duke eksploruar nevojat e tyre, edhe bashkëpunimi është i rëndësishëm. Kjo është, veçanërisht, e rëndësishme për hartimin e programeve të edukimit global në rastet kur nuk ekziston kurrikul e shkruar për këtë qëllim. Diskutimet që lidhen me të dhe pyetësorët janë metodat më të zakonshme për identifikimin e këtyre nevojave dhe i bazojnë temat dhe veprimtaritë e programeve mësimore në to.

### **Zgjedhja e mjedisit të përshtatshëm të të mësuarit:**

Një mjedis me nxënësin në qendër bazohet në parimin e të mësuarit demokratik, pjesëmarrës, bashkëpunues dhe eksperimental. Në mjedise të tilla ndërvepruese, mendimi kritik, dialogu demokratik dhe shikimi holistik vlerësohen dhe nxiten gjatë gjithë procesit arsimor.

MJEDISI I TË MËSUARIT TË EDUKIMIT GLOBAL DUHET TË JETË:	MJEDISI I TË MËSUARIT TË EDUKIMIT GLOBAL:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Demokratik dhe dialogues</li> <li>• Pjesëmarrës</li> <li>• Mbështetës i kujdesshëm dhe i ngrohtë</li> <li>• I pëlqyeshëm dhe shpresëdhënës</li> <li>• Nxitës dhe frymëzues</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijon vetëbesim</li> <li>• Mbështet të kuptuarit dhe besimin e ndërsjellë</li> <li>• Nxit të mësuarit nga njëri-tjetri</li> <li>• Mund të jetë një mikro univers.</li> </ul>

### Aspekti konceptual:

Konceptet kryesore që lidhen me edukimin global duhet të trajtohen si duhet. Këto koncepte do të formojnë një bazë konkrete të mirë për të bazuar të mësuarit ndërveprues.

### Zhvillimi i mendimit kritik:

Mendimi kritik zhvillohet përmes hapave të ndryshëm dhe niveleve të të mësuarit. Së pari, nxënësit duhet të njohin realitetet për të qenë të vetëdijshëm për shoqërinë globale dhe të zhvillojnë vlerat që lidhen me të drejtën e çdo personi për një jetë në dinjitet. Më tej, ata kanë nevojë për t'i kuptuar ato përmes analizës dhe sintezës. Përkthimi i situatave në realitetin e tyre dhe në jetën e përditshme është shumë i rëndësishëm për këtë të kuptuar.

Analiza e situatës përmes ndarjes së saj në dy pjesë, shtron rrugën për të bërë pyetje të tilla si *çfarë* dhe *pse* në vend të përgjigjeve, për dialogë të bazuar në argumente dhe në mendjen e hapur ndaj të ndryshmes. Sinteza, ribashkimi i pjesëve të ndara në një tabelë formuese të botës është hap i rëndësishëm drejt të kuptuarit të dimensioneve politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të çdo situatë dhe të ndërvarësisë së realiteteve të ndryshme të njerëzve dhe zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë.

Zbatimi i informacionit dhe i njohurive në situatat e reja hap vizione të reja për një botë më të mirë përmes pjesëmarrjes aktive. Vlerësimi i njohurive mbi bazën e kritereve të qarta, të lidhura me rezultatet e analizës dhe sintezës, zhvillon qëndrime dhe aftësi për një qytetar me mendje kritike.

### Nxitja e kureshtjes:

Nxitja e kureshtjes është një pikënisje shumë e rëndësishme për zhvillimin e mendimit kritik. Kryesisht, kjo mund të bëhet më shumë përmes kërkimit të pyetjeve të duhura, se sa përgjigjeve të duhura, të cilat mund edhe të mos ekzistojnë në një botë të pasigurt çështjesh konkrete.

### Nxitja e krijueshmërisë

Nxitja e krijueshmërisë është pikënisje shumë e rëndësishme për zhvillimin e vizioneve dhe mundësive për një botë paqësore dhe të qëndrueshme.

### Qasja mikro-makro:

Format kryesore:


- Nga lokalja tek globalja, p.sh. nga ndotja ose varfëria në zonën tonë në zhvendosimi në dimensionin global të këtyre problemeve dhe kthehemi përsëri në nivelin lokal (*glokalizimi*).

- Nga personalja te kolektivja, p.sh. nga historitë dhe përvojat personale të paraqitura nga pjesëmarrësit në një program shumëkulturash të edukimit global, ne drejtohem në përballjen me problemin e migracionit në një bazë kolektive.
- Nga emocionalja tek e arsyeshmja, p.sh. nga emocionet e ngritura në nivel individual pas një tregimeve për migracionin, ne drejtohem në eksplorimin e aspekteve të përgjithshme të problemit të migracionit.

### Qasja ndërdisiplinore:

Çështjet globale mund të zhvillohen përmes çdo lënde në arsimin formal dhe jo formal. Qasja e hapur që pranon këndvështrimet e ndryshme, mundësohet nga lidhja e të veçantës me të përgjithshmen dhe duke lidhur të dhënat që vijnë nga shkencat e ndryshme. Kjo qasje është e nevojshme për të kuptuar dijen si një sistem i bashkuar dhe për të kuptuar veten dhe të tjerët në një botë komplekse dhe të ndërvarur, ku realitetet e jetëve tonë mund të plotësojnë ose të kundërshtojnë njëra-tjetrën. Zhvendosja nga kultura e individualizmit në kulturën e partneritetit, nënkupton shndërrimin e kritereve personale të një të vërtete të vetme në kritere kolektive të realiteteve të shumëfishtë.

Tre dimensionet e kohës: Marrja parasysh e tre dimensioneve të kohës është shumë e rëndësishme në trajtimin e çështjeve globale. Për shembull, fillimisht ne përqendrohemi në mënyrën si problem shfaqet tek ne sot. Megjithatë, ne kemi nevojë të dimë të kaluarën e tij dhe të eksplorojmë mundësitë për të ardhmen. Në mënyrë skematike:



### Karakteri historik i dijes:

Mbi të gjitha është e rëndësishme të njihet karakteri historik dhe kufizimet e proceseve individuale dhe shoqërore, fazat e ndryshme të zhvillimit të dukurive, lindja dhe shkatërrimi, kufizimet, shterimi i mundësive dhe shkatërrimi i çdo sistemi (ekologjik, shoqëror, ekonomik, politik) për të arritur një kuptim të arsyeshëm të situatës.

### Trajtimi i kundërshtive:

Çështjet globale pritet të jenë kundërshtuese. Për këtë arsye, gjatë trajtimit të tyre nuk duhet të shmanget kundërshtia, por të përballlet në mënyrë të baraspeshuar me synimin e sintezës së pikëpamjeve. Kjo sintezë nuk është gjithmonë e mundur. Për shembull, çështjet që lidhen me fenë mund të jenë shumë kundërshtuese dhe, ndoshta, debati demokratik në lidhje me to, nuk të çon në ndonjë përfundim. Megjithatë, ky debati ka vlerë në vetvete. Çështja e respektimit të kulturave të ndryshme do të diskutohet patjetër në shembujt e

mësipërm. Secili në grup do të kuptojë se ne jetojmë në një botë që ndryshon me shpejtësi, në të cilën ne duhet t'i mendojmë edhe njëherë besimet, vlerat dhe qëndrimet ekzistuese

### **Përballja e çështjeve të identitetit kombëtar dhe kulturor:**

Këto çështje, zakonisht lidhen me migracionit, ksenofobinë, stereotipat dhe të drejtat e njeriut dhe për këtë arsye janë shumë kundërshtuese e duhet të trajtohen me kujdes. Megjithatë edukimi global nënkupton rezistencë ndaj të pandryshueshmërisë së gjendjes ekzistuese (*status quo*), ai, kurrë, nuk duhet trajtuar si rrezik, por gjithmonë, si një sfidë pozitive që mund të pasurojë dhe të zgjerojë identitetin kombëtar dhe kulturor.

### **Njohja me elementet e ndryshimit:**

Ndryshimet konstante dhe, për këtë arsye, të pasigurta dhe të paqëndrueshme, janë realitet i botës sonë. Edukimi global duhet të përgatisë nxënësit e saj të përballojnë këtë realitet dhe të përshtaten pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive. Kjo nënkupton të kërkojë rrugë për arritjen e një lloji baraspeshe ndërmjet qëndrueshmërisë dhe ndryshimit. Për këtë arsye, kërkohet një qasje më tërësore, që të lidhë dimensionet e ndryshme të qenies (fizik, intelektual, emocional dhe shpirtëror) me dimensionet e ndryshme të mjedisit (natyror, shoqëror, kulturor, ekonomik dhe politik).

### **Frymëzimi i optimizmit dhe i kënaqësisë:**

Edukimi global është optimist dhe sjell shpresë. Ka shumë “profetë” modernë, të cilët, në stilin e Kasandrës, duket se parashikojnë fundin e botës. Si ta trajtojmë pesimizmin? Një rrugë pozitive është të vësh theksin te besimi në natyrën njerëzore. Le të kthemi pas, në histori, deri dy tre breza më parë dhe të shohim përparimin që është bërë, për shembull, në sigurimin shoqëror ose në përhapjen e arsimit për të hapur këndvështrime të reja pozitive. Edukimi global duhet të jetë edhe i pëlqyeshëm, një element ky i optimizmit. Edhe humori ndihmon në krijimin e një atmosfere të kënaqshme. Përdorni metoda aktive, të pëlqyeshme që mund të kenë ndikim të madh në zhvillimin e aftësive globale dhe të vlerave që çojnë në veprime.

### **Ndërtimi mbi bazën e përvojave personale ose simulimit:**

Përvojat personale ose simulimet janë forma të të mësuarit nga përvoja. Teoritë pedagogjike thonë se “njerëzit mësojnë më shumë përmes përvojës së tyre, në situata që përfshijnë njohjen, emocionin dhe veprimin”. Veprimtaritë simuluese të edukimit global mund të provokojnë emocione të forta të cilat nuk mund të trajtohen me lehtësi. Kjo është arsyeja përse një mësues duhet të jetë i përgatitur për të trajtuar emocionet e forta dhe ka nevojë të dijë dhe të kuptojë çdo person në grup. Veprimtaritë emocionale duhet të përdoren me shumë kujdes, gjatë një periudhe kohore të programuar mirë, ose si pikënisje ose si pjesë e një programi të tërë. Përndryshe, shumë emocione mund ta largojnë detyrën e grupit nga arsyetimi dhe reflektimi. Metodatat që lejojnë përvojën dhe reflektimin dhe baraspeshon nivelin njohës, emocional dhe veprues janë më të efektshme për të mësuarit në edukimin global.

### **Nxitja e përfshirjes aktive:**

Nxitja e përfshirjes aktive është shumë e rëndësishme për një ndryshim të vlerave dhe qëndrimeve. Veprimtaritë mund të hartohen nga nxënësit, për një grup nxënësish dhe për komunitetin lokal, duke u bazuar në vlerësimin e realiteteve dhe nevojave të tyre. Pjesëmarrësit mund të propozojmë zgjidhje ose të ndër marrin veprime kolektive për të nxitur ndryshime në mjedisin e tyre në nivel mikro (klasë, shkollë, komunitet, fshat etj.), për shembull, duke lidhur arsimin formal dhe organizatat qeveritare (OJF). Me anë të këtyre proceseve, nxënësit mund të mësojnë si pjesëmarrja dhe aftësia për t'u përgjigjur nevojave të tyre kërkon përmirësimin e jetës në komunitet dhe, ka shumë të ngjarë, të çojë në një përkushtim qytetar etik dhe afatgjatë.

### **Rrjetet ndërmjet njerëzve:**

Gjatë ushtrimit të edukimit global, është shumë i rëndësishëm krijimi i lidhjeve me vendet, kulturat dhe shoqëritë e tjera. Këto lidhje nënkuptojnë solidaritet të dukshëm dhe konkret të grupeve që punojnë së bashku. Për shembull, ato mund të ndihmojnë njerëzit në rajonet e zhvilluara që të vlerësojnë fshatin ndaj jetës së qytetit dhe njerëzit në vendet më pak të zhvilluar të kuptojnë që jo të gjithë njerëzit në vendet e zhvilluara kanë lindur me lugë argjendi në gojë. Nga ana tjetër, imigrantët nga vendet e ndryshme janë të pranishëm kudo. Duke i përfshirë ata në procesin e edukimit, ne sjellim zëra të ndryshëm në të, duke dëshmuar aktivisht ndërvarësinë tonë dhe nevojën për solidaritet.

### **Përdorimi i burimeve të shumëfishta:**

Mësuesit që përdorin edukimin global duhet të përdorin larmi burimesh sipas realiteteve të mjedisit të të mësuarit (ku, kur, kush, çfarë dhe përmbajtja dhe konteksti i programit) Shpesh, vështirësitë objektive i fshijnë mundësitë për të zgjedhur burimet. Edukimi global duhet të jetë i ndryshueshëm dhe të përshtatë veprimtaritë e tij ndaj burimeve ekzistuese. Ajo që ka rëndësi në edukimin global është jo mjeti në vetvete, por mënyra si e përdor atë.

### **Përdorimi i medias:**

Marrja e informacionit nga media (shtypi TV, interneti) është pjesë e jetës së përditshme. Edukimi global përmes medias është, njëherazi, mjet dhe qëllim. Është një mjet për shkak të sasisë dhe larmisë së madhe të informacionit, burimeve plotësuese Është qëllim sepse të mësuarit rreth botës përmes burimeve të masmedias është mënyra më e mirë për të zhvilluar vetëdijen medietike, e cila është e domosdoshme për qytetarët e sotëm globalë.

***Përdorimi i medias si qëllim për edukimin global:*** Edukimi për medien lidhet drejtpërdrejt me edukimin global, pasi ai kultivon të menduarit kritik, përmes qasjes kritike ndaj një burimi të veçantë të informacionit (objektiv ose subjektiv, i orientuar nga ana kulturore dhe ideologjike), përmes zbërthimit të shenjave dhe simboleve të informacionit të transmetuar (fjalë, pamje, tinguj etj.) dhe përmes analizës, ndarjes dhe krahasimit të një ngjarje dhe të një situatë reale me një opinion ose koment për to. Edukimi për medien mbështet edukimin global, sepse është i lidhur me lëndët e ndryshme në programet e arsimit formal dhe jo formal. Kusht i domosdoshëm për

përdorimin e medias në çdo lëndë në arsim, është aftësia për të bërë dallimin ndërmjet informacionit dhe njohurisë.

***Përdorimi i medias si burim i edukimit global:*** Përdorimi i informacionit të marrë nga media në një proces të mësuarit, do të ishte me shumë interes në nivelin mikro – të dish diçka për mikro universin që rrethon grupin mësimor, të kuptosh si komuniteti lokal reagon ndaj realiteteve të botës dhe të analizosh si njerëzit, që jetojnë përreth nesh, e perceptojnë informacionin për kontekstin global.

Në nivelin makro, sfida qëndron tek të kuptuarit e ndërvarësisë së botës në të cilën jetojmë. Në edukimin global, mësuesi që përdor median mund të nxisë nxënësit të mësojnë për problemet globale, të jenë kritikë për çdo formë informacioni, të analizojnë stereotipat, të zhvillojnë kulturën e të kuptuarit dhe të jenë qytetarë aktivë. Nxënësit që përdorin median në një proces të mësuarit të edukimit global mund të jenë hulumtues aktivë të informacionit dhe pjesëmarrës bashkëpunues në procesin e zbulimit të njohurive.

***Përdorimi i medias si mjet për të vepruar si qytetar global:*** Përdorimi i medias është sfidë, jo vetëm për të marrë, por edhe për të përhapur informacionin nga grup te komuniteti lokal ose global, nëse grupi kalon nga veprimtaria mësimore në veprim në jetën reale ose në hapësirën virtuale. Media mund të përdoret për të rritur vetëdijen e njerëzve dhe për të bërë të dukshme, te individët dhe kolektivi, veprimet e interesit të përbashkët (p.sh. veprimet e solidaritetit ose të bashkëpunimit për mirëqenien e komunitetit, protestat kundër dhunës, ngjarjet shumëkulturore, veprimtaritë për qëndrueshmëri).

### **Procesi dinamik:**

Veprimtaritë e edukimit global ndjekin një proces të vazhdueshëm përgatitjeje, veprimi dhe reflektimi. Të gjithë pjesëmarrësit e këtij tipi edukimi do të kryejnë vlerësim nevojash, do të zhvillojnë propozime, do të hartojnë plane veprimi dhe do të ndajnë rezultatet e veprimeve të tyre me grupet e tjera. Vlerësimi i brendshëm është një shtyllë e rëndësishme për të gjithë procesin, i bazuar në reflektim dhe e lidhur me objektivat e veprimtarisë. Rezultatet e vlerësimit mund të shërbejnë si pikë nisjeje për rishikimin e veprimtarisë ose të një projekti, për këndvështrime ose plane të reja. Edukimi global nuk është një procedurë e ngurtë, e përsëritshme, por një proces i vazhdueshëm dhe dinamik reflektimi dhe veprimi, pra një praktikë.

## **METODA PËR ZBATIMIN E EDUKIMIN GLOBAL**

Edukimi global, me shtrirjen e gjerë të çështjeve dhe të aspiratave dinamike, ofron shumë mundësi për përdorimin e metodave të ndryshme gjatë vënies së tij në jetë, të themi, nga ato “klasiket” tek ato më “të rejat”. Mësuesit duhet të kujtojnë që metoda është një qasje mësimore, e lidhur drejtpërdrejt me objektivat dhe në koherencë dhe bashkëveprim dinamik me përmbajtjen e çdo çështjeje dhe veprimtarie. Ajo që ka rëndësi, nuk është vetëm njohuria, por procesi me anë të të cilit nxënësi mëson si të mësojë.

E rëndësishme në edukimin global është se, në çdo rast, ne përdorim propozimet metodologjike të paraqitura më sipër. Kështu, një mjedis me në qendër nxënësin, në përgjithësi, përjashton metodën shumë “klasike” të një leksioni të zgjatur, që u drejtohet nxënësve pasivë, edhe në rastin kur, në këtë leksion, përdoret teknologjia moderne. Në mënyrë të ngjashme, fletët e punës nuk mund të jenë shumë të efektshme nëse ato bazohen në tekste të gjata e të thata shkencore, të ndjekura nga pyetje të shumta “akademike” që kërkojnë përgjigje individuale. Nga ana tjetër, tregimet (e treguara ose të dhëna në formën e vizatimeve), të shoqëruara nga disa pyetje frymëzuese, mund të motivojnë më shumë nxënësit për të kërkuar përgjigjet në grup dhe për të diskutuar aspekte të çështjeve globale, në një mjedis pjesëmarrës, bashkëpunues, praktik dhe , mbi të gjitha, të të mësuarit demokratik.

Në këtë mënyrë, mirëpritet çdo gjë ndërvepruese: veprimtaritë akull thyese dhe nxitësit e tjerë, veprimtarisë simuluese dhe lojërat, loja me role, dhënia e mendimeve, ushtrimet e zgjidhjes së problemeve, debatet, diskutimet e grupit, diskutimet në tryezë të rrumbullakët ose në panel, ushtrimet për diskutime në çift, shkëmbim përvojash, hulumtim dhe prezantim, vizita studimore, arte pjesëmarrëse, studim rasti, veprimtari artistike që përfshijnë muzikë, vallëzim dhe veprimtari të bazuara në tregime ose përralla, arte pamore/ikonografi (foto, filma, kolazhe, vizatime etj.). Për këto ka shumë metoda dhe mësuesit e trajnuar e dinë këtë. Sot ekzistojnë shumë materiale të shtypura dhe online, të siguruar nga organizatat Evropiane dhe ndërkombëtare, të cilat përshkruajnë shembuj konkretë dhe ide për këto metoda.<sup>7</sup>

Në të gjitha këto, mesazhi kryesor duhet të jetë një, që vendi ku ushtrohet edukimi global, në mënyrë metaforike, duhet t'i ngjajë një hoje bletësh, ku të gjitha ato kanë një rol që duhet ta luajnë për një qëllim të caktuar., me të vetmin ndryshim që mësuesi nuk është një mbretëreshë autokratike.

Kuptohet që në rastin e arsimit jo formal, që lidhet me grupet e rinisë ose të të rriturve, duhet t'i kushtohet kujdes rolit të mësuesit, i cili duhet t'i ngjajë një drejtues orkestre, në të cilin ai dhe lojtarët, në mënyrë demokratike, vendosin për detajet e programit të tyre si dhe rolet individuale dhe kolektive për të arritur harmoninë e simfonisë!

## **MËSUESIT, NXËNËSIT DHE AUTORITETET ARSIMORE PËRBALLEN ME METODA TË REJA**

Mësuesit veprojnë jo vetëm si anëtarë të një sistemi arsimor, por edhe si individë dhe anëtarë të një shoqërie që ndryshon në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, shpesh herë, metodat e reja në arsim shfaqen si rezultat e një procedure që fillon nga poshtë. Mësuesi i edukimit global, duhet të zhvillojë metodat e tij, duke u bazuar në njohuritë, aftësitë, trajnimet, personalitetin, vetëbesimin, idetë dhe motivimet e tij. Si rrjedhojë e vetëvlerësimit, të lidhur me një qasje kritike ndaj metodave tradicionale të përdorura në arsim ose si një nevojë njerëzore për zhvillim dhe përmirësim, shumë mësues kërkojnë metoda të reja, që i përgjigjen sfidave të jetës së përditshme. Ndonjëherë edhe nxënësit kërkojnë metoda të reja, krijuese dhe kritike ndaj atyre tradicionale. Por shpesh, të paktën në arsimin formal, mësuesit, megjithëse kërkojnë metoda të reja përmes një programi trajnimi të ofruar nga autoritet arsimore, në fakt, kërkojnë vetëm mjete. Dhe shpesh, autoritetet ofrojnë mjete ose pajisje të reja dhe kërkojnë që, përmes përdorimit të tyre, të

---

<sup>7</sup> Shih faqen e North-South Centre [www.nscentre.org](http://www.nscentre.org), education link



ndryshohet metodologjia dhe të rritet “efektshmëria” e mësimit, pa reflektuar për koherencën ndërmjet mjeteve, metodave, qëllimeve dhe përmbajtjes (çfarë, pse, si). Për këtë arsye, qartësimi i rolit dhe i rëndësisë së metodave të reja, me ose pa mjete dhe pajisje, është një tjetër sfidë për edukimin global.

## **PRAKTIKA TË REKOMANDUARA**

### **a) Metoda projekt**

Puna për një temë të përbashkët globale, ose për aspekte të saj, është detyrë shumë krijuese për nxënësit në sektorin formal dhe jo formal. Puna mund të përfshijë disa elemente, si tekstet informative, poema ose proza, fotografia, vizatimi, karikaturat, kartonët, pjesë nga gazetatat ose revistat, kolazhet, një gazetë klase, muzika, loja me role dhe produktet pamore ose një CD-ROM. Edhe në rastet kur projektet realizohen individualisht, ato duhet të kenë një dimension kolektiv, që përfshin një prezantim final, diskutim dhe vlerësim nga klasa. Megjithatë, do të ishte më mirë nëse do të ishte rezultat i një pune në ekip, ku pjesëmarrësit mund të kontribuojnë me disa ose me të gjithë elementet e mësipërme, sipas interesave dhe talenteve të tyre. Edhe puna në terren është e mirëpritur, duke filluar, ku është e mundur, nga situatat lokale. Rezultati përfundimtar mund të jetë një ekspozitë për të gjithë projektin në vendin ku është krijuar ose në nivelin e komunitetit lokal.

Java e Edukimit Global, si ngjarje e përvitshme e iniciuar dhe e koordinuar nga Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës, ofron shanse të mëdha për projekte të tilla.<sup>8</sup>

### **b) Metoda e lidhjeve botërore**

Kjo metodë mund t'i japë përmbajtje të parës. Si u shprehëm më lart, sjellja e realitetit global në klasë (ose në një hapësirë tjetër të mësuarit) për pjesëmarrje aktive është shumë e rëndësishme për programet e edukimit global në sektorin formal dhe jo formal.

Kjo mund të bëhet:

- duke ftuar njerëz nga vende të tjera në proceset arsimore ose duke vizituar vetë, kur është e mundur, vende të tjera;
- duke krijuar lidhje dhe rrjete me njerëz nga pjesë të ndryshme të botës përmes korrespondencës postare ose asaj elektronike;
- duke ftuar vizitorë nga kultura të ndryshme, p.sh. imigrantë që jetojnë në vendin tuaj, në sallën e mësuesve, në klasat e shkollës ose në vendin e programit jo formal të edukimit global;
- duke organizuar ngjarje shumëkulturore, festa, ekspozita ose veprimtari të tjera në shkollë ose vende publike dhe duke përfshirë njerëz të kulturave të ndryshme në veprimtari të tilla, duke përfshirë stile të ndryshme të ushqimit, muzikës, vallëzimit dhe ndoshta dramës;
- duke përfshirë nxënësit në veprimtari që synojnë të ndihmojnë njerëzit në nevojë ose në punë vullnetare të nisur nga organizata joqeveritare, veçanërisht në arsimin formal;

---

<sup>8</sup> Shih faqen e internetit e Qendrës Veri-Jug: [www.nscentre.org](http://www.nscentre.org), education link

- duke organizuar takime me mësues, nxënës dhe prindër për sesione të mësuarit për temat shumëkulturore.

#### c) **Partneriteti shkollor ndërkombëtar**

Kjo praktikë plotëson të mëparshmen. Janë me qindra lidhjet e dyanshme ndërmjet shkollave jugore dhe veriore dhe lindore dhe perëndimore. Disa organizata ndërkombëtare të lidhjeve shkollore janë në proces të ndërtimit të trekëndëshave dhe rrjeteve të lidhjeve shkollore, që ofrojnë faqe interneti, ide, përvoja të shkruara dhe raporte. Në pjesën më të madhe të vendeve Evropiane, ekzistojnë agjenci kombëtare ose organizata jo qeveritare që sigurojnë mbështetje për shkollat që janë të interesuara në partneritete shkollore ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë, partneriteti shkollor veri-jug ofron shumë mundësi për edukimin global.

Nga pikëpamja jonë, këto partneritete mundësojnë:

- Kuptim më të mirë të ndërvarësisë globale përmes kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet nxënësve dhe mësuesve në vendet dhe shkollat partnere.
- Kapërcim i stereotipave dhe paragjytimeve të ndërsjella.
- Rritje të motivimit të nxënësve dhe mësuesve.
- Kulturë të re të mësimdhënies dhe të mësuarit, p.sh. përmes lidhjeve prerjeve lëndore të mësimdhënies.
- Zhvillim i mëtejshëm i kompetencave kyç për të gjithë të përfshirët, p.sh. teknologjitë moderne të komunikimit, menaxhimit të projekteve, aftësive të gjuhëve të huaja, komunikimi ndërkombëtar ndërmjet nxënësve dhe mësuesve.

Nga pikëpamja metodologjike, partneriteti shkollor veri-jug ofron shumë mundësi për veprimtari konkrete në klasë si:

- shkëmbi mi i letrave (me shkrim dore, e-mail)
- ngritja dhe përdorimi i faqe ndërvepruese (duke përfshirë forume diskutimi dhe bisedimi)
- shkëmbimi i rezultateve të punës me projekte me partnerët e shkollës
- ftesa për në klasë e një eksperti nga vendi i shkollës partnere, i cili jeton në fshatin ose në qytetin tuaj
- planifikimi i vizitave të ndërsjella ndërmjet shkollave partnere.

#### d) **Konkurrimet debati**

Konkurrimet e debatit janë një metoda shumë tërheqëse, përmes së cilës nxënësi në arsimin formal dhe jo formal mund të vetëdijësohet për çështjet bashkëkohore të edukimit global. Ato mund të organizohen në nivel grupi, shkollë, lokalitetit, kombi ose botëror, në varësi të mundësive financiare.

*Qëllimet e konkurrimet:*

- Të zhvillojë aftësitë folëse dhe argumentuese të bazuara në mendimin kritik.
- Të rrisë ndjeshmërinë e nxënësve për çështjet ndërkombëtare dhe t'i drejtojë në ngritjen e pyetjeve përmes eksplorimit të këtyre çështjeve
- Të kultivojë një mendje kritike.

- Të bëjë nxënësin marrës kritik i mesazheve dhe të zhvillojë rezistencë kritike ndaj manipulimeve.

*Kriteret e vlerësimit:*

- Përmbajtja (bindja, argumenti, niveli i rrjedhshmërisë së të folurit)
- Paraqitja e përgjithshme (zëri, postimi i trupit, gjestet, shprehja)
- Koha (qëndresa deri në kufijtë e kohës në dispozicion)

*Komente të përgjithshme*

Elementi më i rëndësishëm në këtë lloj konkurrimi nuk është fitorja por pjesëmarrja. Pjesëmarrësit duhet të kuptojnë se vlera qëndron në nxitjen e vetë udhëtimit, jo në pikëmbërritjen e tij. Përmes këtij udhëtimi ata fitojnë përvojë dhe njohuri që i zhvillon ata si qytetarë të ndriçuar globalë.

#### e) **Artet pjesëmarrëse**

Artet pjesëmarrëse (AP) luajnë rolin e një pikë lidhjeje, ku lehtësuesi (artist ose persona të tjerë me prejardhje të veçantë) dhe jo artistët bashkëveprojnë duke përdorur rregullat dhe instrumente të veçantë për të luajtur. Kjo përvojë arsimore kolektive i çon pjesëmarrësit në një lloj tjetër vetë përmirësimi duke nxitur parimet që krijojnë një hapësirë rehatie fizike dhe mendore. Në këtë hapësirë, arsimtarët (trajnerë, mësues, psikologë, artistë) dhe nxënësit do të punojnë së bashku në partneritet të bazuar në respekt dhe dinjitet. Kjo veprimtari artistike trajnuese vjen si përgjigje nevojave të grupit, të identifikuara më parë dhe të vendosura përmes procedurash të veçanta. Në lidhje me qëllimet arsimore në artet pjesëmarrëse, procesi është i rëndësishëm sa edhe vetë rezultati përfundimtar (loja, ndodhia, grafitet, teatri shoqëror etj.).

Metodat AP do të shkrijnë çdo frenim dhe do të zëvendësojnë atë me kënaqësinë për mundësinë për pjesëmarrje dhe arritjet personale.

Forumi – teatri, si AP është një metodë në kontekste të ndryshme dhe për probleme të ndryshme, që përballin grupe të ndryshme, me interesa të ndryshme, që vijnë nga kategori të ndryshme socio-profesionale.

Trajnerët përdorin AP si një rrugë e efektshme për të nxitur përfshirjen në nivel shoqëror, politik dhe arsimor. Metoda bazohet në gjuhën e teatrit dhe në hapësirën estetike për të nxitur ndërveprimin e të gjithë pjesëmarrësve. Ata bëhen spektatorë dhe aktorë, të bashkuar në eksplorimin, analizën dhe rishqyrtimin e pjesës më të madhe të problemeve të grupit të cilit i përkasin.

Si fillim, ne tregojmë një skenë që përmban një problem (model) që do të tregojë veprime si nxitëse dhe do të bëjë spektatorët dhe aktorët të përgjigjen dhe të përpiqen të gjejnë zgjidhje ose alternativa të mundshme duke zëvendësuar personazhin kryesor ose të tjerët, duke sjellë zhvillime të reja për veprim. Skena/problemi model duhet të përmbajë, të paktën një qasje të papranueshme (dhunë, diskriminim, mospjesëmarrje etj.) që duhet të ndryshojë dhe të zëvendësohet nga pjesëmarrësit.

Forumi ka treguar të jetë i dobishëm në analizën e situatave, edhe nëse zgjidhje të mundshme nuk janë zhvilluar deri në fund. Megjithatë, qasjet pozitive janë një rezultat i kënaqshëm. Në çdo rast, debati, forumi dhe vetë procesi janë më të rëndësishëm se zgjidhja

e propozuar, sepse përballja e thjeshtë e ideve dhe shkëmbimi i arsyesve dhe argumenteve nxisin dhe trajtojnë pjesëmarrësit për veprim në jetën reale. Simulimi i forumit do të jetë një zgjidhje e vlefshme për jetën reale.

#### f) **Të mësuarit në komunitet**

Kjo teknikë përfshin shërbim komunitar dhe reflektim për këtë shërbim. Ai ushqen përgjegjësinë shoqërore dhe angazhimin ndaj realitetit më të afërt. Të mësuarit në komunitet mund të përdoret për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë në çështje të veçanta ose të mësojnë si t'i transferojnë në situata të veçanta. Kjo ka të bëjë me idenë e veprimit praktik që lidhet me procesin e ndërtimit të njohurive. Përmbajtjet mësohen jo vetëm nga qasja teorike, por edhe nga një vlerë e shtuar që vjen nga një përbërës i ri – puna në terren dhe praktikat që thellojnë konceptin e mësuar në teori nga emocionet e forta të provuara në realitet.

Të mësuarit në komunitet është një praktikë e shkëlqyer në të mësuarit e edukimit global, që siguron informacion dhe zhvillimin e aftësive për trajnimin në “situata reale” të jetës së përditshme dhe shoqëri”<sup>9</sup>

#### g) **Të mësuarit nga të jetuarit së bashku**<sup>10</sup>

*Praktikat e përvojës*

**Ato përfshijnë karakteristikat e mëposhtme:**

- nxënësit ndjekin kureshtjen dhe interesin e tyre
- ata mësojnë përmes përvojës së drejtpërdrejt (të mësuarit duke bërë)
- mësuesi është më shumë lehtësues ose ndërmjetës se i vetmi burim të njohurive
- nuk ka vlerësim zyrtar të të mësuarit
- nxënësit reflektojnë për të mësuarit e ardhshëm.

*Praktikat bashkëpunuese*

**Ky është të mësuarit shoqëror dhe ndërveprues, ku proceset e grupit sundojnë mbi të mësuarit individual.** Në këtë këndvështrim, veprimtaritë e EG kanë nxitur zhvillimin e aftësive të tilla si:

- vendosja e një qëllimi të përbashkët
- të punuarit në grup
- caktimi i roleve për çdo anëtar grupi
- caktimi i përgjegjësive të përbashkëta
- rregullojnë ndarjen e punës
- caktimi i burimeve të përbashkëta
- krijimi i aftësisë për të mësuar nga njëri-tjetri.

*Praktikat ndërkulturore*

**Shumë faqe të internetit të EG nxisin këtë formë të të mësuarit, që bazohet në dy parime**

- relativizmi kulturor, sipas të cilit nuk ka hierarki kulturash (një kulturë nuk mund të përdoret për të gjykuar veprimtaritë e kulturës tjetër).

<sup>9</sup> Për më shumë informacion, Të mësuarit në shërbim: Mësime, Plane, Projekte, Programi i Edukimit për të Drejtat e Njeriut, Amnesty International & Shoqata për Edukimin e të Drejtave të Njeriut, HREA, Mars, 2007

<sup>10</sup> Delors, J. *Apprendre. Un trésor est caché dedans.* Paris, Ed. Odile Jacob, 1996

- karakteri i ndërsjellë, domethënë ndërveprimi dhe kryqëzimi i informacionit për kulturat në kontekstin e shoqërive të larmishme nga ana kulturore.

Duke pasur si pikënisje këto dy parime bazë, të mësuarit ndërkulturor i zhvilluar nga faqja e Edukimit Global kërkon të përmbushë dy qëllime:

- Kapërcimi i etnocentrizmit
- Fitimi i aftësisë për empatinë me kulturat e tjera
- Zhvillimi i mjeteve të bashkëpunimit ndërmjet kufijve kulturorë dhe në një mjedis të larmishëm nga pikëpamja kulturore.
- Fitimi i aftësisë për të komunikuar ndërmjet kulturave kufitare, për shembull, përmes dygjuhësisë.
- Formimi i një identitetit të ri kolektiv që shkon përtej ndryshimeve kulturore individuale.

*Praktikat vepruese*

**Ky është një proces i orientuar nga qëllimi, i organizuar si një rregull në formën një projekti, me rezultate të përcaktuara.** Për të realizuar projektin, trajnerët/mësuesit duhet:

- Të formulojnë qartë qëllimet e tyre.
- Të ndihmojnë nxënësit të zgjedhin strategjitë e tyre të të mësuarit.
- Të motivojnë nxënësit për të marrë përsipër përgjegjësitë për të mësuarit e tyre.
- Të zhvillojnë një projekt konkret që mund të realizohet tërësisht nga nxënësit
- Të mbështesin rritjen graduale të pavarësisë së nxënësve.
- Të lejojnë nxënësit të kuptojnë veprimet e tyre përmes reflektimit (të mësuarit nga praktika reflektuese)

*Praktikat në kontekst*

**Kjo nënkupton integrimin e vazhdueshëm të të mësuarit të një individi në sistemin e referencave kulturore dhe qytetare të grupit, të komunitetit ose të shoqërisë me të cilën ai identifikohet.** Për të nxitur këtë të mësuar, aktorët e përfshirë në projekt duhet të përqendrohen në pikat e mëposhtme:

- Të ndihmojnë nxënësit për të kuptuar tablonë e përgjithshme të qëllimeve dhe të strategjive.
- Të nxisin nxënësit dhe të qartësojnë vlerat dhe identitetet që ata marrin.
- Të përdorin përvojat dhe njohuritë paraprake të nxënësve.
- Të lejojnë nxënësit të arrijnë në përfundime vetë.
- Të kultivojnë vizionin global të shoqërisë

#### **h) Sportet**

Sportet mund të nxisin dhe zhvillojnë barazinë, pjesëmarrjen dhe përfshirjen si dhe të rrisin vlerat shoqërore dhe qëllimet e individëve të tilla si puna e palodhur, loja e ndershme, zhvillimi i karakterit dhe i punës në ekip. Pjesëmarrja në sporte ka treguar të krijojë prirjen për të marrë role drejtuesi. Sportet zhvillojnë kohezionin shoqëror dhe të kuptuarit dhe respektin e ndërsjellë. Për këtë arsye, ato mund të përdoren për të komunikuar mesazhe të të kuptuarit të diversitetit dhe të ndihmojnë në gjetjen e mjeteve jo të dhunshme për të përballuar situatat e vështira.<sup>11</sup>

<sup>11</sup> Më shumë për sportet si metodë në : <http://www.toolkitsportdevelopment.org>

Edukimi global duhet të regjistrojë veprimtaritë sportive si një burim kryesor, i bazuar në interesat dhe entuziazmin që ato krijojnë te fëmijët dhe rinia dhe mundësitë që ky interes hap për krijimin e hapësirave për dialog, kërkim dhe studim të grupet të karakteristikave të larmishme kulturore, fetare dhe etnike të botës së globalizuar.<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> Birzea, César. Edukimi për qytetari demokratike : *një këndvështrim i të mësuarit gjatë gjithë jetës* Council for Cultural Co-Operation (CDCC). Council of Europe, Strasbourg, June 2000

## KRITERE PËR PLANIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E EDUKIMIT GLOBAL

Si e kemi thënë edhe më sipër, në edukimin global përdoren një numër i madh dhe i larmishëm metodash dhe materialesh, sikurse janë të mëdha edhe mundësitë për mjedise dhe veprimtari arsimore.

Për t'ju ndihmuar në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprimeve që bazohen në metodologjinë e edukimit global, po ju ofrojmë pyetjet e mëposhtme:

### 1. Qartësimi i qëllimeve

- Cili është **mesazhi** që unë dëshiroj t'ia jap grupit tim të synuar në fund të veprimit?
- Cilat janë **qëllimet** (në numër pjesëmarrësish dhe strategjish) për veprim?
- **Procesi** i organizimit të veprimit të edukimit global, shpesh herë, është më i rëndësishëm se rezultati!

### 2. Përfshirja e partnerëve dhe e të interesuarve

- **Kush** (kolegë, ekspertë, organizata) mund të jenë partnerë në organizimin e veprimit të edukimit global?
- A është e mundur të përfshihen njerëz nga **kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore** (p.sh. komunitete, grupe fetare)?
- **Si** dhe në **çfarë forme** mund të përfshihen të gjithë partnerët në planifikimin dhe zbatimin e veprimit të edukimit global?
- **Cili** është roli që duhet të luajnë partnerët e ndryshëm? A kanë ata **aftësinë** që kërkohet për detyrën e tyre?
- Si është organizuar **procesi i bashkëpunimit**? A ekziston atmosfera e respektit dhe e bashkëpunimit pjesëmarrës?
- A është e sigurt që të gjithë **partnerët mund të identifikohen** me procesin dhe rezultatet?

### 3. Formati i veprimit

- A ekziston një **marrëdhënie e duhur ndërmjet përmbajtjes dhe tipit/formës së veprimit**?
- A e mundëson tipi/forma e veprimit **përfshirjen aktive** të pjesëmarrësve?
- A janë të përshtatshëm **vendndodhja dhe mjedisi** i veprimit të edukimit global?

#### 4. Logjistika

- **Planifikimi kohor:** A është planifikuar paraprakisht veprimi i edukimit global? A është zgjedhur si duhet data e veprimit (ditë jave, e lidhur me veprimtari të tjera në të njëjtën ditë)
- **Buxheti:** A është i nevojshëm financimi ose sigurimi i fondeve nga jashtë (p.sh. qira salle, pagesa etj.)
- **Burimet njerëzore:** A ekziston mbështetja e duhur nga njerëzit për veprimin?

#### 5. Marrëdhëniet me publikun dhe medien

- Çfarë lloj informimi paraprak (p.sh. fletë palosje, afishe, radio, TV) është planifikuar të bëhet për veprimin e edukimit global?
- A është e mundur të përfshihet **media lokale, rajonale** ose **kombëtare** në këtë informim paraprak?

#### 6. Qëndrueshmëria

- Çfarë **dokumentacioni** është planifikuar (për pjesëmarrësit)?
- A pritet ndonjë veprim tjetër si vazhdim?

#### 7. Vlerësimi

- Çfarë **vlerësimi** është planifikuar për veprimin?
- A është planifikuar të vlerësohet **puna në grup**?



## KRITERE PËR PËRZGJEDHJEN DHE VLERËSIMIN E BURIMEVE

Më sipër përmendëm se nuk ka një metodë për të gjithë grupet e synuara. Po kështu, jo të gjitha burimet mund të përdoren për të gjitha grupet mësimore, dhe burimet nuk mund të përdoren në të njëjtën mënyrë me një grup tjetër ose në kushte të ndryshme. Këto duhet të mbahen parasysh sa herë që dëshirojmë të zgjedhim burimet që do të përdorim në një mësim të caktuar.

Megjithatë, disa kritere për përzgjedhjen e burimeve të vlefshme për edukimin global mund të rekomandohen për të gjithë ata që praktikojnë edukimin global në sektorin formal dhe jo formal. Kritere të ngjashme mund të përdoren për të vlerësuar burimet në lidhje me synimet e edukimit global dhe në përputhje me ndikimin në grupin mësimor. Sigurisht, si arsimtarë, ne nuk duhet të shpresojmë të gjejmë burime me të gjitha karakteristikat e përmendura më sipër, sepse përndryshe, ne asnjëherë nuk do të vendosnim të testonim ose t'i zbatonim ato.

### I. Përdorimi i një burimi me grupin mësimor

Zgjidhni burimet tuaja në përputhje me:

- Me **moshën e grupit** të nxënësve- jo shumë e thjeshtë, jo shumë e ndërlikuar, jo shumë fëmijore, jo shumë serioze.
- Me **nivelin gjuhësor** të nxënësve – nëse ata nuk kuptojnë udhëzimet e burimeve, nuk mund të marrin pjesë. Nëse udhëzimet janë shumë të thjeshta, ata do të mendojnë se ju nuk i vlerësoni të aftë ose në moshën e duhur për të përdorur burimet.
- Me **aftësitë** e të gjithë nxënësve, në mënyrë të veçantë në grupet e përziera. Nuk është e dobishme të provosh një burim, nëse nuk jeni të sigurt që nxënësit mund ta bëjnë këtë.
- Me **diversitetin kulturor** të grupit – jo shumë të orientuar ndaj një kulturë specifike, veçanërisht nëse grupi është i larmishëm nga ana kulturore, pasi nxënësit mund të mos e kuptojnë ose të keqkuptojnë përmbajtjen.
- Me **interesat** e grupeve – një burim i cili është shumë interesant për arsimtarin ose trajnerin mund të jetë i mërzitshëm për nxënësit.

### 2. Formati

Nëse një burim është një paketë ose një mjet, i madh ose i vogël, një pjesë ose shumë pjesë, ne duhet të kontrollojmë nëse është:

- I paketuar me lehtësi
- I transportuar me lehtësi me dorë ose në një valixhe
- I hapur me lehtësi, gati për përdorim.
- I përdorur me lehtësi në hapësirën e siguar me qëllim

- I zbatuar me lehtësi në kohën e veprimtarisë

Nëse burimi është në formatin elektronik ne duhet të kontrollojmë nëse:

- ka pajisje (kompjuter, lidhje interneti etj.) në mjedisin mësimor
- formati është i pajtueshëm me njësinë për veprimtarinë
- burimi mund të instalohet shpejtë dhe me lehtësi
- të dhënat janë të arritshme me lehtësi nga të gjithë

### 3. Formati dhe përmbajtja

Një burim i mirë:

- mund të përdoret në situata të ndryshme
- mund të përshtatet në situata të ndryshme
- mund të ndryshohet me lehtësi, nëse është e nevojshme
- mund të përkthehet me lehtësi në një gjuhë të huaj, nëse është e nevojshme

### 4. Përmbajtja

Një burim i edukimit global:

- ngre çështje për diskutim për tema të edukimit global
- provokon pyetje për pikëpamjet stereotipa
- jep këndvështrime realiste por pozitive
- përfshin këndvështrimet e të tjerëve
- përmirëson mjedisin e të mësuarit

### 5. Objektivat dhe pritshmëria

Një burim i mirë **gjatë** veprimtarisë

- sfidon mësuesin dhe grupin mësimor për ta përdorur atë
- ndihmon mësuesin të arrijë objektivat e tij në mënyrë më interesante dhe nxitëse
- ndihmon nxënësit të përmbushin objektivat dhe të ndërtojnë njohuritë
- i përgjigjet pritshmërisë të mësuesve dhe nxënësve, por mund t'i befasojë ata në mënyrë të këndshme
- Nxit krijueshmërinë
- Përputhet me përmbajtjen dhe kontekstin e veprimtarisë

Një burim i mirë **pas** veprimtarisë:

- shton oreksin për të mësuar më shumë
- nxit ide për veprimtari të reja
- frymëzon përdorimin e një burimi tjetër të edukimit global
- ndihmon në zhvillimin e pikëpamjeve kritike (pozitive ose negative) për burimet e tjera
- ndihmon në vendosjen e kriterëve për përzgjedhjen e burimeve
- aftëson nxënësit dhe mësuesit për të reflektuar dhe përmirësuar metodologjinë e tyre të të mësuarit.

## **6. Ndikimi**

Një burim i mirë është i pëlqyeshëm:

- Mund të jetë i këndshëm ose serioz
- Mund të përmbajë ide të thjeshta ose të ngatërruara
- Mund të bëjë për të qeshur ose për të qarë
- Por me siguri nxit reflektimin kritik

## **7. Si ta përdorim atë**

Një burim i edukimit global:

- nxit pjesëmarrjen
- mund të përdoret nga të gjithë
- paraqitet në mënyrë që respekton përdoruesin
- zgjon krijueshmërinë e përdoruesit
- kërkon ndërveprim
- tregon si të kujdesesh për të

## **8. Përpara se të zgjidhet një burim**

- Nëse është e mundur, merrni mendimin e mësuesve që e kanë përdorur atë. Por mos harroni se përdorimi i të njëjtit burim, nuk është kurrë njëloj, sepse ai varet nga kushtet e ndryshme të të mësuarit dhe faktorët e paparashikuar.
- Për ta testuar nëse funksionon, provojeni fillimisht në grupe të vogla. Nëse diçka shkon keq, është më e volitshme të ndryshohen planet për grupet e vogla se sa për grupet e mëdha.
- Vëreni veten në vendin e nxënësit dhe mendoni nëse do të dëshironit të mësoni nga ky burim.
- Llogarisni koston e burimeve dhe buxhetin e nevojshëm për të gjithë projektin.

## **9. Pas përdorimit të një burimi:**

- Mendoni nëse iu ndihmoi të arrini objektivat tuaja
- Reflektoni për çështjet e ngritura
- Matni ndikimin në grupin tuaj mësimor
- Gjeni vlerën e shtuar të veprimtarisë suaj nga pikëpamja e çështjeve të edukimit global.

## KRITERET PËR HARTIMIN E KURRIKULËS PËR MJEDISËT FORMALE DHE JO FORMALE

Ajo që është e nevojshme të qartësohet dhe të pranohet është se hartimi i kurrikulës për edukimin global nuk nënkupton krijimin e një lënde të re, të veçantë, në kurrikulën e re ose ekzistuese. Së pari, sepse edukimi global nuk mund të kufizohet në një lëndë të vetme, veçanërisht, nëse e gjithë kurrikula ndjek drejtime të tjera, në varësi të objektivave arsimorë. Së dyti, edukimi global nuk mund të kufizohet në vullnetin e izoluar të një mësuesi, koordinatori ose vendimmarrësi, veçanërisht, nëse të gjithë të tjerët nuk janë të interesuar. Së fundi, edukimi global, në thelb, është një këndvështrim kroskurrikular, që nxit integrimin e çështjeve globale në një program arsimor dhe aftëson mësuesit të trajtojnë çështje të tilla përmes lëndëve të tyre.

Kriteret për hartimin e kurrikulës së edukimit global mund të vendosen në dy boshte: a) kriteret për përmbajtjen e vetë kurrikulës dhe b) kriteret për procedurat e ndjekura gjatë hartimit të kurrikulës. Sigurisht, të dy boshtet duhet të përputhen me qëllimet e edukimit global.

### **MOS HARRONI SE NJË BURIM ËSHTË THJESHT NJË BURIM. PËRFITIMI NGA BURIMI VARET:**

- Si e përdor atë
- Sa kohë e përdor atë
- Sa shpesh e përdor në të njëjtin grup
- Si pritet nga grupi
- Çfarë keni arritur pasi e keni përdorur atë

### **Kriteret për përmbajtjen e kurrikulës së EG**

Përmbajtja e kurrikulës përshin jo vetëm çështjet e njohëse dhe etike, por edhe ato metodologjike të përshkruara më parë. Kjo do të thotë se, para së gjithash, këndvështrimi i edukimit global duhet të përshkojë të gjitha aspektet e procedurave të të mësuarit, për shembull, mjedisin e të mësuarit, metodat, veprimtaritë, tekstet dhe burimet e tjera. Një numër pyetjesh është mirë të merren parasysh, pasi mund të na ndihmojnë të përcaktojmë çfarë ka të veçantë këndvështrimi i edukimit global në kurrikul, për të hartuar përmbajtjen dhe, më pas, për të vlerësuar efektshmërinë e kurrikulës së edukimit global me të njëjtat kriteret:

- A e mundëson kurrikula të kuptuarin ndërkombëtar dhe a e zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë globale?
- A është kurrikula me orientim kryesisht etnocentrist, kombëtar, Evropian, apo është e orientuar nga larmia kulturore dhe e karakterizuar nga një vizion dhe kuptim global i botës?

- A e vendos ajo theksin në shqyrtimin e shkaqeve të konfliktit dhe të dhunës, si dhe kushtet e paqes në individët, institucionet dhe shoqëritë, përmes këndvështrimit të kohës në tre dimensione?
- A bazohet ajo në njohjen e karakterit historik dhe në ndërlidhjen e dukurisë me njohurinë për këtë dukuri?
- A ekzistojnë lidhje ndërmjet çështjeve të veçanta për çdo shkencë/lëndë dhe njohurive të përgjithshme, me këndvështrimin global dhe historik, që kultivon vlerat njerëzore themelore?
- A ekzistojnë mundësi për lidhje ndërmjet lëndëve të ndryshme, që e bëjnë të mundur shqyrtimin, në kuadrin e një qasje tërësore, të ndërvarësisë ndërmjet shkaqeve dhe pasojave të varfërisë dhe rritjes së hendekut shoqëror, konfliktit dhe dhunës, shtypjes njerëzore dhe përjashtimit shoqëror, migrimit dhe ksenofobisë, zhvillimit të njëanshëm dhe shkatërrimit ekologjik në nivel lokal dhe global?
- A shqyrtohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet këndvështrimeve të ndryshme duke u bazuar në njohuritë bazë dhe vlerat njerëzore?
- A merr ajo parasysh prejardhjet e ndryshme kulturore të nxënësve dhe mësuesve, në mënyrë pozitive dhe konstruktive, për ndërtimin e njohurive ekzistuese që vijnë nga anë të ndryshme të botës sonë globale?
- A i ndihmon ajo nxënësit të zhvillojnë aftësi shoqërore për të trajtuar në mënyrë konstruktive problemet e botës në një larmi shkallësh dhe nivelesh, nga niveli personal në atë global?
- A është teoria e lidhur qartësisht me praktikën, duke hapur horizonte të reja për nxënësit që të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm global?
- A përfshin ajo strategjitë pjesëmarrëse dhe këndvështrimet makro/mikro në problemet e sotme botërore, si një mënyrë e ndërveprimit, si një shtyllë e rëndësishme zhvillimi për projektet, si element për diskutime dhe analiza mes nxënësve, duke i përgatitur ata për të qenë anëtarë aktivë të shoqërisë që kërkon zgjidhje në solidaritet?
- A përfshin ajo udhëzime të sakta për metodat e mësimdhënies, duke zgjedhur burimet, praktikat e mira, ose a është ajo e favorshme për një larmi të madhe burimesh dhe metodash, ndërsa propozon një numër të madh shembuj të praktikave dhe burimeve të mira?
- A ofrojnë fushat e ndryshme lëndore mundësi të mësuarit për një dimension të ardhshëm, duke përfshirë këtu shqyrtimet mendje hapura për çështjet që lidhen me ndërtimin e një shoqërie botërore më të sigurt, më të drejtë, paqësore dhe të qëndrueshme?
- A ekziston një kornizë e hapur që të lejojë përdorimin e metodave të larmishme dhe të burimeve të shumanshme? A jep ajo mundësinë për ndërveprim dhe për të mësuar nga njeri-tjetri?
- A eksitojnë mundësi për të punuar për një “unitet të mësuarit” ndërmjet kurrikulës formale dhe jo formale?
- A ka hapësirë dhe liri të mjaftueshme për veprimtari ekstra-kurrikulare, në përputhje me qëllimet e kurrikulës?

- A i jep ajo rëndësi të veçantë zhvillimit të aftësive të të mësuarit për gjatë gjithë jetës, që do të forcojë vullnetin e njerëzve për të marrë pjesë në veprime të përbashkëta për zhvillim shoqëror dhe të qëndrueshëm?
- A janë njohuritë e dhëna në çdo pjesë të kurrikulës si e vetmja e vërtetë, apo është e mundur, për grupet e të mësuarit, të zbulojnë njohuritë përmes një metode dialektike të bazuar në kërkime, dyshime dhe pyetje?
- A shqyrton ajo zhvillimin dinamik dhe progresiv të njohurive në nivel global? Më tej, a kultivon ajo proceset evolucionare të njerëzimit drejt zgjidhjeve të problemeve të përbashkëta përmes partneritetit dhe solidaritetit?

## **Kritere për procedurat e ndjekura gjatë hartimit të kurrikulës së EG**

Çështjet e metodologjisë së edukimit global pritet të jenë të pasqyruara në procedurën e hartimit të kurrikulës së edukimit global. Pyetjet e mëposhtme mund të na ndihmojnë në identifikimin e këtyre çështjeve në procesin e hartimit të kurrikulës dhe të vendosim kritere për këtë proces:

1. A është i gjithë procesi pjesëmarrës, bashkëpunues, përfshirës, demokratik dhe i mbështetur në dialog? A janë të gjithë aktorët në arsim të ftuar të përfshihen në procesin e vendimmarrjes?

### Në mënyrë të veçantë:

- *A janë mësuesit të përfshirë aktivisht?*

A vlerësohen ata thjesht si zbatues të një programi të paravendosur, apo janë partnerë në procesin e vendimmarrjes?

Është e qartë që mësuesit duhet të marrin përsipër përgjegjësinë e pjesëmarrjes në procesin e hartimit të kurrikulës, si bashkëbisedues të barabartë me aktorët e tjerë në politikën arsimore.

- *A janë nxënësit të përfshirë aktivisht?*

Nëse edukimi global synon të krijojë qytetarë globalë të përgjegjshëm përmes pjesëmarrjes aktive, nuk është e nevojshme për nxënësit të vlerësohen si partnerë në procesin e vendimmarrjes për kurrikulën, si në arsimin formal, ashtu edhe në atë jo formal.

- *A përfaqësohen në mënyrë të barabartë grupet e ndryshme kulturore dhe shoqërore?*

Nëse edukimi global synon të zhvillojë respektin për ndryshimet kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe të edukojë njerëzit të mësojnë të jetojnë së bashku me të tjerët, si do të mund të përfshijmë në kurrikul aspektet dhe çështjet reale të botës sonë të globalizuar, nëse nuk do të përfshinim përfaqësuesit e grupeve të ndryshme në procesin e vendimmarrjes? Kontributet nga pikëpamje të ndryshme, që vijnë nga njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore dhe shoqërore, janë themelore për këndvështrimet e ndryshme, veçanërisht në shoqëritë tona të larmishme nga ana kulturore dhe të fragmentarizuar.

2. A i karakterizojnë fjalitë e mëposhtme njerëzit e përfshirë në hartimin e kurrikulës?

- *Kritik ndaj informacionit, stereotipave dhe burimeve tradicionale*

- *Jo dogmatikë dhe mendje hapur*
  - *Të aftë për dialog dhe respekt për opinionet e ndryshme*
  - *Të aftë për të analizuar realitetet globale dhe të dhënat shoqërore të kohëve të fundit*
  - *Të pajisur me vlerat dhe qëndrimet e qytetarit global*
  - *Të prirur për të vlerësuar burimet ekzistuese dhe për të kërkuar të tjera*
  - *Të përgjegjshëm për të ndërmarrë detyra të tilla*
  - *Të frymëzuar dhe të përkushtuar ndaj sfidave të edukimit global*
3. A është procesi i hartimit të kurrikulës koherent me qëllimet e edukimit global? A është hartuar kurrikula e lëndëve të ndryshme në mënyrë të pavarur nga i gjithë programi, apo brenda kuadrit të edukimit global? A ekzistojnë komitete të ndryshme lëndor dhe ndërlëndore që punojnë në bashkëpunim të ngushtë me njeri-tjetrin. A është e qartë se lidhjet ndërmjet lëndëve të ndryshme mund të bazohen vetëm në bashkërendimin e veprimit të njerëzve të kualifikuar në shkenca të ndryshme dhe nga nivele të ndryshme arsimore, të aftë të punojnë në mënyrë bashkëpunuese, ndërvepruese dhe tërësore?
  4. A është procesi i hartimit të kurrikulës i lidhur me mjedisin e të mësuarit të edukimit global? A është reflektues dhe nxitës, ndërveprues, krijues dhe premtues. A është ai i bazuar në shqyrtim, analizë dhe sintezë?
  5. A përfshin procesi i hartimit të kurrikulës kritere vlerësimi dhe metoda që bazohen në filozofinë dhe synimet e edukimit global? A janë përcaktuar këto kritere a) për vlerësim fillestar, formativ dhe përfundimtar? b) për vlerësim të brendshëm, të jashtëm dhe vetëvlerësim?
  6. A përfshin procesi i hartimit të kurrikulës, në sektorin e arsimit formal dhe jo formal, një program trajnimi për mësuesit?
  7. A ekzistojnë kritere për vlerësimin e vetë procesit të hartimit të kurrikulës
  8. A ekziston ndonjë mekanizëm për vazhdimësinë e procesit, që të ofrojë një kuadër për përmirësimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të kurrikulës, të bazuar në vlerësimin e procesit të të mësuarit dhe në koherencë me qëllimet dhe metodologjinë e edukimit global?

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi është një proces i domosdoshëm në edukimin global, që fuqizon zbatuesit e tij përmes rritjes së vetëdijes së tyre për efektshmërinë e programit të edukimit global në të cilin janë përfshirë. Vlerësimi nuk është qëllim në vetvete. Ai duhet të jetë i vazhdueshëm, një proces i pafund veprimi dhe reflektimi, i lidhur me metodologjinë dhe qëllimet e edukimit global, që aftëson njerëzit të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme, të përmirësojnë cilësinë e metodave të tyre dhe të fuqizojnë edukimin global në mjedisin e tyre.

Procesi i vlerësimit mund të zbatohet në mënyra të ndryshme, në disa ose në të gjitha aspektet e veprimtarive ose të projekteve të edukimit global, në përgjigje të funksioneve të shumanshme dhe të nevojave të larmishme.

### **Cili është objekt i procesit të vlerësimit?**

Të gjitha aspektet e edukimit global mund të vlerësohen: metodologjia e të mësuarit, burimet, mjetet, mjedisi i të mësuarit, çështjet kurrikulare, kompetencat e mësuesve, njohuritë e nxënësve, tipat e veprimit, planifikimit, strategjia e komunikimit, përfshirja e njerëzve, ndikimi në realitetet lokale etj. E rëndësishme është që, në fund, të njihen, brenda në grupin mësimor, prirjet ose shenjat e zhvendosjes nga kultura e individualizmit në kulturën e partneritetit, të bazuar, si është përshkruar në kapitullin përkatës, në dialog dhe në bashkëpunim,.

Njerëzit, shpesh, pyesin se çfarë e bën të ndryshëm procesin e vlerësimit të edukimit global nga çdo proces i vlerësimit në arsim. Përgjigja nuk duhet kërkuar jashtë kufijve të pedagogjisë bashkëkohore dhe teorive të vlerësimit. Përgjigja mund të gjendet në koherencën ndërmjet qëllimeve të edukimit global, objektivave dhe metodologjisë dhe “pse, çfarë dhe si” kryhet një proces i vlerësimit të edukimit global.

## **A. PËRSE NEVOJITET VLERËSIMI NË EDUKIMIN GLOBAL?**

### **A është realisht i nevojshëm për zbatuesit e edukimit global ?**

Zhvillimi i një kulture vlerësimi në të gjithë njerëzit e përfshirë është një sfidë për edukimin global. Është e qartë se procesi i vlerësimit duhet të jetë në përputhje me çështjet e edukimit global. Edukimi global aftëson njerëzit të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe të analizës, të kërkimit dhe të qasjes së këndvështrimeve të shumta për problemet e përbashkëta, të trajtojnë kontradiktat dhe stereotipat. Ai ndihmon njerëzit të zhvillojnë vlerat dhe qëndrimet e njohurive dhe vizionit vetjak, të dialogut dhe të bashkëpunimit, të mendjes së hapur dhe të përgjegjësisë ndaj botës së përbashkët. Ai nxit njerëzit të zhvillojnë një vizion global dhe një qasje pozitive për ta bërë botën, në të cilën jetojmë, një vend më të mirë. Krahas kësaj, zhvillimi i një kulture të vlerësimit do të thotë që mësuesit dhe nxënësit të aftësohen të bashkëpunojnë për përmirësimin e vetes dhe grupit, përmes qasjes kritike, pluraliste ndaj punën së tyre. Meqë vlerësimi përfshin një dimension vetëvlerësimi, jo vetëm



nxënësit, por edhe mësuesit duhet të nxiten të përmirësojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre për të luajtur rolin si edukatorë të kujdesshëm dhe përgjegjshëm në botën tonë të globalizuar. Vlerësimi kërkon një qasje komplekse, shumëfaqëshe dhe jo lineare. Për këtë arsye, njerëzit e përfshirë në një proces vlerësimi bëhen më të vetëdijshëm për karakterin e ndërlikuar të faktorëve që lidhen me arsimin dhe për nevojën ndërlidhjes të elementeve të ndryshëm për të kuptuar dhe përmirësuar botën ku jetojmë.

### **Si ndihen edukatorët për vlerësimin?**

Megjithëse njerëzit e pranojnë nevojën e vlerësimit, shumë mësues nuk pëlqejnë të përfshihen në një proces vlerësimi dhe, ndonjëherë, i bëjnë qëndresë procesit ose shpërfillin rezultatet e vlerësimit. Kjo ndodh, sepse vlerësimi, shpesh herë, perceptohet si kontroll i punës së tyre dhe, për këtë arsye, ata kanë frikë se ai do të vërë në dyshim kompetencat e tyre profesionale, madje do të rrezikojë punën e tyre. Kjo ndodh edhe sepse vlerësimi, jo rrallë perceptohet edhe si një procedurë burokratike e jashtme, harxhim kohe, disa herë e vështirë, e mërzitshme dhe jo frymëzuese. Arsimitarët ankohen sepse harxhojnë më shumë kohë për raportime sesa për veprime.. Kjo është arsyeja pse vlerësimi nuk mund të jetë një proces “ i detyruar”, i vendosur nga lart. Përkundrazi, procesi i vlerësimit të edukimit global nevojitet të vendoset dhe të kryhet përmes një procedure që fillon nga poshtë, ku mësuesit zbulojnë nevojën e përfshirjes në procesin e vlerësimit, pasi kuptojnë se vlerësimi është pjesë e metodologjisë së tyre, që i aftëson ata të bëjnë punën më mirë në mënyrë sistematike dhe të jenë të vetëdijshëm për të gjithë faktorët që ndikojnë në cilësinë e tij.

### **Cili është qëllimi i një procesi vlerësimi?**

Qëllimi i një procesi vlerësimi lidhet me strategjinë. Metodatat dhe qëllimet e veprimtarive. Edukatorët e edukimit global duhet të vlerësojnë punën e tyre:

- për të qenë më të vetëdijshëm dhe për të reflektuar për metodologjinë dhe strategjinë
- për të gjykuar për përputhshmërinë e projektit me grupin mësimor
- për të kuptuar ndikimin e burimeve që ata zbatojnë në procesin e të mësuarit
- për të matur efektshmërinë e metodave të tyre
- për të matur ndryshimin në aftësitë dhe njohuritë
- për të matur ndryshimet në qëndrime dhe sjellje
- për të analizuar dhe sintetizuar marrëdhëniet ndërmjet qëllimeve dhe metodave
- për të marrë mendime dhe për të përmirësuar veprimtaritë e ardhshme
- për të rishqyrtuar dhe, më pas, për të zgjidhur një problem në bashkëpunim
- për të rishqyrtuar praktikatat e tyre dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme
- për t'u ndierë i vlerësuar dhe për të qenë më i frymëzuar për veprime të tjera

Në nivel institucional, përveç se janë rrjedhojë e kërkesave të mëparshme, rezultatet e vlerësimit janë shumë të dobishme:

- për të matur cilësinë e një procesi në lidhje me qëllimet dhe objektivat e tij
- për të matur ndryshimet e aftësive dhe njohurive në lidhje me metodatat dhe burimet
- për të matur ndryshimet në qëndrime për sjelljen e njerëzve në lidhje me metodatat dhe burimet
- për të siguruar pranimin dhe dukshmërinë e projektit
- për të mbledhur praktikat të mira

- për të rritur përvojën nga një projekt në tjetrin
- për të kryer një analizë krahasuese të metodave të ndryshme të përdorura në projekt
- për të ndarë rezultatet me grupet e ndryshme të njerëzve të interesuar (p.sh. të partnerëve), për të shfrytëzuar në maksimum potencialin e përvojave
- për qëllime të sigurimit të fondeve
- për të krahasuar veprimtari të ngjashme në vende të tjera, që janë pranë situatave të ngjashme
- për të rritur kërkesën për ndryshime të politikave në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar
- për të fuqizuar punën e institucioneve nga ana sasiore dhe cilësore
- për të frymëzuar më shumë më mirë veprimet dhe rrjetet
- për të rritur aftësinë për zhvillimin e kriterëve cilësore.

## **B. ÇFARË LLOJ VLERËSIMI ËSHTË I PËRSHTATSHËM PËR PUNËN TONË?**

Procedurat e vlerësimit janë të ndryshme, sikurse janë edhe metodat e vlerësimit, që varen nga njerëzit e përfshirë, planifikimi kohor, mjetet e përdorura, objektivat dhe veçanërisht konteksti i projektit tonë arsimor. Për të vlerësuar lloje të ndryshme procesesh, përdoren lloje të ndryshme mjeteesh. Nuk është e njëjtë të vlerësosh një proces mësimor he arritjet e tij ose ndikimin e një projekti me vlerësimin e planit strategjik për një projekt ose të cilësisë së punës dhe të menaxhimit të një organizate.

Megjithatë, të gjitha procedurat e vlerësimit, në përgjithësi, marrin parasysh dallimet e mëposhtme ndërmjet:

### **Vetë-vlerësimit, vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm**

Dallimi ndërmjet vetëvlerësimit dhe vlerësimit të brendshëm të grupit të punës dhe ndërmjet vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm qëndron si më poshtë:

#### **Vetëvlerësimi**

Vetëvlerësimi është absolutisht i nevojshëm për të vlerësuar dhe për të përmirësuar metodat tona. Ai kërkon aftësi të njohjes së vetvetes dhe vetëkritikën. Ai bazohet në vullnetin natyral për vet zhvillim dhe për të mësuar gjatë gjithë jetës. Kur njerëzit vlerësojnë veten, ata kanë ndjenjën e përfshirjes dhe të përgjegjësisë për të gjithë punën e tyre.

Vetëvlerësimi nuk është kurrë i mjaftueshëm për një proces vlerësimi, por është i nevojshëm për mësuesit, për të qenë në dijeni të punës së tyre. Ai është një pikënisje në procesin e vlerësimit – të mendojmë edhe një herë për përkushtimin dhe arritjet në një detyrë të caktuar. Për më tej, ne kemi nevojë të kujtojmë që një zbatues/mësues vepron në kuadrin e një konteksti, në ndërlidhje me faktorët e tjerë që lidhen e punën e tij. Kështu, vetëvlerësimi ka kufizimet e tij dhe është më dinamik kur bashkërendohet me forma të tjera të vlerësimit, që matin elemente të tjerë të procesit të të mësuarit.

Vetëvlerësimi shqetëson jo vetëm mësuesit, por edhe nxënësit. Gjatë kohës që kryhet një proces të mësuarit, nxënësit analizojnë zhvillimet e tyre personale nga pikëpamja e vetëdijes për çështjet globale. Edukimi global, si një proces të mësuarit transformues, aftëson nxënësin të jetë i vetëdijshëm për mendimet, ndjenjat dhe

veprimet e tij dhe të kuptojë nivelin e përgjegjësisë dhe të përkushtimit të tij shoqëror ndaj sfidave të botës sonë të globalizuar.

### **Vlerësimi i brendshëm**

Vlerësimi i brendshëm mund të ndihmojë punën në ekip në kuadrin e të mësuarit ose grupin e punës dhe të mbështetë rrjetet ndërmjet institucioneve dhe zhvillimin e tyre. Ai kërkon besim, besueshmëri, bashkëpunim të vazhdueshëm dhe nxitje ndërmjet njerëzve në grup. Pengesat përbëhen nga qëndresa e njerëzve, konkurrenca brenda grupit, mungesa e kohës dhe e vullnetit. Kjo është arsyeja përse është e nevojshme të vendosen tregues të qartë dhe objektivë nga ekipi dhe përse metodat e pjesëmarrjes gjatë gjithë procesit janë më të përshtatshme. Njerëzit duhet të përfshihen në vlerësimin e brendshëm me idenë se i gjithë procesi u përket atyre dhe në këtë mënyrë ata do të bëhen zbatues/mësues reflektues.

Nxënësit, si anëtarë të grupit mësimor të edukimit global, kanë rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të brendshëm. Ata duhet të marrin pjesë në baza të barabarta, duke dhënë mendimin e tyre për procesin e të mësuarit, në varësi të pritshmërisë dhe nevojave të tyre.

### **Vlerësimi i jashtëm**

Vlerësimi i jashtëm është më objektiv dhe duhet të bazohet në norma dhe standarde të pranuar gjerësisht. Disa herë, vlerësimi i jashtëm i frikëson njerëzit sepse dobësitë e punës së tyre nuk mund të fshihen. Në këtë rast, njerëzit duhet të nxiten të kuptojnë që vlerësimi kryhet me qëllimin e vetëm për të përmirësuar dhe jo për të kritikuar punën e bërë. Nëse vlerësuesi nuk shihet vetëm si “mik kritik”, me kompetenca metodologjike në edukimin global, por edhe si dikush që, për shkak të rolit, ka nevojë të mbajë distancën profesionale dhe të koordinojë proceset e ndryshme, vlerësimi i jashtëm do t'i sigurojë ekipit të dhënat e nevojshme për të përmirësuar punën.

Si në vlerësimin e jashtëm, ashtu edhe në atë të brendshëm, duhet të bëhen të qarta që në fillim dhe të pranohen nga ekipi, objekti i vlerësimit, metodat, kriteret dhe treguesit. Për një vlerësues të jashtëm, është shumë e rëndësishme të bëjë takime konsultimi me grupin, përpara se të vendosë për treguesit. Në këtë mënyrë ai merr parasysh edhe qëndrimin e ekipit. Së fundi, por jo nga rëndësia, procesi i vlerësimit duhet të respektojë autonominë dhe pikëpamjet dhe jetët personale.

Bashkërendimi i vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm mund të jetë shumë i frytshëm për një analizë krahasuese të rezultateve, sipas kriterëve, treguesve dhe metodave. Ndërveprimi ndërmjet të dyja formave të vlerësimit është përfitues dhe rrit vlefshmërinë e procesit.

### **Vlerësimi fillestar, formativ dhe përfundimtar**

Dallim bëhet edhe ndërmjet vlerësimit fillestar, formues dhe përfundimtar.

Kryeni një vlerësim fillestar përpara se të fillojë projekti, për të marrë informacionin e nevojshëm për të identifikuar problemet, për të matur njohuritë dhe aftësitë, për të kuptuar vlerat dhe qëndrimet dhe për të përcaktuar strategjinë tuaj.

Përdorni vlerësimin formues në fazat e para të projektit ose të veprimtarisë për të mbështetur zbatimin dhe zhvillimin e saj dhe, më pas, gjatë projektit ose veprimtarisë, për të identifikuar problemet dhe për të eksploruar zgjidhjet dhe për të përshtatur dhe përmirësuar programin tuaj në përputhje me rezultatet e procesit të vlerësimit.

Përdorni vlerësimin përfundimtar pas përfundimit të projektit ose veprimtarisë për të matur efektshmërinë dhe për të reflektuar e përmirësuar metodologjinë për të ardhmen.

Nëse është e mundur, përdorni të dyja proceset për vazhdimësinë e punës suaj. Në këtë rast, ju duhet të mbani parasysh që rezultatet e çdo procesi lidhen me planifikimin kohor dhe informacionin që jep vlerësimi formues për punën tuaj. Nëse ekziston bashkërendimi ndërmjet vlerësimit formues dhe punës suaj, rezultatet e vlerësimit përfundimtar janë nxitëse dhe premtuese.

Procesi i pas vlerësimit mund të jetë shumë i vlefshëm për matjen e efektshmërinë së procesit të vlerësimit në lidhje me punën tuaj.

### **Vlerësimi sasior dhe cilësor**

Dallim i rëndësishëm ekziston edhe ndërmjet vlerësimit cilësor dhe sasior. Edhe pse, vlerësimi sasior është më i thjeshtë për t'u realizuar, të dy vlerësimet janë të rëndësishme për të siguruar cilësinë në mënyrë sistematike. Kjo është arsyeja përse, kur zbatojnë një metodologji të edukimit global, ne kemi nevojë të matim fakte të natyrës sasiore dhe cilësore. Për më tepër, vlerësimi sasior, shpesh herë, na jep të dhëna të vlerësimit cilësor. Për shembull, numri i pjesëmarrësve në një projekt ose veprimtari, numri ose shpeshtia e veprimit, ngjarjes, deklaratave të shtypit, botimeve, materialeve të përdorura etj. janë tregues për vlerësim sasior. Megjithatë, këto matje mund të na japin tregues për vlerësim cilësor, nëse, për shembull, ne përdorim kritere në lidhje me burimin e të dhënave të mbledhura në interes të njerëzve ose kritere në lidhje me arsyet e shifrave në kuadrin e një konteksti shoqëror ose brenda një grupi mësimor, në lidhje me ndikimin ose në lidhje me projektin tonë. Ky lloj bashkërendimi ndërmjet të dhënave sasiore dhe kritereve cilësore mund të na ndihmojë për një analizë më tërësore të vlerësimit dhe të efektshmërisë së projektit. Për më tepër, vlerësimi cilësor është i nevojshëm për procesin e vlerësimit formues, për të përmirësuar vazhdimisht procesin mësimor, kurse vlerësimi sasior, shpesh, përdoret në vlerësimin përfundimtar për të mbledhur të dhëna të matshme.

### **C. SI TË KRYEJMË NJË VLERËSIM?**

Siç e kemi thënë edhe më parë, ka metoda të ndryshme vlerësimi, që lidhen me “pse”, “kur”, “kujt” dhe “pse” zbatohet procesi. Megjithatë, procesi i vlerësimit paraqet karakteristika të përgjithshme në lidhje me hapat e nevojshëm për t'u ndjekur:

#### **Identifikimi i objektit**

Së pari, ne kemi nevojë të identifikojmë çfarë duam të vlerësojmë dhe çfarë është e mundshme për të vlerësuar.

Duke mbajtur parasysh se është më e lehtë të matësh ndryshimet në njohuri dhe aftësi se sa ndryshimet afatgjata në vlera dhe qëndrime, “objekti” i vlerësimit duhet të jetë i veçantë dhe i matshëm, në kontekstin e punës sonë. Vlerat dhe qëndrimet nuk janë lehtësisht të matshme, kështu që ne mund të përcaktojmë temat për vlerësimin në lidhje me to (p.sh. ndryshimet në sjellje). Për më shumë, ne mund të vlerësojmë disa

nga çështjet e veprimtarisë sonë ose të projektit në lidhje me qëllimet dhe objektivat dhe jo domosdoshmërisht të gjithë programin. Për këtë arsye, në politikat publike dhe në programet afatgjata, në vlerësimin e të gjithës shpesh herë është e nevojshme të analizohet ndikimi i edukimit global në një kontekst specifik dhe më pas të reflektohet për politikat arsimore dhe të përmirësojë të gjithë programin në kuadrin e një qasjeje holistike.

### **Përcaktimi i kriterëve dhe i treguesve**

Kriteret dhe treguesit duhet të vendosen përpara se të zgjidhet metoda e vlerësimit. Është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet kriterëve dhe treguesve. Një kriter vendoset duke pyetur veten për çështjet e objektit tonë në lidhje me cilësinë e punës sonë, kurse një tregues vendoset duke iu përgjigjur pyetjes “si e matim një kriter?”. Për shembull, një kriter për ndikimin e një veprimtarie simuluese është shkalla e reflektimit të provokuar, që duhet të lidhet me qëllimet tona. Treguesi përkatës mund të jetë numri i pyetjeve të bëra nga pjesëmarrësit ose numri i pjesëmarrësve që reagojnë nga pyetjet ose nga dëshira për të shprehur veten.

### **Përzgjedhja e metodës dhe mbledhja e të dhënave**

Për të vlerësuar metodologjinë e edukimit global përdoren metoda të ndryshme. Nga një varg metodash, zgjidhni çfarë është e përshtatshme për punën tuaj, mundësisht ato pjesëmarrëse. Vlerësimi i kolegëve, vlerësimi pilot, studime rasti, analiza e kontekstit, analiza S.W.O.T<sup>13</sup>, ndikimi që vlerësimi mund të ketë në punën tuaj. Në vijim, përfshini në procesin e vlerësimit intervistat, konsultimet, vizitat e ekipeve, veprimtaritë pjesëmarrëse, seminare diskutimi, debate dhe vëzhgime të ndjekura nga punë grupi. Pyesni nxënësit tuaj t’u përgjigjen pyetësorëve, të shkruajnë ditarë mësimore, të organizojnë portofola, të përgatisin raporte grupi ose individit ose dokumente të tjerë, mblidhni të dhëna ose bëni një foto ose afishe vlerësimi. Kur vlerësohet një projekt ose veprimtari e edukimit global, është e rëndësishme të përdoren metoda vlerësimi në përputhje me metodën e të mësuarit. Veprimtaritë pjesëmarrëse, si “Kafeja botërore” ose “lëviz një hapësirë për të shprehur mendimin tonë” ose një tryezë e rrumbullakët për diskutime rekomandohen për këtë qëllim.

### **Interpretimi dhe analiza e informacionit**

Hapi tjetër për mbledhjen e të dhënave është interpretimi dhe analiza e informacionit në kuadrin e arritjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit dhe në lidhje me kriteret dhe synimet tona. Kur analizojmë informacionin që vjen nga një proces vlerësimi, është e rëndësishme të bëjmë dallimin ndërmjet qëllimeve të vlerësimit dhe qëllimeve të projektit ose veprimtarisë së vlerësuar. Është e rëndësishme të kuptojmë edhe të pa paparat dhe të pathënat në informacionin që vjen nga njerëzit e përfshirë, si dhe në lidhje me mjedisin e të mësuarit dhe metodat tona.

### **Komunikimi i rezultateve**

Proces pjesëmarrës do të thotë që të gjithë njerëzit e interesuar të mësojnë për rezultatet e procesit të vlerësimit, të diskutojnë dhe të bashkëpunojnë për hapin tjetër.

### **Zhvillimi i strategjive për përmirësim**

---

<sup>13</sup> S.W.O.T. Strengths-Pikat e forta, Weak – Dobësitë, Opportunities – Mundësitë, Threats – Rreziqet

Siç e kemi thënë më sipër, vlerësimi nuk është qëllim në vetvete. Rezultati i vlerësimit duhet të përdoret për të reflektuar për metodologjinë tonë, për të sugjeruar ide dhe objektiva të reja dhe për të zhvilluar strategji për të përmirësuar punën tonë.

## KAPITULLI E

# BIBLIOGRAFIA dhe BURIMET

### Referenca

- Asbrand Barbara & Lang-Wojtasik Gregor, Universiteti i Nuremberg / GENE Grup Pune për vlerësimin, Germany
- Birzea, César(1999): “*Civic Culture*”, Editura Trei, Bucuresti
- Birzea, César. *Education for democratic citizenship: a lifelong learning perspective*. Council for Cultural Co-Operation (CDCC). Council of Europe, Strasbourg, June 2000
- Beljanski-Ristic, Ljubica - *Drama In Education - Belgrade Model*, CEDEUM, Belgrade, 2001
- Benett, C.I. (1990): *Comprehensive Multicultural Education*, Ally & Bacon Co., Boston-London – Toronto
- Bennett, C. (1992): “Strengthening Multicultural and Global Perspectives in the Curriculum”, in A. K. Moodley (ed.), *Beyond Multicultural Education: International Perspectives*, Detseling Enterprises Ltd., Calgary, Alberta
- Boal, Augusto, *Exercices pour acteurs et non-acteurs* – Ed. Maspero, Paris, 1978
- Boal, Augusto, *Theatre of the Oppressed* – Ed. Theatre Communications Group, New York, 1985
- Brown, H.D. (1990) *On Track to Century 21*. San Francisco, USA
- Cabezudo, A. 2007 – 2008 . *Towards Global Learning. On Democracy and Education*, University of Rosario / School of Education, Rosario.Argentina. In process
- Cates, K. (1990) « Global education and Foreign Language Teaching : Theory & Practice ». Journal of the Faculty of General Education, Tottori University No. 24 October 1990
- Dasen, Pierre (1999): “Fundamentele stiintifice ale unei pedagogii interculturale”, in *Educatia interculturala. Experiente, politici, strategii*, Polirom, Iasi
- Dasen, P., Perregaux, Ch., Rey, Micheline (1999): *Intercultural Education. Experiences, policies, strategies*, Polirom, Iasi.
- DEA: Effectiveness in Global Education. <http://www.dea.org.uk/info/projects /effectiveness>

- Delors, J. *Apprendre. Un trésor est caché dedans*. Paris, Ed. Odile Jacob, 1996
- Eisler, R. 1988, *The Chalice and the Blade*, Harper and Row, San Francisco
- Freire, Paulo , *Pedagogy of Oppressed* ,NYC, 1982
- Fukunaga, Y.(1998) «Teaching Global Issues through English Movies». *Global Issues in Language Education Newsletter*. No. 30, March 1998, Tottori, Japan
- Galtung, Johan *Conflict Transformation by Peaceful Means*, Geneva, ONU, 2000
- Haavelsrud, Magnus (1983): “An Introduction to the Debate on Peace Education”, in *International Review of Education*, 29, 3.
- Haavelsrud, M. 1995 *The Substance of Peace Education* , in *International Educator*
- Hannoun, Hubert (1987): *Les Ghetto de l'école. Pour une éducation interculturelle*, ESF, Paris
- Hanvey, R. (1975): *An Attainable Global Perspective*, Center for War/Peace Studies, New York
- Hinkelman, D. (1993) “Overseas Tours to Research Social Issues”. *The Language Teacher*. Vol. XVII No. 5 May 1993, Tokyo.
- Kniep, W. (1985). *A Critical Review of the Short History of Global Education*. New York : American Forum for Global Education
- Maley, A.(1992). *Global Issues in ELT. Practical English Teaching*. Vol 13 No. 2, Dec.1992, London
- Mestenhauser, A.J. (1998): “Travelling the Unpaved Road to Democracy from Communism: a Cross-cultural perspective on Change”, in *Higher Education in Europe*, XXIII, 1, UNESCO
- Munoz, Marie-Claude (1999) : “Les pratiques interculturelles en éducation”, in J. Demorgon, E.M.Lipiansky (coord.), “L'école confrontée a la diversité culturelle”, in *Guide de l'interculturel en formation*, Tetz, Paris
- Niklas Luhmann, Niklas / Schorr, Karl Eberhard: *Reflexionsprobleme im Erziehungssystem*. Frankfurt / M.: Suhrkamp 1999.
- Provo, J. (1993) “Teaching World Issues“ *Daily Yomiuri Newspaper*. March 18, 1993, Tokyo
- Reischauer, E. (1973). *Toward the 21<sup>st</sup> Century*. New York
- Rey, Micheline (1984): “Piège et défi de l'interculturalisme”, in *Education permanente*, 75
- Scheunpflug, Annette unter Mitarbeit von Claudia Bergmüller und Nikolaus Schröck: *Evaluation globalen Lernens. Eine Arbeitshilfe*. Stuttgart: Brot für die Welt 2002
- Toffler, Alvin ( 1983) : *Al treilea val*, Editura politica, Bucuresti
- Touraine, Alain (1996): “Faux et vrais problèmes”, in *Une société fragmentée? Le multiculturalisme en débat*, Edition La Découverte, Paris



## LISTË BURIMORE PËR EDUKIMIN GLOBAL

### LIBRA:

- Drew, N. (1995) Learning the Skills of Peace -making .USA :Jalmar Press
- Elder, P. (1987). Worldways: Bringing the World Into Your Classroom. USA : Addison-Wesley
- Fisher,S. & Hicks, D. (1985) World Studies. New York: Oliver & Boyd.
- Hicks, D & Steiner, M. (1989) Making Global Connections. New York : Oliver & Boyd
- Kniep, W. (1987) Next Steps in Global Education. New York.
- Lewis, B. (1998) The Kids Guide to Social Action. USA : Free Spirit
- Milord, S. (1992). Hands around the world: cultural awareness & global respect. Williamson Ed.
- Pike, G.& Selby, D. (1988) Global Teacher , Global learner. London: Hodder & Stoughton
- Pike, G. & Selby, D. (1999). In the global classroom. Toronto ; Pippin Publishing

### BURIME:

- *Apprendre à vivre ensemble. Un programme interculturel et interreligieux pour l'enseignement de l'éthique.* Fondation Arigatou en collaboration avec et sous l'égide de l'Unesco et l'Unicef, 2008
- Service Learning: Lessons, Plans and Projects, Human Rights Education Program, Amnesty International & Human Rights Education Associates, HREA, March 2007

## **BURIMET ARSIMORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS**

### **COMPASS**

COMPASS është prodhuar në kuadrin e Programit të Rinor të Edukimit të të Drejtave të Njeriut e Drejtorisë për Rininë dhe Sportet e Këshillit të Evropës. Programi synon të vendosë të drejtat e njeriut në qendër të punës së rinisë , duke kontribuar në këtë mënyrë për të bërë edukimin e të drejtave të njeriut pjesë normale të arsimit.  
<http://eycb.coe.int/compass/>

### **DOMINO**

Një manual për t'u përdorur në edukimin ndërmjet bashkëmoshatarëve si mjet për të luftuar racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe intolerancën.

Shih edhe Alien 93, "Organizata e Rinisë në luftë me racizmin dhe ksenofobinë.

<http://eycb.coe.int/domino/> & <http://eycb.coe.int/domino>

### **EDUCATION PACK**

Ide, burime, metoda dhe veprimtari për edukimin ndërkulturor me të rinjtë dhe të rriturit.  
<http://eycb.coe.int/edupack>

### **TË EKSPLOROJMË TË DREJTAT E FËMIJËVE – VEPRIMTARI MËSIMORE PËR ARMIN BAZË**

[http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Source/Pdf/Documents/2006\\_17\\_ExploringChildrensRights\\_En.pdf](http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Source/Pdf/Documents/2006_17_ExploringChildrensRights_En.pdf)

### **FAKTE MËSIMORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.**

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut – pikënisje për mësuesit

[http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Documents\\_Publications/Education\\_materials/089\\_HumanRightsEducationalFactSheets\\_en.asp#TopOfPage](http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Documents_Publications/Education_materials/089_HumanRightsEducationalFactSheets_en.asp#TopOfPage)

### **T-KITS : PAKETË TRAJNIMI**

Paketat e trajnimit janë botime tematike të shkruara nga trajnerë të rinj me përvojë dhe ekspertë të tjerë. Ato janë të gatshme për t'u përdorur në trajnime dhe studime. Paketa është prodhuar nga Drejtoria për Rininë.

[http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Documents\\_Publications/Education\\_materials/082\\_T\\_Kits\\_en.asp#TopOfPage](http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Documents_Publications/Education_materials/082_T_Kits_en.asp#TopOfPage)

### **KARTA EVROPIANE PËR SHKOLLAT DEMOKRATIKE PA DHUNË**

Duke u bazuar në nismën e Këshillit të Evropës, të rinj nga e gjithë Evropa përgatitën Kartën Evropiane për shkollat demokratike pa dhunë, në bazë të vlerave dhe parimeve themelore të përbashkëta për të gjithë Evropianët, në mënyrë të veçantë ato që shpallen në Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.

[http://www.coe.int/t/el/integrated\\_projects/democracy/02\\_Activities/15\\_European\\_School\\_Charter/](http://www.coe.int/t/el/integrated_projects/democracy/02_Activities/15_European_School_Charter/)

Më shumë në :

[http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Documents\\_Publications/EDC\\_Pack/](http://www.coe.int/t/dg4/education/edc/Documents_Publications/EDC_Pack/)

## Shtojca I

# DEKLARATA E EDUKIMIT GLOBAL E MAASTRICHT

### KUADRI STRATEGJIK EVROPIAN PËR PËRMIRËSIMIN DHE ZGJERIMIN E EDUKIMIT GLOBAL NË EVROPË DERI NË VITIN 2015

## “Deklarata e Edukimit Global e Maastricht”

### Kongresi mbarë Evropian i Edukimit Global

Maastricht, Holandë, 15-17 Nëntor 2002

- Përbushja e Qëllimeve të Mijëvjeçarit,
- Të mësuarit për Qëndrueshmëri,
- Rritja e angazhimit për edukimin global për rritjen e mbështetjes publike

**Ne delegacionet pjesëmarrëse të Kongresit Mbarë-Evropian i Edukimit Global, në Maastricht, 15-17 Nëntor 2002, që përfaqësojnë parlamentarë, qeveritarë autoritetet lokale dhe rajonale dhe organizatat e shoqërisë civile nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, që dëshirojnë të kontribuojnë për vazhdimësinë e Samitit Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe të përgatitjeve për Dekadën e Kombeve të Bashkuara për Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm.**

#### I. Duke kujtuar:

- **Angazhimin ndërkombëtar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm i bërë në Samitin Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe ndaj zhvillimit të një partneriteti global për uljen e varfërisë globale si pjesë e Synimet për Zhvillim të Mijëvjeçarit të KB.**
- **Angazhimet ndërkombëtare, rajonale dhe lokale për të rritur dhe ër të përmirësuar mbështetjen për Edukimin Global, si edukim që mbështet kërkimet e njerëzve për njohuri për realitetet e botës së tyre dhe i përfshin ata në qytetarinë kritike, globale demokratike për më shumë drejtësi, qëndrueshmëri, barazi dhe të drejta të njeriut për të gjithë (shih shtojca I)**

## - **Përcaktimet e Edukimit Global të Qendrës Veri-Jug të Këshillit të Evropës (2002)**

- Edukimi global është edukimi që hap sytë dhe mendjet e njerëzve ndaj realiteteve të botës, i zgjon ata për të sjellë një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta të njeriut për të gjithë.
- *Edukimi global, duke qenë dimension i global e Edukimit për Qytetari, përmbledh Edukimin për Zhvillim, Edukimin për të Drejtat e Njeriut, Edukimin për Qëndrueshmëri, Edukimin për Paqe dhe Parandalim Konflikti dhe Edukimin Ndërkulturor; qenien*

## **2. Duke qenë thellësisht të vetëdijshëm për faktin që:**

- Pabarazitë e mëdha globale vazhdojnë të ekzistojnë dhe nevojat njerëzore bazë, duke përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut (siç përmendet në deklaratën e Dakar për Arsimin për të Gjithë), ende nuk janë përmbushur për të gjithë njerëzit;
- Proceset demokratike të vendimmarrjes kërkojnë dialog politik ndërmjet qytetarëve të informuar dhe të fuqizuar dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur;
- Shndërrimet e thella të modeleve të prodhimit dhe të konsumit, të kërkuara për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, mund të realizohen vetëm nëse qytetarëve, burrave dhe grave, **iu** garantohet informacioni i duhur dhe nëse ata e kuptojnë dhe bien dakord për nevojën për të vepruar.
- Edukimi global i kuptuar mirë dhe i planifikuar nga ana strategjike, që mban parasysht çështjet gjinore, duhet të kontribuojë në kuptimin dhe pranimin e masave të tilla.

## **3. Duke pranuar që:**

- Evropa është një kontinent me njerëz që kanë ardhur nga e gjithë bota dhe që janë të pranishëm në të gjithë botën.
- Ne jetojmë në një botë gjithnjë e më shumë të globalizuar, ku problemet ndër-kufitare duhet të zgjidhen përmes masave politike të përbashkëta dhe të shumanshme.
- Sfidat e solidaritetit ndërkombëtar duhet të përballohen me zgjidhje të qëndrueshme.
- Edukimi global, është i rëndësishëm për të fuqizuar mbështetjen publike për të shpenzuar në zhvillim dhe bashkëpunim. Të gjithë qytetarët kanë nevojë për njohuri dhe aftësi për të kuptuar, për të marrë pjesë dhe për të ndërvepruar në mënyrë kritike me shoqërinë tonë globale, si qytetarë të fuqizuar globalë. Kjo shtron sfida të mëdha për të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe edukimin.
- Sot janë të pranishme sfida të reja por edhe shanse për të përfshirë evropianët në forma edukimi për qytetari aktive lokale, kombëtare dhe globale dhe për mënyra jetese të qëndrueshme, me qëllim që të kundërveprojnë ndaj humbjes së besimit të njerëzve në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Metodologjia e Edukimit global përqendrohet në mbështetjen e të mësuarit aktiv dhe në nxitjen e reflektimit me pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe mësuesve. Ajo feston dhe nxit diversitetin dhe respektin për të tjerët dhe nxit nxënësit të bëjnë zgjedhjet e tyre në kontekstin e tyre dhe në lidhje me kontekstin global.

#### **4. Duke rënë dakord që**

Një botë e drejtë, paqësore dhe e qëndrueshme është në interes të të gjithëve.

Meqë përcaktimi i mësipërm i Edukimit Global përfshin konceptin e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe shërben si përgatitje për dekadën e KB për Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke filluar nga 2005

Duke qenë se Edukimi Global është një detyrim që përshkon të gjithë sektorët, ai mund të kontribuojë ndjeshëm në arritjen e këtyre angazhimeve. Garantimi i Edukimit Global është, njëherazi, nevojë dhe e drejtë. Kjo do të kërkojë:

- Rritje dhe përmirësim të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet aktorëve në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe lokal
- Pjesëmarrja dhe angazhimi aktiv në vijim të këtij Kongresi për të gjitha katër kategoritë e aktorëve politikë: parlamentarë, qeveritarë, autoritete lokale dhe rajonale si dhe shoqëria civile, të cilët janë të përfshirë në diskutimet e vazhdueshme e të dobishme politike në kuadrin e Qendrës Veri –Jug.
- Rritja e rëndësishme e fondeve shtesë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Rritja e mbështetjes në Ministrinë e Zhvillim Bashkëpunimit, të Punëve të Jashtme, të Tregtisë, të Mjedisit dhe, veçanërisht në Ministrinë e Arsimit, për të siguruar integrimin e plotë në kurrikulën e arsimit formal dhe jo formal, në të gjitha nivelet.
- Mbështetja ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale dhe mekanizmat e koordinimit.
- Rritja e madhe e bashkëpunimit ndërmjet Veriut dhe Jugut dhe ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit

#### **5. Dëshira për t'u angazhuar vetë dhe shtetet anëtarë, organizatat e shoqërisë civile, strukturat parlamentare dhe autoritetet lokale dhe rajonale që ne përfaqësojmë:**

5.1 Për të çuar përpara procesin e përcaktimit të Edukimit global dhe për të siguruar përfshirjen, të larmisë së pasur të përvojave dhe të ideve (p.sh. këndvështrimet e jugorëve, të minoriteteve, të rinisë dhe të grave).

5.2 Për të zhvilluar, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse dhe me aktorët e duhur (ose duke u mbështetur në ata ekzistues), plane veprimi kombëtare, duke filluar që sot dhe deri në vitin 2015, për rritjen dhe përmirësimin e Edukimit Global në përputhje me Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

5.3 Për të rritur fondet për Edukimin Global

5.4 Për të siguruar integrimin e këndvështrimit të Edukimit Global në sistemin arsimor në të gjitha nivelet.

5.5 Për të zhvilluar ose, ku është e zhvilluar, për të përmirësuar dhe rritur strukturat kombëtare për financim, mbështetje, koordinim dhe politikë bërje në Edukimin Global në të gjithë shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës, sipas kushteve të secilit.

5.6 Për të zhvilluar dhe, ku është e zhvilluar, për të përmirësuar strategjitë për rritjen dhe sigurimin e cilësisë së Edukimit Global.

5.7 Për të rritur mbështetjen e rrjeteve të strategjive Rajonale, Evropiane dhe Ndërkombëtare për të rritur dhe përmirësuar Edukimin Global, ndërmjet politikë bërësve dhe praktikuesve.

5.8 Për të testuar mundësinë e zhvillimit të monitorimit horizontal/programit të mbështetjes në nivel horizontal, përmes Raporteve kombëtare të Edukimit Global dhe vlerësimeve në nivel horizontal në një periudhë 12 vjeçare.

5.9 Për të kontribuar në vijimësinë e Samitit Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

**Ne, delegacionet pjesëmarrëse të Kongresit Mbarë Evropian i Edukimit Global, Maastricht, 15-17 Nëntor 2002, që përfaqësojnë parlamentarët, qeveritarët, autoritetet lokale dhe rajonale dhe organizatat e shoqërisë civile nga shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës, angazhohemi në një dialog të vazhdueshëm me Jugun për formën dhe përmbajtjen e Edukimit Global.**

## **SHTOJCË PËR DOKUMENTIN E KUADRIT STRATEGJIK EVROPIAN:**

**Duke u ngritur mbi konsensusin në lidhje me nevojën për të rritur dhe përmirësuar Edukimin Global, ne kujtojmë:**

- Marrëveshjen e bërë nga Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm 20012, që përfshin pranimin e idesë që “arritjet e synimeve të zhvillimit të pranuar në nivel ndërkombëtar, që përfshijnë ata që ndodhen në Deklaratën e Mijëvjeçarit ...do të kërkojnë rritje të madhe në rrjedhjen e burimeve financiare ...për ...edukim dhe rritje të vetëdijes...” (paragrafi 71) dhe “për të integruar zhvillimin e qëndrueshëm në sistemin e arsimit në të gjitha nivelet e tij, për të nxitur edukimin si agjent kyç për ndryshim” (paragrafi 104), si dhe miratimin e dekadës së edukimit për zhvillim të qëndrueshëm, duke filluar nga viti 2005.
- Kapitulli 35 dhe 36 i Agjendës 21 në lidhje me Rritjen e Arsimit, Vetëdijes Publike dhe Trajnimit;
- Karta e Edukimit Global e Qendrës Veri-Jug e Këshillit të Evropës, që nxit zhvillimin e veprimit të përbashkët ndërmjet llojeve të ndryshme të Edukimit Global –edukimi për të drejtat e njeriut, edukimi për paqe, edukimi për zhvillim, edukimi mjedisor, të mësuarit për qëndrueshmëri;
- Konventa e Arhus për Garantimin e të Drejtës për Informacion, Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrje dhe e Drejta për Drejtësi në çështjet Mjedisore, me qasjen për të mësuarit për qëndrueshmëri, e bazuar në të drejtat.
- Angazhimi ndaj të drejtës për edukimin me të drejtat e njeriut, që është pjesë e instrumenteve ndërkombëtarë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut, bashkë me Rekomandimet e Këshillit të Evropës për Mësimdhënien dhe të Mësuarit për të Drejtat e

Njeriut në Shkollë (1985); Kuadrin e Integruar për Veprim për Edukimin për Paqe, të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci e UNESCO-s (1995); Plani i Veprimit i Dekadës së KB për Edukimin e të Drejtave të Njeriut: 1995-2005;

- Deklarata dhe programi për Edukimin për të Drejtat e Njeriut, i bazuar në të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve” e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (Budapest, 1999);
- Rekomandimet e fundit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtarë në lidhje me Edukimin për Qytetari Demokratike dhe propozimet për të projektuar një vit Evropian të Qytetarisë përmes Arsimit (korrik 20012);
- Rezoluta e Zhvillimit të Arsimit e Ministrave të Këshillit të Zhvillimit të Bashkimit Evropian (8 Nëntor 2001), që nxit “rritjen e mbështetjes për edukimin për zhvillim” dhe “shkëmbimin e informacionit dhe përvojës për edukimin për zhvillim, ndërmjet qeverive dhe aktorëve të shoqërisë civile”;
- Propozimet e Takimit të Nivelit të Lartë i Komitetit të Ndhmës për Zhvillim (DAC) i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) (dhjetor 2000) që DAC të nxisë shtetet anëtarë për të zhvilluar objektiva kombëtarë për edukimin për zhvillim, duke shpenzuar si përqindje të shpenzimeve të Zyrës së Ndhmës për Zhvillim (ODA);
- Përfundimet e Këshillit Nordik të Zhvillimit dhe të takimit të Ministrave të Arsimit, Oslo, Maj 2001 “Solidariteti Nordik, angazhimi për një bashkëpunim më të madh ndërmjet zhvillimit dhe Ministrive të Arsimit për solidaritet global;
- Bashkëpunimi Baltik 21, angazhimi i Deklaratës së Haga se “edukimi për zhvillim të qëndrueshëm të përfshihet në të gjitha e arsimit...” dhe Agjenda 21 Baltik 21E (Janar 2002) Strategji për Arsimin në rajonin e Baltikut;
- Karta e Tokës;
- Karta Koperniku (1993) e firmosur nga më shumë se 250 Universitete në Evropë, deklaroi se Zhvillimi i Qëndrueshëm duhet të përfshihet në të gjithë kurrikulën.
- Deklarata e Universiteteve e Luksemburgut;
- Deklaratat kombëtare për Edukimin Global, të tilla si Deklarata Finale Gjermane nga Pjesëmarrësit në Konferencën për “Arsimi 21; “Të mësuarit për një zhvillim të ardhshëm të drejtë dhe të qëndrueshëm” 28-30 Shtator 2000, Bon;
- Deklarata finale për “Arsimi për të gjithë” (EFA), e miratuar nga Forumi Botëror i Arsimit (UNESCO, Dakar, 26-28 prill 2000) dhe deklarata finale e miratuar nga Grupi i Cilësisë së Lartë për Arsimin për të Gjithë (UNESCO, 28-30 tetor 2001);
- Deklarata e Qeverisë Lokale të Johaneshburgut.

# Shtojca 2

## QENDRA VERI-JUG- KËSHILLI I EVROPËS

# KARTA E EDUKIMIT GLOBAL

Dokument pune

nga Dakmara Georgescu

Instituti për Shkencat Arsimore, Bukuresht

1997

- *Përballë Globalizimit*
- *Mbështetje Ndërkombëtare për Edukimin Global*
- *Përkufizimi i Edukimit Global dhe i të Mësuarit Global*
- *Objektiva*
- *Sfida Pedagogjike*
- *Sfida Institucionale*
- *Shtojca –Dokumente Ndërkombëtarë në mbështetje të Edukimit Global*

Edukimi global ka të bëjë me shkollën dhe veprimtaritë jashtëshkollore. Kjo kartë përqendrohet në lidhjen e edukimit global me organizmat përgjegjëse për politikën shkollore në Evropë. Edukimi global duhet të jetë parim i shkollës, në kurrikula dhe në kurset e trajnimit e mësuesve, që marrin parasysh faktin që puna në sektorin formal është një rrugë strategjike dhe shumë e rëndësishme për të ndikuar në ndryshimet e përgjithshme në arsim.

Karta paraqet një numër argumentesh për vendimmarrësit politikë dhe arsimor, për t'u marrë me sfidat me të cilat përballemi sot dhe do të përballojmë nesër. Ajo synon të nxisë debatin për mënyrën e organizimit të arsimit, si duhet të formohet kurrikula që të jetë në një hap me ndryshimet e shpejta në një shoqëri gjithnjë e më shumë të ndërruar, nga përkthimi i çështjeve globale në programe shkollore.

Synimi i Kartës është të tërheqë dhe të nxisë hartuesit e politikave dhe arsimtarët të mbështesin idetë dhe idealet e edukimit global në programet e arsimit formal. Ne vlerësojmë integrimin e çështjeve globale në kurrikulën zyrtare si një dimension thelbësor të reformës së kurrikulës shkollore për sot dhe të ardhmen.<sup>14</sup>

## I. PËRBALLË GLOBALIZIMIT

---

<sup>14</sup> Ideja e një karte të edukimit global për vendet anëtarë të Këshillit të Evropës doli nga një seminar ndërkombëtar për Partneritetin për Edukimin Global-Edukimi Global në Shkollat e mesme, i organizuar nga Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Kombëtar dhe Çështjeve të Republikës së Republikës së Greqisë në Athinë, në 15-17 Mars 1996.



Globalizimi është një fjalë të cilës i referohemi me ngulm në çdo lloj diskutimi që përpiqet të përshkruajë dhe të shpjegojë zhvillimet e sotme shoqërore, ekonomike dhe politike. Në dekadat e fundit, proceset që lidhen me globalizimin shkaktojnë ndryshime të mëdha ekonomike, teknologjike, kulturore, demografike, mjedisore dhe politike, gjë që kërkon përcaktimin e qytetarisë së përgjegjshme globale. Bota në të cilën jetojmë është zhvilluar në një sistem të vetëm shoqëror si rrjedhojë e shumë lidhjeve të ndërvarësisë mes vendeve të ndryshme. Historia e kohëve të fundit, padyshim tregon se jetët e burrave dhe grave të këtij planeti mund të ndikohet nga faktet, proceset, organizatat rrjetet mijëra kilometra larg.

Globalizimi, mund të thuhet se, ka filluar qindra vjet më parë, me shtrirjen e ndikimit perëndimor në pjesë të ndryshme të globit. Por, në këtë shekull, pas Luftës II Botërore, ai u bë një fakt. Marrëdhëniet ekonomike botërore, kryesisht si rrjedhojë e veprimtarisë së shoqërive shumëkombëshe, por edhe marrëdhëniet shoqërore, komunikimi dhe transporti modern që mundëson qarkullimin e shpejtë të informacionit, të personave dhe të të mirave, janë njëherazi shkaqe dhe karakteristika të globalizimit, si proces që na çon dhe drejton drejt një bote të ndërvarur.

Megjithatë, globalizimi nuk u zhvillua në mënyrë të barabartë: në të vërtetë, ai u shoqërua me pabarazi dhe konflikte. Zhvillimi global i marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore është shoqëruar paralelisht me pabarazi të mëdha ndërmjet Veriut dhe Jugut. Sundimi i idesë së ekonomisë së tregut dhe përparimet botërore ekonomike dhe teknologjike ndeshen me rritje të pabarabartë të ekonomisë botërore, shpërndarje të pabarabartë të burimeve materiale dhe njohëse, numër të madh të dëmeve të shaktuara nga zhvillimi i pamenduar i burimeve dhe përdorimi i rrezikshëm i progresit teknologjik. Nëse zhvillimi i planetit tonë në një fshat planet pranohet si fakt, vlerësimi i përfitimeve dhe i kostos së globalizimit, interpretimi i procesit në vetvete është një çështje shumë kundërshtuese. Në kontekste të ndryshme, në pjesë të ndryshme të botës dhe në lidhje me anë të ndryshme të globalizimit, dukuritë dhe proceset që ndihmojnë ndërtimin e fshatit/planetit global të sotëm (por gjithnjë e më shumë të atij të nesërm) perceptohen në dy këndvështrime, si pozitive ose negative, të mira ose të këqija, të dobishme ose të dëmshme, fitimprurëse ose humbëse.

Edukimi global mund të ndihmojë njerëzit të kuptojnë që globalizimi shpreh një kurs të zhvillimeve të ardhme shoqërore dhe varet nga ne nëse zhvillimet do të jenë vetëm në interesin e një pjese të privilegjuar të popullsisë globale apo të njerëzimit në tërësi. Edukimi global (dhe të mësuarit global) është një përgjigje ndaj proceseve të globalizimit dhe ndaj shanseve dhe rreziqeve të tyre.

Ndryshimet e mëdha politike të viteve të fundit, siç është rënia e Murit të Berlinit dhe ndryshimet demokratizuese në Evropën Qendrore dhe Lindore, në Republikën e Afrikës së Jugut, në Amerikën Qendrore dhe Jugore etj., duket se mbështetin një pikëpamje optimiste të globalizimit dhe të ndikimeve të tij. Megjithatë, ka qenë një kohë kur konfliktet etnike dhe fetare në pjesë të ndryshme të botës janë përshkallëzuar deri në luftëra mizore. Megjithëse është rritur vetëdija për nevojat dhe dëshirat e përbashkëta në të gjithë botën, sa mund të pajtohen pikëpamjet e ndryshme të njerëzve për të drejtën e burimeve të botës mbetet ende një çështje e hapur.

Ne shtrojmë me forcë idenë se disa nga çështjet e ngritura nga proceset e globalizimit mund dhe duhet të trajtohen nga arsimi. Që shoqëria jonë të funksionojë si duhet dhe në mënyrë të respektuar, të rinjtë dhe të rriturit duhet të kujtojnë përmes edukimit dhe të shqyrtojnë, në mënyrë të vazhdueshme, barazinë themelore në kuadrin e larmisë së qenieve

njerëzore, nevojën për të respektuar kulturat dhe racat e tjera dhe për të dënuar dhunën, detyrimet dhe shtypjen si mekanizëm i kontrollit shoqëror.

## **2. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE PËR EDUKIMIN GLOBAL**

Vetëdija globale dhe ndërgjegjia globale është dokumentuar në shumë mënyra. E para ka qenë media që ka mundësuar hyrjen në informacionin, kulturën dhe mënyrën e jetesës së globalizuar. Vetëdija e ndryshimit global si rritje e ndërvarësisë dhe e nevojës për bashkëpunim ndërkombëtar u plotësua nga një përgjigje sistematike ndaj ndryshimit, të nxitur kryesisht nga organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, UNESCO, Këshilli i Evropës, OSBE. Gjithnjë e më shumë, individët dhe organizatat, mbështetësit e edukimit global e kuptojnë se njerëzit dhe udhëheqësit e tyre kanë nevojë të zhvillojnë qëndrime dhe sjellje që të çojnë në pranimin dhe nxitjen e ndërvarësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet kombeve.

Shumë pakte dhe deklarata ndërkombëtare të përgatitura dhe të zbatuara nga këto institucione përmbajnë sugjerime, rekomandime dhe linja veprimit për projektimin dhe zbatimin programeve profesionale të edukimit global, të parë si përgjigje arsimore ndaj sfidave të botës së sotme.<sup>15</sup> Këto pakte dhe deklarata, duke transmetuar bindjen në potencialin mësimor të shkollës, përmbajnë pohime të rëndësishme për qytetarinë globale që përmbledh vlerat dhe parimet që vlerësohen themelore për një botë ku bashkëpunimi ndërmjet njerëzve, të barabartë në të drejta dhe dinjitet, të mund të kthehen në fakt.

Arsimtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se vlera dhe parime të tilla duhet të zbulohen në mënyrë të vazhdueshme, të ndryshohen dhe të pohohen përmes proceseve të të mësuarit. Vendimmarrësit dhe arsimtarët duhet të jenë shumë të ndjeshëm ndaj faktit që këto vlera dhe parime të mos merren të mirëqena si universale: kjo është një sfidë e madhe. Empatia dhe vlerësimi i këndvështrimeve të ndryshme kulturore, në kontekstin e sistemeve të tjera vlerash, mbetet një kërkesë e edukimit global.

Referenca ndaj dokumenteve të tillë ndërkombëtar vë në dukje ndryshimet në këndvështrimet intelektuale dhe politike në botë në dekadat e fundit dhe ilustron faktin që frazat e ndryshme, të çuara përpara nga veprimet e veçanta të organizatave ndërkombëtare (p.sh. edukimi mjedisor, edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi për paqe, arsim tërësor, arsim parandalues etj.) sjellin, në mënyra të ndryshme, vetëdijen e përbashkët të përparësive politike, të cilat janë në përputhje me ndryshimet e botës në të cilën jetojmë.

## **3. PËRKUFIZIMI I EDUKIMIT GLOBAL DHE I TË MËSUARIT GLOBAL**

Edukimi global,<sup>16</sup> si një lëvizje idesh dhe një prirje arsimore, vlerësohet si një qëndrim dhe përgjigje ndaj globalizimit në rritje në kuadrin e jetës bashkëkohore. Fusha e edukimit global është rritur në njëzet vitet e fundit. Përvojat amerikane dhe kanadeze ofruan shtysën.

---

<sup>15</sup> Edukatorët e shqetësuar për mënyrën e hartimit dhe të zbatimit të programeve të edukimit global, mund të përfitojnë nga idetë dhe sugjerimet e mishëruara në disa dokumente që vlerësohen si tekste edukative në shtojca, në një listë që pretendon të mos jetë shteruese.

<sup>16</sup> Përkufizimi i Edukimit Global duhet të shikohet si një përkufizim i hapur dhe funksional, të përshkruajë një thelb idesh të pranuar gjerësisht, që pasqyrojnë të kuptuarit e koncepteve dhe praktikave ekzistuese në një kohë të dhënë dhe që na ndihmojnë t'i komunikojmë më mirë ato.

Megjithëse i ndryshëm nga edukimi për zhvillim, nga edukimi për të drejtat e njeriut dhe paqen, nga edukimi ndërkulturor, edukimi global ofron një pamje më të gjerë të asaj që tradicionalisht është referuar nga këto fusha edukative dhe thekson ndërvarësinë dhe lidhjet e forta ndërmjet aspekteve ekonomike, teknologjike, shoqërore e politike, demografike dhe kulturore të jetës shoqërore.

Edukimi global, si stil i të mësuarit dhe si mënyrë e të menduarit, nxit njerëzit të identifikojnë lidhjet ndërmjet nivelit lokal, rajonal dhe botëror dhe të trajtojnë pabarazinë. Ai përfshin katër fusha kryesore kërkimi dhe veprimi:

- Ndërvarësia në një kornizë globale
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Vetëdija dhe shqetësimi mjedisor
- Të drejtat e njeriut (përfshi antiracizmin), demokracia, drejtësia shoqërore dhe paqja

Edukimi global thekson marrëdhëniet e tyre me njerëzimin në tërësi dhe lidhjen e ngushtë me kontekstet ndërkombëtare. Ai i trajton çështjet në përputhje me qasjen ndërlëndore dhe u jep rëndësi qendrore të gjitha aspekteve të ndërvarësisë, të bazuar në metodat arsimore aktive dhe pjesëmarrëse.

Si një veprim i veçantë arsimor, edukimi global karakterizohet, para së gjithash, nga lidhja ndërlëndore dhe nga qasja e saj e orientuar drejt karakterit ndërkulturor, nga fokusi i temave të mësipërme dhe nga objektivat e të mësuarit që synojnë të zhvillojnë kompetencat e kërkuara nga qytetaria globale.

Duke ofruar shanse të reja për arsimin, edukimi global mbështetet për të dhënë ide për të kuptuar dukurinë e globalizimit, për të mundësuar fitimin dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të kërkuara nga individët për t'i përshtatur ato ndaj sfidave të shoqërisë në ndryshim. Edukimi global, më shumë se një strategji që aftëson njerëzit të kuptojnë botën ku jetojnë, është një mënyrë e veçantë e veprimit për të modeluar botën, për të ndihmuar qeniet njerëzore të arrijnë fuqizimin e tyre personal dhe komunitar.

Edukimi global përqendrohet në të mësuarit global, i cili zhvillon aftësinë për të kuptuar, për të ndjerë dhe për të vepruar në kuadrin e ndërvarësive të shumanshme, të cilat janë të orientuara nga e ardhmja. Megjithëse të mësuarit global nuk mund të arrihet pa njohuri specialistësh, fitimi i njohurive nuk është qëllimi i tij parësor. Të mësuarit global synon, kryesisht, të zhvillojë aftësitë për të marrë vendime për jetën, të marrë pjesë, në mënyrë kompetente, në praktikën shoqërore dhe të shprehë solidaritetin me ata, të cilëve u janë shkelur të drejtat themelore.

Të mësuarit global përkufizohet si i mësuarit tërësor, pararendës, pjesëmarrës, me në qendër personin, i bazuar në situatë dhe në nxitjen e të menduarit, i përshtatshëm për t'u përballur me ndërvarësitë. Ai është i mësuarit i përqendruar në çështjet, i bazuar në motivimet vetjake dhe në përpjekjet e pavarura.

Si proces të mësuarit, edukimi global lehtëson zhvillimin e aftësive për të ndjerë, për të menduar, për të gjykuar dhe për të vepruar, në mënyrë që të rinjtë të mund të përballen me sfidat intelektuale dhe emocionale të ekzistencës globale.<sup>17</sup>

---

<sup>17</sup> Ekziston rreziku që edukimi global të devijojë në lëmoshë dhe qasje kujdestarie, që përjetësojnë klishtë dhe stereotipat, veçanërisht rreth vendeve të Botës së Tretë dhe krijon ose ruan pamje dhe qëndrime të cilat

Të mësuarit global synon të zotërojë tensionet, veçanërisht ato ndërmjet:

- Globalizimit dhe potencialit lokal për veprim
- Komplexitetit dhe thjeshtëzimit të pashmangshëm
- Ndërkombëtarizimit të përvojës jetësore dhe individualizimit
- Pasigurisë dhe nevojës për siguri
- Orientimit nga e ardhmja dhe përballja me ngjarjet dhe proceset e përcaktuara historikisht
- Fitimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave shoqërore

Edukimi global, si metodë e të menduarit, gjykimit, ndjenjës dhe veprimit, që mishëron dimensionin e të mësuarit, mënyrës së jetesës dhe veprimit, duke theksuar marrëdhëniet e vlerave dhe standardeve për njerëzimin në tërësi, duke theksuar kontekstin ndërkombëtar dhe duke aftësuar fëmijët për të marrë pjesë aktivisht në ndërtimin e të ardhmes së tyre.

#### 4. OBJEKTIVAT

Edukimi global përmbush nevojat për trajnim të të rinjve dhe kontribuon në edukimin e tyre moral, duke u përpjekur të sigurojnë përgjigjet e duhura dhe kompetente për pyetje të tilla si:

- Në çfarë mënyre dhe në çfarë shkalle jetët tona ndikohen nga proceset globale, që veprojnë në nivel lokal dhe sa ne jemi të vetëdijshëm për këtë?
- Si dhe në çfarë shkalle, proceset globale mund të ndikohen nga ato lokale, nga mundësia e përdorimit të burimeve tek ndarja e përgjegjësisë?
- Si mund që rritja e qëndrueshme dhe shoqëria e qëndrueshme të sigurohet tani dhe në të ardhmen?
- Si mund të modelohet ndërvarësia globale-lokale, në mënyrë që globalizimi të mos jetë kërcënim për gjithçka që është lokale?
- Si mund të shmangim që globalizimi të shkojë në drejtim të gabuar, kur arsyet janë egoiste dhe “të gabuara”?
- Në çfarë mënyre modelet arsimore me në qendër etninë mund të kapërcehen, kur ne ndjekim ruajtjen e identitetit tonë lokal në një kuadër global?
- Në çfarë mënyre mund të identifikohen konceptet lokale të qytetarisë globale?

Nga edukimi global pritet të sigurojë orientimin në botën e sotme dhe të ardhme. Për të zhvilluar aftësitë për të kuptuar botën ku jetojmë dhe për veprime kompetente dhe morale, edukimi global mund të lehtësojë:

- njohjen e të tjerëve dhe pranimin e jetës në një botë pluraliste;
- njohjen e faktit që marrëdhëniet globale janë komplekse dhe që ne duhet të kuptojmë globalizimin nga këndvështrime të ndryshme;
- analizën e mënyrës si marrëdhëniet globale ndikojnë te ne përmes marrëdhëniet shkak-pasojë dhe qëllim-mjet.
- pranimin e ndërvarësisë dhe ndërhyrjes që modelon identitetet tona lokale, rajonale dhe kombëtare, në një kontekst global;

---

janë false dhe të rrezikshme, duke mbajtur parasysh potencialin dhe përpjekjet e këtyre vendeve për të hyrë në shkallët e zhvillimit.

- zhvillimin e shqetësimit për drejtësi, për të drejta dhe përgjegjësi të përbashkëta në kuadrin e qytetarisë globale;
- hapjen/larminë e formave të të mësuarit, duke përfshirë këtu edhe median kritike;
- dëshminë që njerëzit mund të ndikojnë në jetën e tyre përmes pjesëmarrjes kundër padrejtësisë, shfrytëzimit dhe shtypjes;
- gatishmërinë për veprime personale dhe në grup;
- njohjen e ndikimeve të zgjedhjeve/vendimeve dhe veprimeve të sotme.

Duke u bazuar në dimensionin edukimit ndërkulturor të integruar në themelet e edukimit global, ne e vlerësojmë edukimin global si ombrellë të katër fushave në artin dhe njohuritë e të jetuarit së bashku në Planetin Tokë (“Di të jetoj në bashkësi”)

- Edukimi për empati* (të mësosh të kuptosh të tjerët, të mësosh të vësh veten në vendin e tjetrit, të shohësh problemet me syrin e të tjerëve, të jesh empatik me të tjerët).
- Edukimi për solidaritet* (të zhvillosh ndjenjën e komunitetit që ngrihet përtej kufizimeve të grupit, shtetit ose racës, të punosh/të bësh fushatë për t’ dhënë fund pabarazisë dhe padrejtësisë sociale).
- Edukimi për respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë* (të jesh i hapur ndaj kulturave/fushave/botëve, të ftosh të tjerët të marrin pjesë/të bashkohen në kulturën e tyre).
- Edukimi kundër nacionalizmit* (të hapesh ndaj kombeve të tjerë, të komunikosh, të shmangësh qëndrimet/shprehjet/sjelljet e rrënjosura në paragjykim dhe stereotipa).

Edukimi global zgjeron horizontet e njohurive dhe lejon reflektimin kritik për identitetet dhe mënyrës tonë të jetesës dhe të tjerëve dhe, që këtej, ai ndihmon në shmangien e keqinterpretimeve dhe stereotipave. Proceset e të mësuarit, specifike për edukimin global synojnë të zhvillojnë një marrëdhënie të qëndrueshme ndërmjet globales dhe lokales, në një përpjekje për të përmbushur nevojën e ndërtimit të jetëve tona përmes veprimit.

#### **4.1 Njohuritë dhe proceset e të mësuarit**

Njohuritë dhe vetëdija për proceset globale nuk janë qëllime në vetvete. Ato kanë kuptim vetëm nëse synojnë zhvillimin e qëndrimeve dhe kompetencave për të kultivuar ndjeshmërinë dhe pjesëmarrjen shoqërore të të rinjve.

Përmes një grupi njohurish të caktuara, nxënësit duhet të njihen me gjuhën dhe çështjet e edukimit global. Ata duhet të përballen me koncepte themelore të tilla si:

*të drejtat e njeriut, komunikimi botëror, e ardhmja e qëndrueshme, puna dhe punësim, aleanca të reja ekonomike dhe grupime të reja pushteti, sundim, zhvillim, ndarje, tregti ndërkombëtare, rritje popullore, trysnia e burimeve, shkatërrimi i habitatit dhe ruajtja, përfshirja, përjashtim, varfëria masive, migrimi, nacionalizmi përkundrajt internacionalizmit, konfliktet, lëvizja shoqërore, arsimit.*

*Informacioni faktik* i ofruar nxënësve duhet të jetë i rëndësishëm dhe i verifikueshëm, dhe të lidhë këndvështrimet e ndryshme kulturore, historike, gjinore dhe ideologjike. Më tej, ai duhet të shoqërohet me analizën e ideve të hapura dhe të nënkuptuara dhe të vlerave që qëndrojnë në themel të këtyre këndvështrimeve. Edukimi global duhet të vërë theksin në

ndërvarësitë strukturore ndërmjet Veriut dhe Jugut dhe ndërmjet prirjeve të zhvillimit në Veri dhe në Jug.

Proceset e të mësuarit, duhet të përpiqen të integrojnë qëndrimet, aftësitë dhe njohuritë dhe të marrin parasysh marrëdhëniet ndërmjet njohurive dhe kontekstit.

Njohuritë duhet të ndihmojnë nxënësit të eksplorojnë dhe të përdorin lidhjet ndërlëndore dhe kroskurrikulare që ofron programi shkollor (p.sh. lidhjet ndërmjet historisë dhe studimeve mjedisore, ndërmjet gjeografisë, historisë dhe studimeve qytetare dhe politike etj.)

## **4.2 Qëndrimet dhe aftësitë**

Vendimmarrësit e politikës dhe të arsimit dhe mësuesit duhet të kuptojnë nevojën për edukimin global dhe potencialin e tij. Programet shkollore kanë nevojë për të zhvilluar qëndrimet dhe sjelljet që çojnë në pranimin dhe zhvillimin e ndërvarësive dhe bashkëpunimit ndërmjet kombeve. Aftësitë shpirtërore, emocionale dhe fizike të nevojshme për të sunduar realitetin dhe kompleksitetin e jetëve tona janë mjete intelektuale dhe shoqërore-emocionale që duhet të orientohen drejt këndvështrimit të globalizuar të artit dhe njohurive për të jetuar së bashku.

Zhvillimi i qëndrimeve dhe i aftësive që duhet të mbështesë dhe të nxisë edukimi global, synon të bëjë fëmijët të aftë të shmangim indiferencën dhe mungesën e shqetësimit. Ai shmang të menduarit e thjeshtësuar dhe të njëanshëm që ruan klishetë, njëanshmëritë dhe stereotipat, të cilat rritin qëndrueshmërinë e pasojave shoqërore negative. Synimi i edukimit global është të ngushtojë hendekun ndërmjet njohurive (madje edhe të kuptuarit) dhe veprimeve të përgjegjshme, duke ndihmuar të rinjtë të zhvillojnë aftësi politike dhe besimin për t'i përdorur ato.

Përpjekjet tërësore të edukimit global që vënë theksin në marrëdhëniet ndërmjet çështjeve globale dhe lokale, që duhet të aftësojnë nxënësit për të zhvilluar dhe për të shprehur shqetësimet e tyre për barazinë, drejtësinë shoqërore dhe mirëqenien e tyre personale dhe mjedisore. Nxënësit duhet të zhvillojnë qëndrimet e tolerancës dhe respektit, solidaritetit, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit, konkurrencës së ndershme, të kujdesit, të patriotizmit pa paternalizëm dhe nacionalizëm.

Aftësitë intelektuale të zhvilluara përmes edukimit global duhet t'u japin nxënësve mundësi kompetente për të njohur dhe kuptuar aspektet/fushat komplekse dhe të ndërvarura të të drejtave të njeriut, të zhvillimit të qëndrueshëm, paqes, qytetarisë dhe mjedisit. Ato duhet të aftësojnë nxënësit për të kapur dimensionet shumë dhe ndërkulturore të identiteteve tona dhe ndërvarësitë komplekse të jetës bashkëkohore në pamjet e tyre pozitive dhe negative të projektuara dhe të vlerësuara në kontekst. Mendimi kritik dhe qasja kritike, në thelb, nënkupton krahasimin e dukurive dhe proceseve lokale dhe globale, dhe analizon shkaqet dhe arsyet e tyre. Nxënësit duhet të përdorin, sa më shumë të jetë e mundur, qasje që përfshijnë kontraste, krahasime, vlerësime nga burimi i tyre i kritikizmit.

Nxënësit duhet të mësojnë të trajtojnë teknologjitë e reja të informacionit, të cilat na lidhin përditë me botën. Vend të veçantë duhet t'i kushtohet letërsisë kritike dhe analizës kritike të medias, për shkak të mundësisë së saj për të nxitur ose mbështetur stereotipa dhe keqinterpretime. Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit shoqëror, të vendimmarrjes dhe të zgjidhjes së konflikteve. Ata duhet të mësojnë të ndajnë përgjegjësitë,

të pranojnë këndvështrimet e ndryshme si burim i pasurimit dhe fuqizimit të ndërsjellë. Të tilla aftësi janë themelore për të njohur dhe përdorur strategjitë për pjesëmarrje dhe përfshirje në çështjet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto aftësi duhet të zhvillojnë vetëdijen e marrëdhënieve ndërmjet veprimit njerëzor dhe vendimmarrjes. Ato duhe të ndihmojnë edhe në përshtatjen krijuese ndaj ndryshimit.

## 5. SFIDA PEDAGOGJIKE

Njohja dhe mbështetja e edukimit global në shkolla, si një dimension i të mësuarit, mund dhe duhet të ketë, si pjesë të rëndësishme, ndryshimet kurrikulare, si një nisme e mirë ose si veprim reformues.

Edukimi global, në praktikën pedagogjike, identifikohet si një qasje kros-kurrikulare, si qasje disiplinore me theks të veçantë në aspektet globale ose si program e projekt i veçantë ekstra-kurrikular. Zbatuesit duhet të kuptojnë nevojën për metoda dhe strategji që bashkërendojnë ndjenjat, mendimin dhe bërjen, si dhe baraspeshën ndërmjet lojës dhe të mësuarit, ndërmjet statusit aktor dhe spektator të nxënësit, ndërmjet të mësuarit dhe veprimit përmes ndarjes.

Duke zhvilluar vlerën emocionale të të mësuarit, përveç asaj njohëse, edukimi global mbështetet fuqimisht në *ndërveprimin e teknikave* të cilat ndihmojnë të përshtaten përmbajtja dhe forma e të mësuarit me synimet e edukimit global.

Mësimdhënia dhe të mësuarit për çështjet globale në arsimin formal ngre *sfida të rëndësishme pedagogjike*, të cilat po i përmbledhim më poshtë:

- Në çfarë mënyre, shkolla mund të jetë e suksesshme në lidhjen e ngjarjeve, shkaqeve dhe pasojave, të cilat janë larg gjeografikisht, dhe si mund të kultivojë vetëdije dhe qëndrime që ende nuk ekzistojnë në nivelin e vendimmarrësve dhe as në pjesën më të madhe të medias?
- Në çfarë mënyre, edukimi global mund të projektojë projekte të rëndësishme shkollore që përqendrohen në ndërveprimin e globales me lokalen dhe, të në njëjtën kohë, të mos synojnë, në mënyrë të veçantë, drejt komunitetit?
- Si mund të arrihet baraspesha ndërmjet nevojës për t'iu drejtuar metodave tradicionale të pedagogjisë tradicionale dhe metodologjive të ofruara nga shkencat moderne arsimore, të tilla si strategjitë ndërvepruese, partneriteti ose puna me projekte, bashkëpunimi, shkëmbimet dhe kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet shkollave dhe vendeve, dhe sistemi i komunikimit modern (fax, e-mail, internet)?
- Si mund të ndërliiden veprimtaritë shkollore dhe jashtëshkollore për të mundësuar ndërveprime me dobi të ndërsjellë, që e ndalojnë shkollën nga të qenit plotësisht dhe artificialisht e shkëputur nga familja, komuniteti dhe ndikimet e tjera shoqërore e politike, gjë që përmban mundësi përfitimi arsimor?
- Sa kohë mësimore mund t'i kushtohet edukimit global në programet shkollore?

Këto sfida duhet të merren parasysh në lidhje me çdo gjë që lidhet me veprimtarit shkollore, duke përfshirë këtu materialet mësimore, konsultimet dhe trajnimin.

Ne mbrojmë pikëpamjen që, përmes shembujve të praktikave të mira, edukimi global ka dëshmuar potencialin e tij reformues dhe kjo, për sa i takon arsimin, tregon se nuk ka një pedagogji të vetme, por pedagogji të ndryshme, të përshtatura me kontekstet e veçanta. Në

këtë mënyrë, pluralizmi kulturor dhe politik, si parim i edukimit global, shfaqet në praktikën e shkollës si *pluralizëm pedagogjik*. Është pikërisht ky pluralizëm pedagogjik që duhet t'u japë edhe nxënësve një zë në hartimin e programeve dhe të veprimtarive të veçanta.

Ne besojmë fuqimisht se diskutimet dhe dialogët e mëtejshëm ndërmjet mësuesve do të mundësojnë më shumë njohuri për proceset kurrikulare dhe rastet e praktikave të mira nga e gjithë bota.

Edukimi global, si një instrument i ndërhyrjes, duhet të mbështetet në një *mjedis të veçantë të mësuarit, që lehtëson zhvillimin gradual të ndjenjës së kureshtjes dhe të kënaqësisë së zbulimit dhe lejon zbatimin në praktikë të njohurive të fituara.*

## **6 . SFIDAT INSTITUCIONALE**

Edukimi global shihet nga mbrojtësit dhe ushtruesit e tij, jo vetëm si një burim i vlefshëm i të mësuarit shoqëror dhe i shoqërizimit, por edhe si një rezervuar i ndryshimit institucional dhe i përmirësimit të shkollës, në mënyrë që, çfarë ndodh në të, të jetë sa më pak akademike, e përshtatur dhe e integruar më mirë me ndryshimet e jetës shoqërore.

Edukimi global po shfaqet, njëherazi, si një sfidë dhe shans për zhvillimin institucional të shkollave, që nënkupton nevojën për një kurrikul më të hapur dhe më të ndryshueshme, si dhe *për zhvillimin në shkollë të një klime dhe të një mjedisi të mësuarit demokratik.*

Hartuesit e politikave arsimore duhet të rishqyrtojnë rolin e shkollës e cila, më shumë se instrument i përjetësimit të qëllimeve nacionaliste, *duhet të hapë fëmijët drejt një këndvështrimi botëror dhe t'i aftësojë ata për të qenë në gjendje të jetojnë së bashku, në një botë që përballet me shanse, por edhe me rreziqe të panjohura më parë.*

Hartuesit e politikave dhe autoritetet shkollërore duhet t'i japin mbështetje institucionale edukimit global në shkollë:

- duke bërë të njohur dhe duke nxitur projektet dhe programet e edukimit global përmes kurrikulës së arsimit formal;
- duke lehtësuar ngritjen dhe bashkëpunimin e qendrave për edukim global;
- duke lehtësuar rrjetet e partneritetit ndërmjet institucioneve dhe personave të Veriut dhe Jugut;
- duke ofruar trajnimin fillestar dhe në punë të mësuesve, për të nxitur mësuesit që të interesohen për kulturën profesionale të edukimit global.

Shumë projekte të edukimit global provojnë që aspektet e ndryshme, si *ngritja e fondeve ose partneriteti*, mund të bëhen të prekshme, veçanërisht, nëse ekziston bashkëpunimi me autoritetet publike dhe me qendrat kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara në fushën e edukimit global. Shembuj të mirë në këtë drejtim janë vende të tilla si Holanda, Zvicra, Britania e Madhe dhe Gjermania, ku secili mund të flasë për një *traditë të gjerë kros kurrikulare të edukimit global, të përfshirë në programet shkollërore, përmes përpjekjeve dhe interesit të ministrive të arsimit dhe të disa OJF-ve të specializuara në zhvillimin e kurrikulës.*

Partneriteti i efektshëm ndërmjet njerëzve dhe/ose institucioneve, si kusht i domosdoshëm për edukimin global, varet, *sipas rastit, nga informacioni, dokumentacioni dhe mundësitë financiare*, që sigurohen nga shërbime të specializuara të qendrave kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat janë aktive dhe kompetente në edukimin global. *Qendrat e Edukimit*



*Global duhet të rritin koordinimin dhe çarkullimin e ideve dhe të informacionit, duke orientuar ekipet e mësuesve drejt përfshirjes së dimensionit të veprimit të edukimit global në shkolla, duke i dhënë çdo shkollë një profil të veçantë.*

Për të përmirësuar mbështetjen institucionale për përfshirjen në kurrikulën zyrtare të programeve tërësore të edukimit global, ne rekomandojmë me forcë që edukimi global të bëhet pjesë e legjislacionit kombëtar, rajonal dhe lokal dhe të hartohen kurrikula dhe udhëzime për të gjitha format dhe nivelet e shkollimit, për të aftësuar mësuesit dhe nxënësit të zhvillojnë strategji për shoqërimin global dhe mësuarit për edukimin global.

Programet shkollore duhet të bëhen një pikë e rëndësishme nisjeje për të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke lehtësuar përpjekjet afatgjata dhe të qëndrueshme të kalimit kulturor drejt një shoqërie (të mësuarit) global(e).

## Shtojca

### **Lista e dokumenteve ndërkombëtarë që lidhen dhe mbështesin edukimin global:**

- The Universal Declaration of Human Rights (1948) and the United Nations Charter on Human Rights
- European Convention on Human Rights and Fundamental Freedoms (1950)
- UNESCO Recommendation - (1974)
- The Helsinki Accords (1975)
- International Covenant on Civil and Political Rights (1976)
- International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights (1976)
- Council of Europe's Recommendation No. 85/1985 on Teaching and Learning about Human Rights in Schools
- Declaration on the Rights to Development (1986)
- UN Convention on the Rights of the Child (1989), e.g. Art. 29
- The Maastricht Treaty (1992)
- Agenda '21 (Post-Rio Declaration - 1992) on sustainable development
- The Vienna Declaration of Heads of State and Government of the Council of Europe Member States (1993)
- The Vienna Declaration and Programme of Action adopted 25 June 1993 by the World Conference on Human Rights
- Resolution of the Standing Conference of the European Ministers of Education on Democracy, Human Rights and Tolerance (1994)
- Conclusions and Recommendations of the UNESCO European Conference on Curriculum
- Development: Civic Education and Eastern Europe - Vienna (1995)
- Draft Integrated Framework of Action on Education for Peace, Human Rights and Democracy, adopted at the UNESCO General Conference (1995)
- Rapport a l'UNESCO de la Commission internationale sur l'éducation pour le vingt et unième siècle présidée par JACQUES DELORS: L'EDUCATION - UN TRESOR EST CACHE DEDANS, Editions Odile Jacob, (1996) / Delors Commission Report to UNESCO : "Education in the XXI<sup>th</sup> Century" - EDUCATION - Learning - The Treasure Within, (1996)
- European Commission White Paper on Education and Training (1996) on the initiative of Edith Cresson, Commissioner for Research, Education and Training, and Pdraig Flynn, Commissioner for Employment and Social Affairs, in cooperation with Martin Bangemann, Commissioner for Industry, Telecommunication and Information Technology
- Amsterdam Appeal on conflict prevention and peace-building. Action Plan for European Leaders and Civil Society (1997)

Shumë dokumente të tjerë, si deklarata, pakte dhe rekomandime, janë të bërë të mundshme përmes takimeve ndërkombëtare, p.sh. ato për edukimin mjedisor ose edukimin për të ardhmen të kryera në Stockholm 1972, Tbilisi 1977, Copenhagen 1982, Moscow 1987, Rio de Janeiro, 1992.

## KONTRIBUTE

### Grupi i Punës për Udhëzimet për Edukimin Global

**Alicia Cabezudo**

Peace and Human Rights Educator, School of Education, University of Rosario, Argentina, Master's degree in Peace Education, University of Peace, San José, Costa Rica

**Miguel Carvalho da Silva**

Global Education Programme Manager, coordinator of the Global Education Week Network, North-South Centre (NSC) of the Council of Europe, Lisbon, Portugal

**Christos Christidis**

School adviser, Director of GAIA Education Centre, Thessaloniki, Greece

**Valentina Demetriadou-Saltet**

Secondary School Teacher, Permanent Secretary Assistant – Ministry of Education and Culture, Cyprus

**Franz Halbartschlager**

Secondary School Teacher, Head of the Education Department of Südwind Agentur, Austria

**Georgeta-Paula Mihai**

Secondary School Teacher, School Inspector for formal and non-formal education, Romania

**Me mbështetjen dhe kontributin e Sekretariatit të Qendrës Veri-Jug:**

Gordana Berjan, Ilda Oliveira, Marcos Andrade, David Gakunzi, Paula Smith

**Dhe Rrjeti i Javës së Edukimit Global<sup>18</sup>**

---

<sup>18</sup> Lista e Rrjetit të Javës së Edukimit Global [www.nscentre.org](http://www.nscentre.org), në kuadrin e link-eve të Arsimit dhe Javës së Edukimit Global

## KËSHILLTARË

**Kwasi Boateng** – Java e Një Bote të Vetme - Ghana

**Maarten Coertjens** – Policy Officer Education, Forumi Rinor Evropian

**Dakmara Georgescu** – Koordinator Programi (Asistencë Teknike/Zhvillim Kurrikule), UNESCO International Bureau of Education (IBE)

**Madie Joubert** – Përgjegjës i misionit « Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Këshillin Kombëtar të Arsimit Bujqësor » (CNEAP) në Paris

**Nuno da Silva** – Arsimtar i lirë, Këshilli Kombëtar i Rinisë Portugeze; anëtar i grupit të trajnerëve të Këshillit të Evropës, Forumi Rinor Evropian dhe EU SALTO Kurse për Qytetarinë Evropiane; Koordinator i kurseve për trajnimin e trajnerëve të Edukimit Global në NSC Universiteti i Rinisë dhe Zhvillimit.

**Ingrid Wilson** - Mësuese; Drejtor i Shërbimeve Ndërkombëtare të Zhvillimit të Arsimit dhe Arteve, S. Wales; Trusti Java e Një Bote të Vetme, UK

Koordinator projekti/shkrimi nga:	Miguel Carvalho da Silva
Korrektor:	Wendy Graça
Faqosja e kopertinës dhe teksit:	Luca Padovani
Shtypja:	Multitema Soluções de Impressão S.A.
Botimi:	Qendra Veri-Jug e Këshillit të Evropës - 2008

*Idetë e shprehura në këtë libër janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.*

North-South Centre of the Council of Europe  
Av. da República, n°15-4°  
1050-185 Lisboa-Portugal  
Tel.: + 351 213 584 030  
Fax: + 351 213 584 072  
[www.nscentre.org](http://www.nscentre.org)  
[www.coe.int](http://www.coe.int)